



RAPORTI VJETOR I
KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI



Tabela e përmbajtjes

I.	Mesazhi i Titullarit.....	4
II.	Hyrje	7
III.	Kuadri Ligjor mbi Barazinë dhe Antidiskriminimin	7
	1. Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit.	7
	Instrumentet në kuadrin e OKB-së	7
	Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës	11
	Standardet e Bashkimit Evropian	12
	2. Kuadri Ligjor Shqiptar	14
	3. Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funkcionimin e KMD	28
	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative	28
	Zyra e KMD	28
	Kompetencat e Komisionerit.....	29
IV.	Veprimtaria në Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Promovimi i Barazisë.....	31
	1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit	31
	2. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD	31
	3. Procedura e shqyrtimit të ankesave.....	31
	Procedura e regjistrimit të ankesave	32
	Ankuesit.....	35
	Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së).....	36
	Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive	37
	Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara	37
	Çështjet e trajtuara sipas fushave.....	39
	Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve.	40
	Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit.....	41
	Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit.....	42
	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.	43
	Gjuha e urrejtjes.....	43
	Mbrojtja e të drejtave të shtetasve të huaj	44
	4. Vendimet e çështjeve sipas fushave.	45
	5. Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve.....	46
	Vendimet e çështjeve me shkak racën	46
	Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar	47
	Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike.....	49

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike.....	49
Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore.....	50
Vendimet e çështjeve me shkak moshën.....	51
Vendimet e çështjeve me shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.....	52
Vendimet e çështjeve me shkak gjininë.....	53
Vendimet e çështjeve për “çdo shkak tjetër”.....	54
Vendimet për konstatimin e diskriminimit për më shumë se një shkak.....	55
Format e tjera të diskriminimit.....	56
6. Rezultatet e vendimeve të çështjeve të shqyrtuara.....	56
Problematikat e evidentuara nga KMD gjatë shqyrtimit të ankesave.....	58
7. Proceset Gjyqësore.....	60
Pjesëmarrja e KMD në proceset gjyqësore.....	60
Pjesëmarrja në proceset gjyqësore.....	61
Vendimet Gjyqësore.....	63
Praktika gjyqësore lidhur me shpërblimin e dëmit si pasojë e diskriminimit.....	76
8. Rekomandime dhe opinione ligjore.....	79
Rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore:.....	79
Rekomandime në lidhje me Projekt-ligjin "Për Barazinë Gjinore".....	80
9. Ndërgjegjësimi.....	111
Komunikimi Publik dhe Bashkëpunimi me Median.....	111
Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete.....	112
Përfundime dhe objektiva strategjike.....	123
10. Veprimtaria monitoruese e KMD.....	124
Raportime të KMD.....	124
11. Programi i transparencës.....	126
V. Zyrrat Rajonale.....	127
1. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë.....	127
2. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier.....	134
3. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër.....	146
VI. Aspekte të Shërbimeve.....	152
1. Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2024.....	152
2. Menaxhimi i burimeve financiare 2025.....	153

I. Mesazhi i Titullarit

Në muajin simbolik të Marsit që korrespondon me Ditën Ndërkombëtare të Diskriminimit Zero, veshur me funksionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), po Ju dërgoj përmbledhjen vjetore të veprimtarisë së Institucionit e cila reflekton edhe gjendjen e diskriminimit në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga përpjekjet e vazhdueshme të Kuvendit të Shqipërisë dhe vullnetit pozitiv të treguar në përforcimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim garantimin sa më efektiv të Parimit të Barazisë dhe mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi individual dhe i strukturuar, uroj një vazhdimësi të përhershme dhe të përditshme të këtij impenjimi të Kuvendit me të gjitha institucionet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Sfidat janë të gjithanshme dhe kërkojnë një aktivizëm të të gjithë aktorëve publikë dhe shoqërorë në promovimin, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave sociale, si instrumente vitale në gëzimin me dinjitet të të gjitha të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventave Ndërkombëtare.

Në kuadër të veprimtarisë vjetore që po ju dërgohet KMD gjykon dhënien e disa rekomandimeve me karakter strukturor, me qëllim vëmendjen e Kuvendit dhe nevojën për më shumë kërkesë llogarie si dhe zgjidhje ligjore të disa aspekteve të evidentuar nga veprimtaria e institucionit.

Së pari, vërehet që Kuvendi i Shqipërisë nuk i kushton vëmendjen e duhur propozimeve të KMD-së në lidhje me ndryshime ligjore të nevojshme për garantimin e barazisë dhe shmangien e diskriminimit.

Së dyti, evidentohet një implementim i dobët dhe i pamjaftueshëm i ligjeve me karakter social që miraton Kuvendi i Shqipërisë, nga ana e pushtetit ekzekutiv dhe vetëqeverisjes vendore. Ky mosimplementim lidhet me disa aspekte ndër të cilat mund të evidentojmë më kryesoret:

- Mungesë e analizave ligjore dhe financiare të implementimit të ligjeve, si nga ana e vetë Kuvendit ashtu edhe nga pushteti qendror dhe vendor;
- Mungesë e të dhënave të besueshme, sistematike, të unifikuara dhe publike të institucioneve publike;
- Mungesë dhe pamjaftueshmëri e buxhetit të dedikuar dhe shumë të domosdoshëm për implementimin e këtyre ligjeve;
- Interpretim i ngushtë i ligjeve me karakter social nga ana e administratës publike qendrore dhe vendore, duke sjellë shpesh herë përjashtimin e grupeve vulnerabël nga përfitimi i shërbimeve apo pagesave sociale;
- Mungesë e një bashkëpunimi, koordinimi dhe kooperimi të vazhdueshëm dhe të strukturuar midis organeve publike në tërësi e sidomos midis pushtetit qendror dhe atij vendor në veçanti;
- Implementim i pamjaftueshëm i strategjive dhe planeve të veprimit që miratohen për arritjen e barazisë dhe luftën kundër diskriminimit për grupet më vulnerabël;
- Nivel i ulët i zbatimit dhe implementimit të vendimeve dhe rekomandimeve që institucioni i KMD-së miraton;

- Efektivitet i ulët i kontrollit që Kuvendi ushtron ndaj pushtetit ekzekutiv nisur nga veprimtaria e KMD-së;
- Vëmendje e ulët nga ana e administratës publike mbi standartet ndërkombëtare që Shteti Shqiptar ka ratifikuar dhe pranuar, në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut.

Së treti, rezulton nga veprimtaria e institucionit që për disa grupe vulnerabël pabarazia dhe diskriminimi mbeten të strukturuar dhe sistemikë. Nga problematikat e shumta që evidentohet tashmë ndër vite mund të evidentohen si më problematike disa aspekte:

- Në lidhje me personat me aftësi të kufizuar, mbetet problem i theksuar mungesa e aksesueshmërisë në institucione dhe shërbime si dhe garantimi i lëvizjes së lirë dhe jetesës së pavarur për këto persona;
- Në lidhje me komunitetet Rome dhe Egjiptiane, paraqet problem strehimi dhe garantimi kushteve të jetesës dinjitoze për këto persona;
- Në lidhje me gratë dhe vajzat, vazhdojnë problemet endemike të dhunës së dimensioneve të ndryshme, portretizimit të tyre në publik në mënyrë paragykuese, si dhe pabarazia *de facto* në shumë fusha të jetës;
- Në lidhje me komunitetin LGBTI, problemi kryesor lidhet me homofobinë dhe përdorimin e gjuhës së urrejtjes kundrejt tyre në të gjitha format e të shprehurit publik;
- Në lidhje me fëmijët, evidentohet një mosadresim i strukturuar i bullizimit në shkolla, aspekte të segregimit të fëmijëve Romë dhe Egjiptianë, si dhe mosmbeshtetja e duhur për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë;
- Së fundmi, si emërues të përbashkët të individëve të këtyre grupeve që shërben si shkak i diskriminimit është gjendja ekonomike e tyre. Është pikërisht pamundësia dhe pamjaftueshëmria ekonomike e tyre që i ekspozon ndaj sjelljeve diskriminuese dhe i bën viktima të vazhdueshme të pabarazisë dhe diskriminimit.

Së katërti, rezulton ndër vite se një nga fushat ku ka numër të lartë ankesash dhe për rrjedhojë edhe vendimesh, është ajo e punësimit. Si probleme më të mprehta në këtë fushë evidentohen:

- Mos zbatimi i legjislacionit në lidhje me garancitë që duhet të ketë punonjësit në periudhën e mëmësisë;
- Mos lejimi dhe vendosja e barrierave dhe vështirësive në lidhje me krijimin e sindikatave apo të ushtrimit të aktivitetit sindikal, si dhe heqja nga puna e drejtuesve të sindikatave;
- Evidentimi i bindjes politike si shkak për pushimin nga puna apo shqetësimin e punonjësve, sidomos në pushtetin vendor;
- Heqja nga puna si dhe shqetësimi i punonjësve për shkak të qendrimeve kritike apo edhe ankesave të adresuar kundrejtë punëdhësit të tyre;
- Mungesa e parashikimeve në aktet e brendshme rregullatore të institucioneve, të garantimit të të drejtave të punëmarrësve në lidhje me shqetësimin dhe diskriminimin në vendin e punës, si dhe mungesa e punonjësve të trajnuar për adresimin e tyre.

Së fundmi, si nevoja të domosdoshme për përmirësimin e situatës së diskriminimit në Shqipëri me qëllim zbehjen e pabarazive dhe garantimin e parimit të barazisë, rekomandohet:

- Zgjidhja e problemeve të evidentuara nga organet e barazisë në mënyrë sistematike dhe të strukturuar dhe jo sporadike dhe individuale;
- Alokimin e buxhetit të nevojshëm për implementimin e ligjeve me karakter social si dhe të strategjive të miratuara për grupet e pamundura;
- Krijimi i një dialogu të përhershëm dhe të strukturuar midis Kuvendit, organeve qendrore dhe vendore dhe organeve të barazisë dhe organizatave të shoqërisë civile;
- Forcimi dhe efektiviteti i organeve mbikqyrëse të Kuvendit kundrejtë pushtetit ekzekutiv, si dhe kryerja e analizave periodike mbi zbatimin dhe implementimin e ligjeve me karakter social;

- Fuqizimin me kapacitetet e nevojshme të organeve të barazisë në aspektin buxhetor, strukturor, si dhe të marrjes parasysh të vendimeve dhe rekomandimeve të tyre;
- Ngritjen e një Ministrie të posaçme për çështjet e barazisë, sociale, apo të shanseve të barabarta;
- Ndërtimin e sistemeve të strukturuar, unifikuar, segreguar dhe publike të të dhënave;
- Si dhe, mbajtjen gjithmonë parasysh të parimeve kushtetuese, standarteve ndërkombëtare dhe jurisprudencës së gjykatave supreme dhe ndërkombëtare, në hartimin dhe implementimin e politikave me karakter social dhe që kanë një ndikim direkt në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe garantimin e dinjitetit njerëzor.

Përsa më sipër, shpreh besimin e plotë në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjithë subjekteve në ndreqjen e pabarazive dhe luftën kundër diskriminimit, duke garantuar përfshirjen pa rezerva të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në këtë sfidë dhe detyrë publike dhe qytetare.

KOMISIONERI

ROBERT GAJDA

II. Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Referuar nenit 26, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara Komisioneve të Kuvendit, si dhe përgatit raporte mbi aktivitetet e 6 mujorit të parë të vitit të veprimtarisë institucionale.

Raporti përfshin analizë të veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përgjithësi, si dhe puna e Komisionerit dhe Zyrës janë reflektuar me qëllim njohjen dhe informimin me veprimtarin konkrete të ushtruar, sipas fushës së kompetencës që mbulon.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Vlerësimet dhe Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë përmes “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2024”, janë një udhëzues në veprimtarinë e institucionit për garantimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

III. Kuadri Ligjor mbi Barazinë dhe Antidiskriminimin

1. Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit.

Ka standarde të shumta në këtë fushë të krijuara dhe zbatuara në nivelin e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, dhe Bashkimit Evropian, të cilat mund të shërbejnë si bazë e dobishme për çdo vlerësim të pjesëve të kuadrit ligjor të barazisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Pas nënshkrimit dhe ratifikimit të instrumenteve të legjislacionit ndërkombëtar që merren me të drejtat e njeriut dhe pas ndalimit të instrumenteve të diskriminimit, Shqipëria i ka bërë ato pjesë të rendit të brendshëm ligjor.

Instrumentet në kuadrin e OKB-së

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948, ndonëse ka karakter thjesht deklarativ, pra konsiderohet si një dokument “*soft law*”, ka një vlerë kolosale për formulimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare, formulimin e ligjeve të çdo shteti, të politikave, veprimeve të autoriteteve dhe individëve si edhe vendimeve të gjykatave. DUDNJ, në nenin 1, nënvizon se: “*Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta ...*”. Neni 2/1 parashikon se secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh

përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Në nenin 7 kemi “*të drejtën për barazi përpara ligjit*”, ku parashikohet shprehimisht se: “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabartë nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t’u mbrojtur barabartë kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë*”.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Ky pakt, i ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991¹, parashikon parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtën për mbrojtje të barabartë nga ligji, pa asnjë diskriminim. Ky pakt ka sanksionuar në përmbajtjen e tij se: “*Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtetë tjetër*”.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Shqipëria e ka ratifikuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në vitin 1991². Ky pakt ka sanksionuar detyrimin e shteteve palë për të garantuar ushtrimin e të drejtave të shprehura në të, pa asnjë diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë, lindjes, ose ndonjë statusi tjetër.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara³ (KDPAK) është miratuar në 13 Dhjetor 2006 dhe ka hyrë në fuqi me 3 Maj 2008. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2012⁴. Bashkimi Evropian e ka ratifikuar këtë Konventë në Dhjetor të vitit 2010. KDPAK ndalon diskriminimin ndaj kujt do për shkak të aftësisë së kufizuar, duke marrë në konsideratë faktin që diskriminimi pengon njerëzit të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Konventa parashikon edhe hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ndaluar diskriminimin de facto dhe forma diskriminuese që mund të shfaqen në të ardhmen, si dhe për të promovuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta me të tjerët. Ndalimi i diskriminimit, përveç se një e drejtë e veçantë, është edhe një nga parimet bazë të Konventës që udhëheq interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të tjera të mbrojtura në të.

Dispozitat e tjera shpjegojnë çfarë përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar në fushat e përkatëse, si dhe masat, përfshirë edhe ato pozitive, për të arritur barazinë në praktikë. Konventa sqaron se këto masa pozitive nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese. Po kështu, kuadri kundër diskriminimit plotësohet edhe nga Nenet 6 dhe 7, që kanë të bëjnë me masat anti diskriminuese për fëmijët dhe gratë me aftësi të kufizuara.

¹ Ligji Nr. 7510 date 08.08.1991.

² Ligji Nr. 7511 date 08.08.1991.

³ Convention on the Rights of Persons with Disabilities.

⁴ Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave⁵ (CEDAW), u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 18 Dhjetor 1979 dhe hyrë në fuqi më 1981. Shqipëria ka ratifikuar CEDAW-n në vitin 1993⁶. Ndërsa Protokollin Fakultativ i Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, i vitit 1999 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2000, është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh., në vitin 2003⁷. Në preambulën e saj, Konventa ka përcaktuar se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbim të vendeve të tyre dhe njerëzimit, Konventa ka përcaktuar në nenin 1 të saj kuptimin e termit “*diskriminim ndaj grave*” si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë, ose të shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

Në këtë Konventë sanksionohet mbrojtja nga diskriminimi ndaj grave nëpërmjet masave të përkohshme të veçanta që synojnë përshtetimin de facto të barazisë midis burrave dhe grave; si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave me qëllim që t’i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fusha të ndryshme si: në jetën politike dhe publike të vendit; në fushën e arsimit; në fushën e punësimit; për të parandaluar diskriminimin ndaj grave për shkaqe martesore apo amësie, dhe për të siguruar të drejtën e tyre efektive për punë; në fushën e kujdesit shëndetësor për t’u siguruar, mundësitë për të përfituar shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit familjar; në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare.

Konventa për dhunën dhe ngacmimin, 190, është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me Ligjin Nr. 13/2022. Qëllimi i kësaj Konvente është të mbrojtë punëtorët dhe personat e tjerë në botën e punës, duke përfshirë punonjësit, siç përcaktohen në legjislacionin dhe praktikën kombëtare, si dhe personat që punojnë pavarësisht nga statusi i tyre kontraktues, personat në trajnim, duke përfshirë praktikantët dhe fillestarët, punëtorët, punësimi i të cilëve ka përfunduar, vullnetarë, punëkërkues dhe aplikantë për punë dhe individë që ushtrojnë autoritetin, detyrat ose përgjegjësitë e një punëdhënësi. Kjo Konventë zbatohet për të gjithë sektorët, qoftë privatë apo publikë, si në ekonominë formale, edhe në atë joformale, dhe qoftë në zonat urbane apo rurale.

Me ratifikimin e saj shteti shqiptar, merr përsipër detyrimin për të miratuar ligje, rregullore dhe politika që garantojnë të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim në punësim dhe profesion, duke përfshirë për punëtorët femra, si dhe për punëtorët dhe personat e tjerë që i përkasin një ose më shumë grupeve të prekshme ose grupeve në situata të prekshmerisë që preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna dhe ngacmimi në botën e punës. Njëkohësisht duhet të garantojë që dispozitat mbi dhunën dhe ngacmimin në ligjet, rregulloret dhe politikat kombëtare, marrin parasysh instrumentet e barazisë dhe mosdiskriminimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, duke përfshirë Konventën për Shpërblimin e Barabartë (Nr. 100) dhe Rekomandimin (Nr. 90), 1951 dhe

⁵ Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women.

⁶ Ligji Nr. 1769, date 09.11.1993.

⁷ Ligji Nr. 9052, date 17.04.2003.

Konventën për Diskriminimin (Punësimi dhe Profesionet) (Nr. 111) dhe Rekomandimin (Nr. 111), 1958, si edhe instrumente të tjera përkatëse.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e miratuar në vitin 1966 dhe hyrë në fuqi në vitin 1969, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993⁸, ka përcaktuar në Preambulën e saj se: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe se kanë të drejtë të mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji kundër çdo diskriminimi si dhe kundër çdo nxitjeje për diskriminim”*.

Sipas kësaj Konvente, *“diskriminimi racial”* nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërroje ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike. (neni 1).

Konventa përcakton detyrimin e shteteve palë të ndalojë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave: Të drejtat politike ku përfshihen kryesisht: e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike. Të drejtat e tjera civile ku përfshihen kryesisht: e drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti; e drejta shtetësisë; e drejta e martesës dhe e zgjedhjes së bashkëshortit/bashkëshortes; e drejta e pronës; e drejta e trashëgimisë; e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar; e drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore.

Të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore ku përfshihen kryesisht: e drejta e punës; e drejta e krijimit të sindikatave dhe e anëtarësimit në to; e drejta e strehimit; e drejta e trajtimit shëndetësor, sigurimit shoqëror dhe shërbimeve sociale; e drejta e arsimit dhe përgatitjes profesionale etj.(neni 5).

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC)⁹, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 Nëntor 1989, ka hyrë në fuqi në vitin 1990. Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1992¹⁰.

Konventa garanton parimin e barazisë dhe përcakton detyrimin e shteteve pale që të ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjor ose të anëtarëve të familjes së tij.

Gjithashtu, Konventa përmban edhe 2 Protokolle Opsional, të ratifikuar nga R.Sh. Protokollin Opsional i Konventës së OKB-së *“Për Të Drejtat e Fëmijëve”*, Për Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet të Armatosur¹¹ dhe Protokollin Opsional i Konventës Së OKB-së *“Për të Drejtat e Fëmijëve”*, Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë¹².

⁸ Ligji Nr. 7768, datë 09.11.1993.

⁹Convention on the Rights of the Child.

¹⁰Ligji datë 27.02.1992.

¹¹Ratifikuar me Ligj Nr. 9833, datë 22.11.2007.

¹²Ratifikuar me Ligj Nr. 9834, datë 22.11.2007.

Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës

Sipas standardeve të Këshillit të Evropës, legjislacioni për trajtimin e barabartë duhet të ndalojë diskriminimin, ngacmimin dhe viktimizimin për shkaqe të tilla, si gjinia ose seksi, origjina racore ose etnike, aftësitë e kufizuara, orientimi seksual, mosha dhe feja ose besimi, midis të tjerash, të ofrojë të drejta të zbatueshme në këto fusha, dhe të krijojë struktura kombëtare për promovimin e barazisë. Të njëjtat standarde identifikojnë që fusha e legjislacionit të trajtimit të barabartë mbulon më së shumti punësimin, trajnimin dhe formimin profesional, por mund të përfshijë gjithashtu edhe fusha jashtë punës, si aksesit në mallra dhe shërbime, strehimi, arsimit, mbrojtja sociale, kujdesi shëndetësor ose përparësi të tjera sociale.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹³ është nënshkruar në Romë me 4 Nëntor 1950 dhe hyri në fuqi me 3 Shtator të vitit 1953. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në vitin 1996¹⁴.

Standardet e Këshillit të Evropës bazohen në nenin 14 të KEDNJ, “*ndalimi i diskriminimit*”, në përmbajtjen e të cilit parashikohet se: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*”. Siç mund të konstatohet, në këtë nen mbrojtja nga diskriminimi gjen zbatim në lidhje me ato të drejta dhe liri themelore të parashikuara në Konventë dhe në Protokollin e saj shtesë.

Protokolli 12 (2000) i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, i cili është ratifikuar nga Shqipëria në Nëntor 2004 dhe ka hyrë në fuqi me 5 Prill 2005, e zgjeron fushën e ndalimit të diskriminimit duke garantuar trajtim të barabartë lidhur me gëzimin e çdo të drejte të parashikuar me ligj (përfshirë të drejtat sipas legjislacionit kombëtar).

Në nenin 1 “*ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit*”, sanksionohet në mënyrë të shprehur se: “*Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*” dhe se “*Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1*”.

Karta Sociale Evropiane e rishikuar¹⁵, e nënshkruar më 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh-së në vitin 2002, sanksionon parimin e barazisë dhe parimin e mosdiskriminimit. Karta Sociale Evropiane e vitit 1961/1965 përbën një traktat kryesor evropian dhe plotëson Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale.

Karta Sociale Evropiane e rishikuar, e nënshkruar në vitin 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2002, po zëvendëson gradualisht Kartën Sociale Evropiane.

¹³KEDNJ u nënshkrua në nëntor 1950 dhe hyri në fuqi në shtator 1953 pas ratifikimit të dhjetë të saj nga Dukati i Luksemburgut.

¹⁴Ligji Nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, i ndryshuar.

¹⁵Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002.

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 1999¹⁶, ka qëllim themelor sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo konventë ndalon çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare, duke përcaktuar detyrimin e shteteve nënshkruese të kësaj Konvente për t'u garantuar personave që i përkasin pakicave, të drejtën e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë nga ligji.

Konventa Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje¹⁷ është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Qëllimi i kësaj konvente është të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; duke kontribuar ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimit të barazisë thelbësore midis burrave dhe grave; ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.

Konventa garanton të drejtat themelore, barazinë dhe mosdiskriminimin e grave nëpërmjet parashikimit të masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

Standardet e Bashkimit Evropian

Standardet më gjithëpërfshirëse në lidhje me mosdiskriminimin janë zhvilluar në nivelin e Bashkimit Evropian. Ato përbëhen nga një sërë burimesh të ndryshme ligjore që përcaktojnë format e ndryshme të diskriminimit dhe i detyrojnë shtetet anëtare t'i zbatojnë këto standarde në kornizën e tyre legjislative, si dhe në praktikën gjyqësore. Këto njohje kanë çuar në zhvillimin e disa standardeve legjislative për mbrojtjen nga diskriminimi, me vëmendje të veçantë tek ata persona dhe grupe që konsiderohen të jenë më të prekshëm sesa të tjerët.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) i dedikon një kre/titull të tërë “barazisë”. Neni 20 parashikon barazinë përpara ligjit dhe Neni 21 i saj kërkon ndalimin e çdo diskriminimi për *çdo shkak, të tillë si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionimi politik apo ndonjë mendim tjetër, anëtarësia e një pakice kombëtare, pasuria, lindja, mosha ose orientimi seksual*.

Të drejtat dhe parimet e sanksionuara në Kartë duhet të zbatohen në praktikën ligjore kombëtare në rastet kur:

- Legjislacioni që zbaton të drejtën e BE-së ka rëndësi (si instrument interpretimi).
- Legjislacioni kombëtar konsiderohet se ndërhyt me të drejtën e BE-së.
- Autoritetet e BE-së kanë vepruar në zbatim të së drejtës së BE-së.

¹⁶Ligji Nr. 8496, date 03.06.1999.

¹⁷Ligji Nr. 104 date 11.08.2012 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”.

Neni 19 i **Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian** (TFEU) i ka mundësuar Bashkimit Evropian të marrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, ose orientimit seksual. Kjo kompetencë ka çuar në miratimin e:

- Direktivës 2000/43/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”; (Direktiva për racën)
- Direktivës 2000/78/KE “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës”; (Direktivën për barazinë në punësim)
- Direktivave 2004/113/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”; 2006/54/KE “Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës” 2010/41/BE (Direktivat për barazinë gjinore).
- Direktivës Nr. 2024/1500 datë 29.05.2024 të Këshillit të Bashkimit Evropian “Mbi standardet për organet e barazisë në fushën e trajtimit të barabartë dhe mundësive të barabarta midis grave dhe burrave në çështjet e punës dhe profesionit, si dhe ndryshimi i Direktivave 2006/54/EC dhe 2010/41/EU”. Qëllimi i kësaj Direktive është të përcaktojë kërkesat minimale për funksionimin e organeve për promovimin e trajtimit të barabartë ("organeve të barazisë") për të përmirësuar efektivitetin e tyre dhe për të garantuar pavarësinë e tyre, me qëllim të forcimit të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, siç rrjedh nga Direktivat 2006/54/KE (3) dhe 2010/41/BE (4) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.
- Direktivës Nr. 2024/1499 datë 07.05.2024 të Këshillit të Bashkimit Evropian “Mbi standardet e organeve të barazisë në fushën e trajtimit të barabartë të personave, pavarësisht racës ose etnisë, trajtimi i barabartë në çështjet e punësimit dhe profesionit të personave pa dallim feje, aftësie të kufizuar, moshe ose orientimi seksual, trajtimi i barabartë ndërmjet grave dhe burrat në çështjet e sigurimeve shoqërore dhe në aksesin në fushën e të mirave dhe shërbimeve, dhe ndryshimin e Direktivave 2000/43/EC dhe 2004/113/EC”. Qëllimi i kësaj direktive është përcaktimi i kërkesave minimale për funksionimin e organeve të barazisë për promovimin e trajtimit të barabartë, me qëllimin për të përmirësuar efektivitetin e tyre dhe për të garantuar pavarësinë e tyre, në mënyrë që të forcohet zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë sikurse rrjedh nga Direktivat e Këshillit 79/7/EEC, 2000/43/EC, 2000/78/EC dhe 2004/113/EC.

Direktivat për Trajtim të Barabartë e Bashkimit Evropian përcaktojnë standardet minimale në legjislacionin për trajtimin e barabartë. Ato ndalojnë diskriminimin, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, viktimizimin në punësim dhe profesion për shkak të përkatësisë gjinore, origjinës racore ose etnike, orientimit seksual, fesë ose besimit dhe aftësisë së kufizuar; dhe në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për shkak të përkatësisë gjinore dhe origjinës racore ose etnike.

Direktiva për Racën ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike në fushën e punësimit, arsimit, aksesit dhe furnizimit me mallra dhe shërbimeve që janë në dispozicion të publikut, duke përfshirë strehimin, mbrojtjen sociale, përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, avantazhet sociale, etj.

Direktiva për Barazinë në Punësim ndalon diskriminimin në bazë të fesë dhe besimit, orientimit seksual, moshës, aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit.

Direktivat për Barazinë Gjinore synojnë eliminimin e diskriminimit në fushën e punës, duke përfshirë vetëpunësimin dhe aksesin në mallra dhe shërbime në bazë të gjinisë. Praktika gjyqësore e GJED-së tregon se këtu përfshihet edhe identiteti gjinor.

2. Kuadri Ligjor Shqiptar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon, në pjesën e dytë të saj, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si vlera që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik shqiptar. Këto të drejta dhe liri janë të ndara në: liri dhe të drejta vetjake; liri dhe të drejta politike; si dhe liri dhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Në nenin 18/1 të Kushtetutës është parashikuar parimi i barazisë në të cilin sanksionohet se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”* dhe në nenin 18/2, *“Parimi i mosdiskriminimit”*, në përmbajtjen e të cilit sanksionohet se: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”* dhe se *“Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”*.

Në vitin 2016, Kuvendi ka miratuar me unanimitet amendimet kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, një nga të cilët paraqet ndryshim në kompetencat e KMD. Konkretisht, është amendimi Kushtetutës i cili sanksionon të drejtën e KMD për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, përmes Ligjit Nr. 76/2016, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”*, duke sanksionuar, në nenin 134, se: *“Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: ... (e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta”*.

Ligji Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili pas dekretimit nga Presidenti i Republikës dhe botimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010. Ky ligj erdhi me propozim të një grupi deputetësh dhe është një hap konkret në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nën frymën e dokumenteve ndërkombëtare dhe njëkohësisht, një hap konkret i përmbushjes së standardeve të anëtarësimit në BE.

Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është në përputhje të plotë me Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e barazisë dhe konkretisht është përafër plotësisht me: Direktivën 2000/43/KE për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”*, Direktivën 2000/78/KE për *“Përcaktimin e një kuadri të 12 përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*, Direktivën 2004/113/KE për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”* dhe Direktivën 2006/54/KE për *“Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimin dhe marrëdhëniet gjatë punës”*.

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim si dhe gjatë periudhës së ushtrimit të marrëdhënieve të punës, në fushën e arsimit, si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve.

Me qëllim zbatimin efektiv të këtij ligji, është themeluar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri shtrin kompetencat jo vetëm në sektorin publik, por edhe në sektorin privat. Në nenin 39, ligji ka parashikuar detyrimin e Këshillit të Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të këtij ligji. Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ka 9 vite nga miratimi dhe hyrja në fuqi e tij dhe këto akte nënligjore nuk janë nxjerrë ende.

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë¹⁸, ndalon çdo formë diskriminimi, të parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion. Neni 9/2, përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët¹⁹.

Përshtatja e arsyeshme e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar ose persona të ndodhur në kushte të tjera, të përmendura në pikën 2, të këtij neni është përcaktuar si detyrim për punëdhënësin. Mohimi i përshtatjes së arsyeshme përbën diskriminim.

Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:

- a) mundësinë për punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë;
- b) qasjen në të gjitha llojet dhe në të gjitha nivelet e orientimit profesional, trajnimit profesional, trajnimit dhe ritrajnimit të avancuar profesional, përfshirë edhe përvojën e punës në praktikë;
- c) kushtet e punës dhe punësimin, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën;
- a) anëtarësimin dhe aktivizimin në organizata sindikale dhe organizata të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruara nga këto organizata.

Ndryshimet e rëndësishme të vitit 2015, referojnë në ndjekjen e procedurave të ankimit, të përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion dhe në të gjitha procedurat e ankimit lidhur me sa më lart, zbatohet parimi i zhvendosjes së barrës së provës.

¹⁸Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, ndryshuar në vitin 2015.

¹⁹Ndryshuar me Ligjin Nr. 136/2015, datë 05.12.2015.

Në Kodin e Punës, parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit parashikohet edhe në dispozita të tjera si: Ndalimi i përdorimi të punës së detyruar si masë diskriminimi racial, shoqëror, kombëtar ose fetar (neni 8, prg. 2, germa (e); Barazia në shpërblim (neni 115); Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme (neni 146) ku konkretisht parashikohet se: *“1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*;

Ndalimi i diskriminimit ndaj përfaqësuesve të sindikatës (neni 181/3) dhe mos dhënia e pëlqimit nga përfaqësuesit e organizatës sindikale për zgjidhjen e kontratës, nëse zgjidhja e kontratës shkel parimin e trajtimit të barabartë (neni 181/4); Ndalimi i diskriminimit për shkak të pjesëmarrjes ose jo në grevë (neni 197/4); Trajtimi i barabartë (neni 149/2) lidhur me përfundimin e kontratave me afat të caktuar, ku përcaktohet shprehimisht se: *“Punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të caktuar nuk mund të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të pacaktuar, lidhur me kushtet e punësimit, trajnimit dhe mundësive të karrierës në punë. Punëmarrësit me kontratë pune me afat të caktuar gëzojnë të njëjtat të drejta, përpjesëtimisht, si punëmarrësit me kontratë me afat të pacaktuar.”* etj.

Kodi Penal²⁰ ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vitin 2013 lidhur me mbrojtjen e komunitetit LGBTI. Konkretisht, Parlamenti shqiptar miratoi, si rrethanë rënduese për dënimin e një krimi, përfshirjen e orientimit seksual si shkak të ri, kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me këtë shkak, (neni 50/j). Konkretisht, është parashikuar se: *“Rëndojnë dënimin rrethanat që vijojnë: j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.”*

Shkelja e barazisë së shtetasve (neni 253) parashikon dënimin e kryerjes për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji. Me amendimet e vitit 2013, u shtua orientimi seksual dhe identiteti gjinor²¹.

Dispozita në lidhje me nxitjen e urrejtjes ose grindjeve (neni 265) u ndryshua gjithashtu në vitin 2013 duke shtuar orientimin seksual si shkak të mbrojtur nga diskriminimi, si dhe duke zgjeruar fushëveprimin e tij me aktin e përhapjes dhe shpërndarjes së çdo përmbajtjeje që nxit urrejtje ose grindje. Sipas kësaj dispozite, *“Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet”*. Nevoja për ndryshime në Kodin Penal është ende prezente, Komisioneri ndër vite ka rekomanduar heqjen e termit *“marrëdhënie homoseksuale”* që përmendet si në titull ashtu edhe në përmbajtje të neneve 100 deri 107 të Kodit Penal, Seksioni VI, ku parashikohen krimet seksuale. Shprehja *“marrëdhënie homoseksuale”* përfshin si marrëdhëniet seksuale midis individëve të të njëjtës gjini ashtu edhe atyre të gjinive të ndryshme. Për këtë arsye, marrëdhënia juridike apo vlera shoqërore që

²⁰Ndryshuar nga Ligji Nr. 144/2013; Ndryshuar në vitin 2017.

²¹Në këtë dispozitë janë shtuar fjalë, me Ligjin Nr. 144/2013, datë 02.05.2013.

kërkohet të mbrohet nga legjislacioni penal nëpërmjet këtyre veprave penale, garantohet më së miri pa referuar në përmbajtjen e neneve të mësipërme termin *“marrëdhënie homoseksuale”*.

Kodi i Familjes²². Statusi ligjor i një çifti lidhet me një sërë implikimesh ligjore në fusha të ndryshme të jetës. Në Shqipëri, martesat është ende e kufizuar tek një burrë dhe një grua të moshës 18 vjeç e sipër. Martesat e të njëjtit seks nuk janë ende të pranuar. Megjithatë, në jetën e përditshme, të drejtat që rrjedhin nga bashkëjetesa janë të rëndësishme për dhënien me qira të një banese, për kontratat e sigurimit, për përfitimet sociale etj. Megjithatë, bashkëjetesa në Kodin e Familjes që është në fuqi në Shqipëri, përkufizohet si një bashkim faktik midis një burri dhe një gruaje që jetojnë si çift, të cilët jetojnë përbashkërisht në një jetë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme.

Kodi i Procedurave Administrative²³ parashikon si një nga parimet e përgjithshme parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 17), sipas të cilit: *“1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë” dhe “3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”*.

Lidhur me mjetet e kërkimit të provës në kuadër të hetimit administrativ, Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit (neni 82, paragrafi 2). Konkretisht, ky Kod ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit, duke sanksionuar shprehimisht se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Kodi i Procedurës Civile. Ndryshimet e fundit që i janë bërë Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, të miratuara përmes Ligjit Nr. 38/2017, datë 30.03.2017 dhe botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 98, datë 5 Maj 2017, kanë hyrë në fuqi në Nëntor 2017. KMD konstaton se edhe me këto ndryshime, nuk është ndërmarrë ndonjë nismë për të ndryshuar barrën provës gjatë procesit civil, në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, një kërkesë kjo e direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Në përputhje me to, Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, në Kreun VI *“Procedurat përpara gjykatës”*, ka parashikuar zhvendosjen/shpërndarjen e barrës së provës në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, ndryshe nga parimi i përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë. Bazuar në këto standarte, KMD në mënyrë të përsëritur ka dërguar rekomandime për zhvendosjen e barrës së provës në procesin civil, kur një çështje ka të bëjë me pretendim diskriminimi, të cilat nuk janë marrë parasysh. Parimi i barrës së provës parashikohet nga Kodi i Procedurës Civile në nenin 12, ku thuhet: *“Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj”*. Pra, nëse normalisht detyrimin për të provuar pretendimet duhet t’u kishte

²²Kodi i Familjes i Shqipërisë, Ligji Nr. 9062, miratuar në maj, 2003.

²³Miratuar me Ligjin Nr. 44/2015, Fletore Zyrtare Nr. 87/2015.

paditësi, sipas legjislacionit të BE-së në çështjet e diskriminimit, në momentin që paditësi vërteton rastin prima facie - “në pamje të parë”²⁴, atëherë i kërkohet të paditurit, që të paraqesë prova se ai/ajo nuk e ka diskriminuar paditësin, duke rrëzuar prezumimin faktik se ka patur diskriminim.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, e shtrin zbatimin e tij si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Me Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Kodin e Procedurave Administrative (Kodi i ri), dhe ndryshimet e fundit në Kodin e Punës, është harmonizuar dhe rregulluar shpërndarja e barrës së provës lidhur me çështjet e diskriminimit në sektorin publik. Me qëllim rregullimin dhe harmonizimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit edhe në sektorin privat, është e nevojshme që një parashikim i tillë të shtohet edhe në Kodin e Procedurës Civile.

Kodi i Procedurës Civile është ligji bazë për procedurat që gjykatat duhet të respektojnë gjatë veprimtarisë së tyre, duke e bërë këtë Kod me rëndësi nga këndvështrimi i garantimit të mbrojtjes efektive nga diskriminimi. Kodi i Procedurës Civile, duke qenë në një nivel më të lartë në hierarkinë e normave, se sa ligjet e miratuara me shumicë të thjeshtë, përfshirë këtu Ligjin Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, e bën problematike zbatimin e këtij standarti. Kështu, gjykatat gjenden midis kërkesave të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i cili ka parashikuar zhvendosjen e barrës së provës, në përputhje me legjislacionin e BE, dhe Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë pretendimin e saj.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar me Ligjin Nr. 37/2017, datë 30 Mars 2017, ka hyrë në fuqi me 1 Janar 2018. Ky Kod përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta (neni 1).

Në Kreun II të Kodit parashikohen Parime të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku, ndër të tjerë, sanksionohet “Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi”, neni 11, i cili parashikon shprehimisht se: “1. Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit”, dhe “2. Të drejtat për të miturin, të parashikuara në këtë Kod, mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni”.

Kështu, mbrojtja nga diskriminimi i çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit, garantohet për të gjitha shkaqet e diskriminimit të listuara me ligj por jo shteruese, ç’ka është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 1 të Ligjit

²⁴ Paditësi sjell fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi në mungesë të një shpjegimi të përshtatshme.

Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Gjithashtu, kjo mbrojtje garantohet për të gjitha format e diskriminimit, citohet në Kod, duke referuar në parashikimet e nenit 3 të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi“, i ndryshuar, ku parashikohen ato, sipas përkufizimeve përkatëse.

Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, është miratuar në Shkurt të vitit 2017 dhe ka hyrë në fuqi tre muaj pas miratimit, pra në Qershor të vitit 2017. Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës (neni 1). Bazuar në këtë ligj, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.
2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.
3. **Barazia dhe mosdiskriminimi.**
4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t’i krijuar kushtet e jetesës, për t’i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.
5. Ndarja e përgjegjësive ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.
6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.
7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuara me ligj.
8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.
9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.
10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor. (neni 5, “parime të përgjithshme”).

Me këtë ligj, një rregullim i veçantë parashikohet për fëmijët me aftësi të kufizuar (neni 32) dhe atyre që i përkasin pakicave kombëtare (neni 33).

Ligji Nr. 129/2021 “Për statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, rregullon kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, si dhe i të drejtave e përfitimeve që rrjedhin nga ky status.

Qëllimi i këtij ligji është marrja në mbrojtje dhe në përkujdesjen e shtetit të fëmijës, njëri ose të dy prindërit e të cilit apo, në mungesë të tyre, personi i ngarkuar ligjërisht me kujdestarinë e tij kanë humbur jetën në kushtet e përcaktuara nga Ligji “Për statusin ‘Dëshmor i Atdheut’”, në përpjekje për mbrojtjen e pronës publike apo mbrojtjen e jetës së individit, si rezultat i një akti vetëmohimi ose patriotizmi, për shkak të plagëve të marra apo të sëmundjeve të shkaktuara si pasojë e kryerjes me përgjegjshmëri të detyrës dhe ushtrimit të profesionit në kushte të jashtëzakonshme apo të fatkeqësisë natyrore. Ky ligj garanton mirëqenien dhe zhvillimin e jetës së fëmijës nëpërmjet ndihmës dhe përkujdesjes efektive të shtetit, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Ligji nr. 64/2025, datë 6.11.2025, rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës publike dhe private për arritjen e barazisë gjinore plotësisht dhe në mënyrë efektive, ligjrisht dhe në praktikë, si dhe trajtimit të barabartë, pavarësisht përkatësisë gjinore, përmes mbrojtjes, mundësive të barabarta për ushtrimin e të drejtave dhe gëzimin e të mirave dhe shërbimeve, pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe ndihmesës në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. Qëllimi i këtij ligji është: a) të sigurojë të drejtën e çdo individi për barazi gjinore dhe për mbrojtje efektive nga diskriminimi gjinor dhe pabarazitë gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë në jetën publike dhe private, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi; b) të përcaktojë për të gjitha fushat e veprimtarisë, përfshirë edhe fushat sipas këtij ligji, masat e përgjithshme dhe të veçanta të bazuara në nevojat dhe prioritetet e ndryshme gjinore, me qëllim përmirësimin, nxitjen dhe realizimin e barazisë gjinore në shoqëri; c) të përcaktojë autoritetet përgjegjëse për zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri dhe detyrimet e tyre për arritjen e barazisë gjinore, monitorimin dhe vlerësimin e arritjes së saj. Ky ligj bazohet në parimin e barazisë, të mosdiskriminimit dhe në parimet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, Konventa 190 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi dhunën dhe ngacmimin nëbotën e punës”, si dhe të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Në këtë ligj, disa nga termat kanë këto kuptime: “Barazi gjinore” janë të drejta, përgjegjësi, mundësi, pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre, në të gjithat fushat e jetës, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfutur njëlloj nga arritjet dhe zhvillimet e shoqërisë, në respektim të dallimeve biologjike, shoqërore, kulturore, interesave, nevojave dhe prioriteteve të grupeve të ndryshme sipas përkatësisë gjinore; “Diskriminim për shkak të gjinisë” është çdo dallim, përjashtim, preferencë ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin në mënyrë të barabartë nga secila gjini të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile, të aksesit në drejtësi dhe në çdo fushë tjetër.; “Diskriminim ndërsektorial” është formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të atillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.

Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. (neni 1). Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë dhe të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet. (neni 2). Ndër të tjera, ky ligj bazohet edhe në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit.

Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë parashikohet në nenin 6 të këtij ligji, sipas të cilit: “1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i

bëhet, i është bërë ose do t'i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohej”.

Gjithashtu, ky ligj parashikon në pjesë të veçanta, mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës; në arsim dhe kualifikim; dhe në media. Organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e barazisë gjinore, të parashikuar me këtë ligj bashkë me detyrat përkatëse janë: Këshilli i Ministrave; Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore; Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore (ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore); dhe organet e qeverisjes vendore.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ka parashikuar si kompetencë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në nenin 32, pika dh), monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme, si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, është miratuar me datë 13.10.2017 dhe ka hyrë në fuqi në Nëntor 2017. Sipas objektit të tij, të parashikuar në nenin 1, ky ligj rregullon ushtrimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar me Ligjin Nr. 8496, datë 03.06.1999, dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të pakicave kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit. (neni 2, pika 1).

Në nenin 8, thuhet se:

1. “Ndalohet çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare.
2. *Institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme:*
 - a) *për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës;*

- b) për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional;
- c) për të forcuar dialogun ndërkulturor;
- d) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional.

3. Masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi”.

Ky ligj parashikon gjithashtu njohjen e pakicave kombëtare, sipas një procedure të caktuar dhe liston të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare në R.Sh. Bazuar në këtë ligj, është ngritur Komiteti për Pakicat Kombëtare, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi. Lidhur me këtë ligj janë miratuar vetëm një pjesë e akteve nënligjore, të parashikuara nga vetë Ligji. Mos miratimi i plotë i akteve nënligjore i bën disa nga segmentet e ligjit jo efektiv, duke lënë të pa zbatuara një numër të drejtash të rëndësishme të pakicave.

Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Parimet e ndihmës juridike, sipas nenit 4 të këtij ligji, përcaktojnë se, dhënia e ndihmës juridike bazohet, ndër të tjera, në parime si: akses i barabartë i individëve në ndihmën juridike; barazi dhe mosdiskriminim i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike si dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave vulnerabël.

Ky ligj, ka parashikuar, në nenin 11, kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, sipas të cilit: Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- a) viktimave të dhunës në familje;
- b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesit shoqëror;
- d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor; ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;

- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitim të zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- h) personave, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, ka për qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes.

Në këtë ligj jepen përkufizime të termave si “*Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara*”, “*Mohim i përshtatjes së arsyeshme*” apo edhe “*Përshtatje e arsyeshme*” të cilat janë në përputhje me përkufizimet e Ligjit Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

Në nenin 4 përcaktohet shprehimisht se, parimet bazë të këtij ligji, janë, ndër të tjera: a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohej se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë; b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta.

Në nenin 16, “*Monitorimi*”, paragrafi 2, parashikon se: “*Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.*

Ligji Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”²⁵, sipas objektit të tij në nenin 2, përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Në nenin 3 jepen përkufizimet, ku termi “*diskriminim*” përkufizohet në përputhje me Ligjin Nr. 10 221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, i ndryshuar. Ndër parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor parashikohet, sipas nenit 5/1, germa (a), trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.

Neni 8 parashikon mbrojtjen nga diskriminimi, sipas të cilit “*Personave me çrregullime të shëndetit mendor u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në këtë fushë*”.

Ky ligj është në përgjithësi në përputhje me nenin 25 dhe nene të tjera të KPDAK për sa i përket shërbimeve që parashikon për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e të drejtave

²⁵ Ndryshuar me Ligjin Nr. 61/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 44/2012, datë 19.4.2012 “Për shëndetin mendor”.

të tyre. Përrjashtim bën neni 9 që parashikon heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe nenet 21-25 mbi trajtimin e pavullnetshëm, të cilat nuk janë në përputhje me KPDAK.

Ligji Nr. 7889/1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, parashikon se Shoqëria dhe shteti marrin ne mbrojtje invalidët, ne mënyrë qe ata te marrin pjese ne jetën shoqërore njëlloj si te tjerët, t’u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për te jetuar ne mënyrë dinjitoz, te kenë kushte banimi, te shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, te kenë një pune te përshtatshme, si dhe t’u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese (neni 2). Ky ligj parashikon disa lehtësi për individët që gëzojnë statusin e invalidit të punës, si: pajisjen me:

- a) mjete lëvizëse përfshi edhe autovetura dhe pajisje te ndryshme ortopedike.
- b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;
- c) me mjete ndihmëse kardiake etj;

Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk lëvizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas; Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas ndërsa udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqtetas bëhet me 50 përqind të vlerës se biletës; Invalidët favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit e të rikualifikimit profesional, si dhe ndjekjen e shkollave të larta.

Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar. Bazuar në nenin 1 të tij, përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjes’shëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësore janë të paafte për punë në kushte normale. Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta (neni 3).

Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar. Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit. (neni 1).

Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive (neni 3). Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes (neni 4). Edhe ky ligj parashikon disa lehtësi dhe përfitime për personat që gëzojnë këtë status.

Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”²⁶, i cili ka shfuqizuar Ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale.

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike,

²⁶ Ndryshuar me Ligjin Nr. 79/2023, datë 12.10.2023.

- zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore;
- b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre; c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura;
- c) mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

Ligji parashikon se një ndër parimet bazë, në bazë të të cilit funksionojnë programet e asistencës sociale është edhe parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit të çdo individi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”²⁷. Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. (neni 1).

Ligji përcakton llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij. (neni 2)

Ligji jep një përkufizim të diskriminimit, që është në përputhje dhe harmoni me Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar (neni 3, pika 19). Gjithashtu, ligji parashikon se, shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore, ku ndër të tjera, edhe parimin e mosdiskriminimit. Sipas kësaj të fundit, në nenin 4 pika (ë) përcaktohet se, ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligj Nr. 22/2018 “Për strehimin social”²⁸. Ky ligj është miratuar rishtazi në maj 2018 dhe ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2018. Objekti dhe qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Në nenin 10, ligji ka parashikuar parimin e mosdiskriminimit, si një ndër parimet e politikave të strehimit, duke theksuar shprehimisht se: *“1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të*

²⁷Ndryshuar me Ligjin Nr. 99/2024, datë 12.9.2024.

²⁸ Ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuuese. 2. Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të përfutuar strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t'i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë.”

Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”²⁹. Qëllimi i këtij ligji është, nga njëra anë, parandalimi dhe goditja e korrupsionit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe nga ana tjetër, mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës. Edhe pse qëllimi i këtij ligji në vetvete ka të bëjë me parandalimin dhe goditjen e korrupsionit, nga veprimtaria e deritanishme e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka rezultuar se individët të cilët denoncojnë apo sinjalizojnë veprime korruptive të ndodhura në vendin e tyre të punës, janë përballur me situata diskriminuuese.

Për këtë arsye, vlerësojmë se rregullimi dhe mbrojtja me ligj e personave që sinjalizojnë veprime apo praktika të dyshuara korruptive, përbën një zhvillim pozitiv edhe në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”³⁰. Ligji “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në vitin 2012 ka parashikuar si shkaqe të diskriminimit edhe “*orientimin seksual*”. Neni 5/1 ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në Nenin 1 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor parauniversitar³¹.

Në nenin 5, ku parashikohet e drejta për arsimim, thuhet shprehimisht se: “1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.”

Ligji parashikon edhe parimet e përgjithshme, ku në Nenin 6/3, thuhet se: “Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral”.

Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”³², ka si qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues. Sipas këtij ligji, të burgosurit duhet të trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast ndaj të burgosurit ndalohet tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtërues. Të burgosurit duhet të

²⁹ Ndryshuar me Ligjin Nr. 150/2020 “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

³⁰ Ndryshuar me Ligjin Nr. 56/2015, datë 28.5.2015, Nr. 48/2018, datë 23.7.2018, Nr. 44/2023, datë 15.6.2023; Nr. 99/2012, datë 12.9.2024.

³¹ KMD, Raport i Veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”

³² Ndryshuar me Ligj Nr. 129 datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

trajtohen në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gratë e burgosura trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore, që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi, që dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohej trajtim i barabartë, pa diskriminim, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre kryhet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen për kategoritë e personave me çrregullime të shëndetit mendor, jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Të burgosurve me aftësi të kufizuara u garantohej të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, trajtimi pa diskriminim i çdo forme për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre, duke mbajtur parasysh standardet e legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Të burgosurit shtetas të huaj ose persona pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit duhet të ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale gjatë transferimit dhe pas lirimit.

Ligji Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Shqipëri”, në nenin 32 parashikon që shërbimet e mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi. Gjithashtu, neni 42 paragrafi 3/b parashikon se komunikimet audiovizuale tregtare nuk duhet të kenë përmbajtje që përfshijnë ose promovojnë diskriminim për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, kombësisë, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual.

Gjithashtu, sipas Seksionit 4/10 të Kodit të Udhëzimeve Etike për Transmetimet Audiovizuale të miratuara nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizuale (AMA), *informacioni i transmetimit nuk duhet të përmbajë përmbajtje diskriminuese në lidhje me shkaqe të tilla si raca, ngjyra, përkatësia etnike, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, mendimet politike, bindjet fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose sociale, ose për ndonjë shkak tjetër.*

Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”. Ky ligj rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë. Ligji përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike e private, shqiptare ose të huaja, që në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente dhe parimin e mosdiskriminimit, kryejnë aktivitete në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që kërkojnë të hyjnë, që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë.

3. Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funksonimin e KMD

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 10 221, më datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010, pas Dekretimit nga Presidenti i Republikës me Dekretin Nr. 6433, datë 24.2.2010 dhe botimit në Fletoren Zyrtare Nr. 15, datë 25 Shkurt 2010.

Në datë 15.10.2020, me Ligjin Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi””, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020, u miratuan ndryshimet ligjore në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të cilat hynë në fuqi me 18 Nëntor 2020.

Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. KMD ushtron kompetencat në tre sfera kryesore: (I) ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit përmes shqyrtimit të ankesave, kryerjes së hetimeve administrative, vendosjes së sanksioneve administrative dhe pjesëmarrje në gjykatë për çështjet civile; (II) monitorimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe (III) rritjen e ndërgjegjësimit.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.


Zyra e KMD

Bazuar në nenin 22, pika 2, të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Zyra ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin me vendimin Nr. 34, datë 20.05.2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, miratoi strukturën organizative të Zyrës së Komisionerit. Me këtë strukturë organizative, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka funksionuar me 4 drejtori dhe 1 sektor, nga viti 2010 kur është themeluar si institucion deri në vitin 2018.

Me Vendimin Nr. 88, datë 23.07.2018, të Kuvendit të Shqipërisë, është vendosur ndryshimi i strukturës dhe organikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në bazë të këtyre ndryshimeve është rritur numri i stafit të Zyrës, nga 23 punonjës që ishin me strukturën e vjetër në 34 punonjës me strukturën e re. Në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe anti-diskriminimit”, KMD pilotoi 3 zyra rajonale në qytetet Korçë, Gjirokastrë dhe Shkodër. Me strukturën e re, tre zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytetet Korçë, Fier, Shkodër, bëhen zyra të përhershme. Në bazë të strukturës së re, me qëllim forcimin e kapaciteteve monitoruese të KMD, janë parashikuar specialist të posaçëm për monitorim dhe raportim.

Struktura organizative e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Kompetencat e Komisionerit

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, 2006/54/KE, në nenin 20 të saj, lidhur me organet e barazisë, parashikon detyrimin për vendet anëtare të ngritjes së organeve të posaçme në nivel kombëtar për promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të individëve.

Në këtë nen parashikohen, gjithashtu, edhe kompetencat kryesore që duhet të gëzojnë këto organe të barazisë dhe, konkretisht:

- të ofrojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;
- të kryejnë sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin;
- të publikojnë raporte dhe të japin rekomandime për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Kompetencat e KMD-së janë parashikuar në nenin 32 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Sipas parashikimeve të këtij neni, KMD-ja gëzon një sërë kompetencash që shkojnë përtej parashikimeve të Direktivës 2006/54/KE.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin përkatës dhe që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim, përfshijnë:

- shqyrtimin e ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;
- shqyrtimin e ankesave nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;

- kryerjen e hetimeve administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;
- vendosjen e sanksioneve administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;
- të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar dhe që kanë për qëllim kryerjen e sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin, përfshijnë:

- kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin;
- monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe Ligjit “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.

Kompetenca të KMD-së që kanë për qëllim publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin, përfshijnë:

- adresimin e rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;
- publikimin e raporteve dhe përgatitjen e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- kontribuimin në raportimet dhe, sipas rastit, prezantimin e raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin e mësipërm dhe që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, përfshijnë:

- nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara;
- adresimin drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- zhvillimin e dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare;
- zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

IV. VEPRIMTARIA NË MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE PROMOVIMI I BARAZISË

1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), asistenca ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:

- Shqyrtimit të çështjeve nga KMD;
- Pjesëmarrje e çështjeve të diskriminimit në gjykatë.

2. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD

Bazuar në Ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë:

- Të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në Ligjin Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji.
- T’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues.
- Të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.

3. Procedura e shqyrtimit të ankesave

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese.

Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal (neni 33 i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar).

Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim, si dhe shpjegime dhe fakte që ankuesi disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar, si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri.

Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij.

Në qoftë se ankesa plotëson kushtet e ligjit për t'u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 të Ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar. Procedura e hetimit përfshin grumbullim informacioni lidhur me çështjen, mund të zhvillohen edhe inspektime apo seanca dëgjimore mes palëve.

Pas analizimit të fakteve të grumbulluara bazuar në procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim brenda 90 ditëve dita e regjistrimit të ankesës. Nëse gjatë procedurës administrative është, zhvilluar seancë dëgjimore, atëherë vendimmarrja e KMD zgjatet me 90 ditë të tjera.

Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik privat nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Për çështjet me objekt gjuhën e urrejtjes, operatorët mediatikë shtetërorë kanë detyrimin që të publikojnë përmbledhjen e vendimeve të formës së prerë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, detyrim ky i bërë me ndryshimet e LMD-së në vitin 2020.

Procedura e regjistrimit të ankesave

Gjatë vitit 2025, pranë Drejtorisë së Pritjes së Ankesave janë regjistruar për shqyrtim 330 ankesa, ndër të cilat:

- ❖ 73 janë paraqitur dhe asistuar nga **Drejtoria e Pritjes së Ankesave**
- ❖ 105 kanë ardhur **me postë**;
- ❖ 81 kanë ardhur nëpërmjet adresës elektronike info@kmd.al;
- ❖ 28 kanë ardhur përmes **Zyrës Rajonale Korçë**;
- ❖ 22 kanë ardhur përmes **Zyrës Rajonale Shkodër**;
- ❖ 21 kanë ardhur përmes **Zyrës Rajonale Fier**

Bazuar në numrin total të ankesave, rezulton se **78.5%** e tyre i janë drejtuar Zyrës së KMD në Tiranë dhe janë regjistruar nga Drejtoria e Pritjes së Ankesave, ndërsa **21.5%** e tyre kanë ardhur nga Zyrat Rajonale Korçë, Fier dhe Shkodër dhe janë regjistruar nga DPA.

Është rritur numri i ankesave të ardhura nga shtetas të huaj që janë resident në Shqipëri në 3.03% të numrit total të ankesave. Statistikat tregojnë se **9.1%** e ankuesve janë shtetas migrantë brenda vendit, që i drejtohen qyteteve më të mëdha si Tirana e Durrësi.

Drejtoria e Pritjes së Ankesave ka pritur **287** (dyqind e tetëdhjetë e shtatë) qytetarë të interesuar për të marrë informacion kryesisht:

- për mënyrën e ngritjes së një ankesë pranë KMD;
- për t'u njohur me kriteret ligjore që duhen plotësuar për të paraqitur një ankesë;
- për vijimin e procedurës nga KMD deri në daljen e vendimit;
- për të marrë kontakt me inspektorin e çështjes, nëpunës të Drejtorisë Juridike apo/dhe drejtorive të tjera në KMD;
- për të rezervuar takim me titullarin e institucionit, etj.

Gjatë këtij viti janë pritur **849 (tetëqind e dyzet e nëntë) telefonata**, kryesisht nga subjekte ankues, institucione publike ose private, si dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme të interesuar për marrjen e informacionit në kuadër të një ankesë, plotësim të dokumentacionit, vijueshmërinë e saj nga Drejtoria e Hetimit Administrativ, apo rreth procedurave të ndjekura për çështjet në Gjykatë.

Gjatë vitit 2025 bashkëpunimi me institucionet, referimi i rasteve dhe zgjidhja e tyre me ndërmjetësim ka pësuar një rritje të ndjeshme, sidomos në nivel rajonal.

Zyra Rajonale Korçë për periudhën **janar-dhjetor 2025**, numëron:

- ❖ **390 (treqind e nëntëdhjetë) raste** për këshillim, ndërmjetësim, ofrim asistence ligjore dhe ndihmë në portalin **e-Albania**, ku pjesa më e madhe e tyre kanë marrë zgjidhje.
- ❖ 28 ankesa janë përcjellë për regjistrim në DPA;
- ❖ **Referim i 18 (tetëmbëdhjetë) rasteve** pranë Avokatit të Popullit, ku disa prej tyre kanë marrë zgjidhje.
- ❖ **Referim i 23 (njëzet e tre) rasteve** pranë Ndihmës Juridike Falas në Korçë.
- ❖ **Referim i 1 (një) rasti** pranë Ndihmës Juridike Falas në Pogradec;

Zyra Rajonale Fier për periudhën **janar-dhjetor 2025**, numëron

- ❖ 21 (njëzet e një) ankesa janë përcjellë për regjistrim në DPA;
- ❖ 6 (gjashtë) ankesa referuar Zyrës së Shërbimit Ligjor Falas në Fier;
- ❖ 1 (një) ankesë referuar ZR të Avokatit të Popullit në Vlorë;
- ❖ 2 (dy) ankesa referuar ZR të Avokatit të Popullit në Berat;
- ❖ 2 (dy) ndërmjetësime në fushën e shërbimeve dhe arsimit;


Zyra Rajonale Shkodër për periudhën **janar-dhjetor 2025** numëron:

- ❖ 22 (njëzet e dy) ankesa të regjistruara nga DPA;
- ❖ 3 (tre) raste të referuara përfaqësuesit të Avokatit të Popullit në Shkodër;
- ❖ 1 (një) rast të referuar Zyrës së Ndihmës Juridike Falas në Shkodër.


Falë marrëveshjes së bashkëpunimit, gjatë vitit 2025, nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, kanë ardhur për ndjekje dhe shqyrtim **7 ankesa**.

Çështjet e trajtuara³³ nga KMD

Në periudhën nga 1 Janar 2025 deri në 31 Dhjetor 2025, KMD ka trajtuar gjithsej 424 çështje, (404 ankesa dhe 20 çështje ex-officio). Nga këto, 342 çështje (330 ankesa dhe 12 çështje ex-officio) janë të regjistruara në vitin 2025 dhe 82 çështje (74 ankesa dhe 8 çështje ex-officio) janë të regjistruara nga viti 2024.



Grafiku 1. Çështje të vitit 2025.




Grafiku 2. Të dhëna krahasimore 2024-2025.

³³Çështjet e mbyllura me vendim dhe ato në proces gjatë vitit 2025.

Ankuesit


Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat a dhe b, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankuesit janë: individë, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitime.

Nga 424 çështje që janë trajtuar gjatë vitit 2025, për **404 çështje** ka filluar shqyrtimi në bazë të ankesës, nga të cilat në **356 raste** ankesat janë paraqitur nga individë (288 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2025 dhe 68 ankesa të regjistruara në vitin 2024), **në 26 raste**, ankesat janë paraqitur nga organizata me interesa legjitime (25 ankesa të regjistruara në vitin 2025 dhe 1 ankesë e trashëguar nga viti 2024), në **22 raste** ankesat janë paraqitur nga grup personash (17 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2025 dhe 5 ankesa të regjistruara në vitin 2024).




Grafikët 3 & 4. Ankesat e regjistruara sipas subjekteve ankuese.

Gjatë 2025, konstatohet se numri i ankesave të organizatave me interesa legjitime, në krahasim me vitin 2024, rezulton të jetë i njëjtë, krahasuar me një vit më parë. Organizatat me interesa legjitime, kryesisht gjatë vitit 2025, kanë paraqitur ankesa, të cilat kanë patur në objekt të tyre mbrojtjen e një kategorie të veçantë, si psh: personat me aftësi të kufizuara apo pakicat e ndryshme kombëtare në Republikën e Shqipërisë.



Grafiku 5. Ankesat e paraqitura nga OJF për vitet 2021-2025.



Grafiku 6. Ndarja sipas subjekteve për çështjet e trajtuara gjatë vitit 2025.

Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2025 përveç ankesave individuale, janë shqyrtuar edhe 26 ankesa nga organizata me interes legjitim (1 ankesë e regjistruar në vitin 2024 dhe 25 ankesa të regjistruara në vitin 2025). Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara, pakicave kombëtare Rome/Egjiptian, etj. Në çështjet e regjistruara gjatë vitit 2024, 12 ankues janë mbështetur nga OJF të ndryshme për të depozituar ankesë pranë KMD-së, ndërkohë që në vitin 2025, në 20 raste ankuesit janë asistuar nga organizata të shoqërisë civile, për të depozituar ankesë.


Gjithashtu, në disa raste informacioni i dhënë nga ana e organizatave të shoqërisë civile dhe medias, ka shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për nisjen e shqyrtimit kryesisht të çështjeve.

Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së)

Mbështetur në nenin 32, pika 1/c, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, gjatë vitit 2025, janë trajtuar gjithsej 20 çështje ex-officio, nga të cilat 8 çështje janë të regjistruara në vitin 2024 dhe 12 të regjistruara gjatë vitit 2025. Gjatë vitit 2025, KMD ka filluar hetimin administrativ për 6 (gjashtë) raste, pas marrjes së informacionit të besueshëm nga organizata të shoqërisë civile. 1 (një) çështje është shqyrtuar kryesisht nga KMD, në bazë të informacionit të marrë nga ankesat e trajtuara dhe 5 (pesë) janë trajtuar mbështetur në informacionin e marrë nga media.

Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive

Gjatë vitit 2025, ka pasur një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminimi, të paraqitura pranë KMD-së. Bashkitë, nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave janë: Tiranë, Shkodër, Korçë, Durrës, Fier, etj. Është për tu theksuar fakti që gjatë vitit 2025, janë paraqitur ankesa edhe nga disa Bashki si p.sh.: Has, Pustec dhe nga shtetas Shqiptar që jetojnë jashtë vendit, nga të cilat Komisioneri nuk ka pasur ankesa më parë.



Grafiku 7. Shpërndarja e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2025, sipas Bashkive.


Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 të tij, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.


Mbështetur në LMD, është parashikuar një listë e hapur shkaqesh, për të cilët ligji ofron mbrojtje, duke përfshirë dhe rastet për “çdo shkak tjetër”, duke patur parasysh se, **shkaku i mbrojtur** mund të jetë një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri, i cili nuk parashikohet shprehimisht nga neni 1, të LMD-së.

Gjatë vitit 2025, janë depozituar 139 ankesa, në raport me 89 ankesa të paraqitura gjatë 2024, në të cilat ankuesit kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi.

Në grafikët e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat mbi shpërndarjen e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2025 dhe atyre të regjistruara në vitin 2024, të ndara sipas shkaqeve:



Grafiku 8. Shkaqet e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2025




Grafiku 9. Shkaqet e ankesave të regjistruara në vitin 2024

Gjatë vitit 2025 vazhdojnë të mbeten mbizotëruese pretendimet për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, gjendjes ekonomike, racës, etnisë, bindjeve politike, përkatësisë në një grup të veçantë, gjendjes arsimore, gjinisë, moshës dhe gjendjes shëndetësore.

Çështjet e trajtuara sipas fushave.


Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje në 3 (tre) fusha: fusha e punësimit, fusha e arsimit dhe fusha e të mirave dhe shërbimeve. Gjatë vitit 2025, nga totali prej 424 çështje të trajtuara gjithsej, (404 ankesa dhe 20 çështje ex-officio), nga këto **50 çështje** në fushën e arsimit, **167 çështje** në fushën e punësimit dhe **207 çështje** në fushën e të mirave dhe shërbimeve (342 çështje të regjistruara në 2025 dhe 82 çështje të mbartura nga 2024).



Grafikët 10 & 11. Çështjet e trajtuara dhe të regjistruara gjatë vitit 2025, të ndara sipas fushave.

Gjatë vitit 2025, shihet se ka një rënie të çështjeve të trajtuara në fushën e arsimit, krahasuar me një vit më parë. Çështjet e trajtuara në fushën e punësimit kanë patur një rritje. Ndërsa, çështjet e trajtuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve, kanë pasur një rritje me thuajse 20% nga viti 2024.

Për sa evidentohet, nga të dhënat rezulton se, çështjet në fushën e arsimit zënë 11.8 % të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti, me një ulje prej rreth 26 % krahasuar me vitin paraardhës, çështjet në fushën e punësimit zënë 39.4 % të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti me një rritje prej 10.7 % krahasuar me 2024, çështjet në fushën e të mirave dhe shërbimeve zënë 48.8 % të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti, me një rritje prej 21.2 % krahasuar me 2024.




Grafiku 12. Shpërndarja e çështjeve sipas fushave për vitet 2024-2025.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

Numri total i çështjeve të trajtuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve është **207**, nga të cilat 173 çështje janë regjistruar në vitin 2025 dhe 34 çështje të mbartura nga 2024. Në total 154 çështje drejtohen kundër subjekteve publike dhe 53 drejtohen kundër subjekteve private. Raporti i ankesave drejtuar subjekteve publike gjatë këtij viti ka një rritje prej 36.6 % nga viti paraardhës, ndërsa raporti i ankesave drejtuar subjekteve private në këtë fushë, ka një rënie me 18.5 %, krahasuar me vitin 2024.

Nga 154 çështjet e trajtuara kundër subjekteve publike, në 74 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 80 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor.



Grafiku 13 & 14. Çështjet në fushën e të mirave dhe shërbimeve, gjatë 2024 dhe 2025.

Gjatë vitit 2025, rezultojnë që çështjet kundër subjekteve publike qendrore zënë 35.7 % të totalit të çështjeve në këtë fushë, ndërsa çështjet kundër subjekteve publike vendore zënë 38.7 % të totalit të çështjeve në këtë fushë. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024 ka një rritje prej 52.7 % të çështjeve që drejtohen kundër pushtetit qendror.

Problematikat e ankesave të paraqitura në këtë fushë, mbeten thuajse të njëjta edhe për vitin 2025, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mos ofrimin e shërbimeve të nevojshme nga njësitë e qeverisjes vendore, si: trajtimi me strehim të përshtatshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore; aksesueshmëria dhe mungesa e lehtësirave në linjat e transportit publik dhe privat; përdorimi i gjuhës së urrejtjes ndaj grupeve vulnerabël, mungesa e mbështetjes financiare të familjeve në nevojë etj.


Një pjesë e mirë e ankesave drejtohen edhe kundër institucioneve të administratës qendrore, ku objekti i ankesave konsiston në mosofrimin apo garantimin e një serie shërbimesh si, mungesa e medikamenteve në shërbimin shëndetësor, mos ofrimi i transportit publik qytetas pa pagesë, mos ofrimi i bursave për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë etj. Shkaqet kryesore, për të cilat janë paraqitur ankesat në fushën e shërbimeve kanë qenë: aftësia e kufizuar, raca, mosha, gjinia dhe gjendja ekonomike.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit.

Çështjet e trajtuara me pretendim diskriminimin në fushën e punësimit janë ankesa të depozituara si kundër institucioneve publike, ashtu edhe kundër subjekteve private. Objekti i çështjeve të trajtuara në këtë fushë konsiston kryesisht në problematika të shfaqura lidhur me aksesin në punësim dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Numri i përgjithshëm i çështjeve, në fushën e punësimit, që janë trajtuar gjatë vitit 2025, është 167, nga të cilat 36 çështje të regjistruara gjatë vitit 2024 dhe 131 çështje të regjistruara në vitin 2025.

Nga të gjithë çështjet e trajtuara në këtë fushë gjatë vitit 2025, 116 çështje drejtohen kundër subjekteve publike dhe 51 të tilla kundër subjekteve private.



Grafiku 15. Çështjet në fushën e punësimit.

Krahasuar me vitin 2024, evidentohet se numri i çështjeve të trajtuara në këtë fushë ka pasur një rritje të lehtë për vitin 2025. Gjatë vitit 2024, sa i përket numrit të çështjeve në këtë fushë kundër subjekteve publike ka qenë 115 ndërsa kundër subjekteve private 34. Nga krahasimi i të dhënave me vitin paraardhës, gjatë vitit 2025 rezulton një rritje prej afro 33 % e çështjeve drejtuar subjekteve private. Ndërsa numri i çështjeve drejtuar subjekteve publike ka mbetur në të njëjtat nivele.


Pra, gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024 ka pasur një rritje me 1 ankesë të totalit të çështjeve të kësaj fushe që drejtohen kundër subjekteve publike, dhe një rritje me 17 ankesa të numrit të çështjeve kundër sektorit privat.

Nga **116** çështjet e trajtuara kundër subjekteve publike, në 46 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 70 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor. Çështjet e paraqitura në fushën e punësimit, janë drejtuar përgjithësisht drejt institucioneve të administratës publike, me objekt kundërshtimi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Në krahasim me vitin 2024, shpërndarja e çështjeve në këtë fushë drejtuar pushtetit qendror dhe atij vendor nuk ka pësuar ndryshime domethënëse. Në vitin 2024, janë paraqitur kundër pushtetit qendror 42 raste ose 25 % e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike dhe 73 raste kundër subjekteve publike vendore ose 43.7 % e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike.

Gjatë vitit 2025, rezulton që çështjet kundër subjekteve publike qendrore zënë 27.5 % të totalit të çështjeve në këtë fushë, ndërsa çështjet kundër subjekteve publike vendore zënë 41.9 % të totalit të çështjeve në këtë fushë. Çështjet që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë pasur si shkak të pretenduar diskriminimi: bindjet politike, gjendjen shëndetësore, gjendjen arsimore, përkatësinë në një grup të veçantë, aftësinë e kufizuar, qëndrimeve në media kundër punëdhënësve, ankesat për diskriminim etj.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 50 çështje, në fushën e arsimit, nga të cilat 12 çështje janë të regjistruara në vitin 2024 dhe 38 çështje janë të regjistruara gjatë vitit 2025.



Grafiku 16. Çështjet në fushën e arsimit.

Krahasuar me një vit më parë, gjatë vitit 2025, janë shqyrtuar 2 çështje në fushën e arsimit kundër subjekteve arsimore private. Në çështjet e trajtuara në fushën e arsimit, ankuesit janë drejtuar kundër subjekteve publike, ndër të cilat në 4 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 44 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor.

Objekti i çështjeve të paraqitura në fushën e arsimit ka qenë vendosja e mësuesit ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara, përjashtimi nga pagesa e regjistrimit të fëmijëve të pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane në kopshte dhe çerdhe, përfitimi i bursave për nxënësit që vijnë nga familje në nevojë nga ana e njësisive të vetëqeverisjes vendore etj.

Shkaqet kryesore të pretenduara në këto çështje janë aftësia e kufizuar, gjendja arsimore, gjendja ekonomike, raca, etj.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është anëtar për shkak të detyrës, në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri ka përfunduar shqyrtimin e 41 çështjeve ku janë trajtuar problematikat e fëmijëve. Për këto 41 çështje, Komisioneri është shprehur si vijon:

- 2 Vendime Pushimi për të cilat është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ai i ishte nënshtruar procedurave të shqyrtimit administrativ;
- 14 Vendime ku Komisioneri ka konstatuar Diskriminim e fëmijëve (12 raste të cilat vijnë nga familje në nevojë, të cilët nuk kanë përfituar bursa nga njësitë e vetëqeverisjeve vendore, referuar përcaktimeve të VKM-së nr. Nr. 511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar);
- 11 Vendime Mosdiskriminimi;
- 2 Vendime Mospranimi;
- 1 Vendim Pushimi, pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;

Ndërsa për 10 ankesa të tjera dhe 1 çështje ex-officio Komisioneri vijon procedurat e shqyrtimit të tyre gjatë vitit 2026.

Problematikat kryesore që lidhen me objektin e ankesave me subjekte fëmijët, kanë qenë kryesisht:

- Regjistrimi pa pagesë në kopshtet ose çerdhet publike, i fëmijëve që i përkasin pakicës rome apo egjiptiane në Shqipëri;
- Trajtimi me bursë i fëmijëve që vijnë nga familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike, dhe që ndjekin arsimin parauniversitar;
- Plotësimi me mësues ndihmës i fëmijëve me aftësi të kufizuar;
- Përfitimi i bursave për fëmijët e familjeve në nevojë, të regjistruar në arsimin parauniversitar.

Gjuha e urrejtjes.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri ka shqyrtuar në total 26 çështje me objekt përdorimin e gjuhës së urrejtjes, nga të cilat 23 ankesa dhe 3 çështje ex-officio. Nga çështjet e trajtuara në këtë fushë gjatë vitit 2025, në 5 raste (4 ankesa dhe 1 ex-officio) çështjet drejtohen kundër subjekteve private të cilat marrin pjesë në jetën publike, ndërsa 21 raste janë drejtuar kundër subjekteve publike.

Referuar çështjeve të trajtuara, në 16 raste ankesat janë depozituar nga OJF, në 3 raste nga subjekte ankues gra, në 2 raste nga subjekte ankues burra, në 2 raste ankesat janë depozituar nga grupe personash dhe në 3 raste çështjet janë nisur të shqyrtohen me iniciativën e Komisionerit referuar informacionit të marrë në media.

Çështjet e trajtuara kanë patur si shkak të pretenduar diskriminimi: orientimin seksual, identitetin gjinor, karakteristikat e seksit, gjininë, bindjet fetare dhe aftësinë e kufizuar.

Gjatë vitit 2025, KMD-ja ka marrë gjithsej 21 vendime si më poshtë:

- 3 vendime pushimi për shkak se gjatë procedurës së shqyrtimit të tyre është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilën ishte nisur trajtimi i tyre;
- 2 vendime diskriminimi në formën e gjuhës së urrejtjes (1 për shkak të bindjeve fetare dhe 1 për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor);
- 1 vendim mosdiskriminimi;
- 15 vendime mospranimi të ankesave.

Ndërsa, për 4 ankesa dhe 1 ex-officio vijojnë procedurat e shqyrtimit në vitin pasardhës.

Mbrojtja e të drejtave të shtetasve të huaj

Gjatë vitit 2025, Komisioneri ka trajtuar 11 ankesa dhe 1 ex-officio me subjekte ankues shtetas të huaj, ku është shprehur me vendim për 6 prej tyre, ndërsa për 5 ankesa dhe 1 çështje ex-officio, vijojnë procedurat e shqyrtimit të tyre.

Objekti i tyre kryesisht lidhet me:

- Trajtimi diskriminues i një fëmije, nga ana e mësuesve për shkak të pamjes së jashtme dhe identitetit gjinor të supozuar prej tyre;
- Mos ekuivalentimi i programit mësimor nga ana e Ministrisë së Arsimit;
- Trajtimi diskriminues nga ana e punëdhënësit për shkak të fesë apo dhe racës, gjatë marrëdhënieve të punësimit, duke mos marrë pagën që i takon;
- Është mashtruar nga një menaxher futbollit duke i premtuar nënshkrimin e kontratave me të në ekipe futbollit, për shkak të racës
- Mohimin e shërbimit nga një qendër estetike e cila është nën administrimin e shtetaseve Ruse në Shqipëri, për një shtetase Ukrainase;
- Mos lejimin e një shtetase të huaj, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të ushtrohet pranë një palestere force për femra;
- Përdorimi i gjuhës diskriminuese të publikuara në rrjetet sociale etj.

Mbështetur në ankesat e depozituara, ato janë drejtuar në 5 raste në fushën e të mirave dhe shërbimeve, në 5 raste në fushën e punësimit dhe në 2 raste në fushën e arsimit.

Nga 11 ankesat e trajtuara, ato janë depozituar pranë Komisionerit në 3 raste nga subjekte ankues burra, në 7 raste nga subjekte ankues gra dhe në 1 rast grup personash. Sa i përket rastit të nisur kryesisht, ai është iniciuar nga informacioni i marrë në media.

Sa më sipër Komisioneri është shprehur me vendim në 6 raste, si më poshtë:

- 1 vendim diskriminimi;
- 1 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 4 vendime mospranimi;

4. Vendimet e çështjeve sipas fushave.

Në fushën e të mirave dhe shërbimeve, KMD ka dhënë gjithsej **134 vendime dhe 2 rekomandime**³⁴, nga të cilat, 28 vendime për çështjet e regjistruara në vitin 2024, 106 vendime dhe 2 rekomandime për çështjet e regjistruara gjatë vitit 2025. Nga 136 vendimet e rekomandimet e përcjella, 92 vendime dhe 2 rekomandime janë dhënë kundër subjekteve publike dhe 42 vendime janë dhënë kundër subjekteve private.

Në këto vendime është konstatuar:

- në 23 raste diskriminim, ndër të cilat 10 vendime kundër subjekteve publike dhe 13 vendime kundër subjekteve private;
- në 20 raste mosdiskriminim, ku në 1 prej tyre pavarësisht se nuk është konstatuar situata diskriminuese, është dhënë rekomandim për përmirësimin e situatës;
- në 63 raste mospranim të ankesave;
- në 25 raste për ndërprerje e procedurave të shqyrtimit të çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore;
- në 3 raste për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi i bërë tek Komisioneri;
- si dhe janë dhënë dhe 2 Rekomandime (1 prej tyre nuk është dhënë në kuadër ankese).

Vlen të theksohet se, sa i përket 23 vendimeve të diskriminimit, Komisioneri ka konstatuar si më poshtë:

- 1 vendim diskriminim në formën e rëndë dhe atij ndërsektorial;
- 2 në formën e gjuhës së urrejtjes;
- 1 në formën e udhëzimit për diskriminim;
- 5 në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe atij të tërthortë;
- 1 në formën e diskriminimit strukturor;
- 1 në formën e rëndë;
- 1 në formën e rëndë, ndërsektorial dhe të tërthortë
- 11 në formën e diskriminimit të drejtpërdrejtë.

Gjithashtu, janë vendosur 3 sanksione me gjobë për çështjet e regjistruara gjatë vitit 2025, nga të cilat, në 2 raste për shkak se subjektet ndaj të cilëve janë paraqitur ankesat nuk kanë zbatuar vendimin e Komisionerit dhe në 1 rast tjetër, nga subjekti nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit informacioni i kërkuar në kuadër të shqyrtimit të çështjeve përkatëse.

Në fushën e punësimit, KMD ka dhënë gjithsej **117 vendime dhe 1 rekomandim**, nga të cilat, 25 vendime dhe 1 rekomandim për çështjet e regjistruara në vitin 2024 dhe 92 vendime për çështje të regjistruara gjatë vitit 2025. 82 vendime dhe 1 rekomandim janë dhënë kundër subjekteve publike dhe 35 vendime kundër subjekteve private. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në **13 raste**, ku në **12 raste** kundër subjekteve publike dhe **1 rast** kundër subjekteve private. Në vendimet ku është konstatuar diskriminim dhe në pjesën më të madhe të tyre Komisioneri ka kërkuar nga subjektet përkatëse, rregullimin e situatave diskriminuese, si dhe rikthimin në punë të individit të diskriminuar.

³⁴ 2 rekomandime të dhëna në kuadër të shqyrtimit të çështjeve ex-officio.

Komisioneri është shprehur me mosdiskriminim në **21** raste. Në **67** raste është shprehur për mospranimin e ankesës, në **2** raste është shprehur për ndërprerje e procedurave të shqyrtimit të çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore, në **5** raste është shprehur për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi i bërë tek Komisioneri, në **9** raste Komisioneri është shprehur me vendim për pushimin e çështjeve, për shkak se subjektet ankuese i janë drejtuar organeve gjyqësore me ankim për diskriminim.

Gjithashtu, sa i përket 13 vendimeve të diskriminimit, Komisioneri ka konstatuar:

- 1 rast është konstatuar diskriminim në 2 forma, atë të viktimizimit dhe në formën e diskriminimit të rëndë;
- 1 rast është konstatuar diskriminim në formën e viktimizimit dhe atë të shoqërimit;
- 1 në formën e shqetësimit;
- 1 në formën e udhëzimit për diskriminim;
- 1 në formën e viktimizimit;
- 8 në formën e diskriminimit të drejtpërdrejtë.

Në fushën e arsimit, KMD ka dhënë gjithsej **33 vendime**, të cilat, në 32 raste të drejtuara kundër subjekteve publike dhe në 1 rast kundër subjekteve private. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në **11 raste**. Komisioneri është shprehur me **13** vendime mosdiskriminimi, **4** vendime për mospranimin e ankesës, **2** vendime për ndërprerjen e procedurave, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore dhe **2** vendime për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi i bërë tek Komisioneri.

5. Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve³⁵

Vendimet e çështjeve me shkak racën³⁶

Gjatë vitit 2025, Komisioneri është shprehur me **22** vendime, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të racës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:


- 2 vendime diskriminimi;
- 8 vendime mospranimi;
- 5 vendime mosdiskriminimi;
- 6 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;

³⁵ Komisioneri shprehet me vendim për çështje ku pretendohet diskriminim për një ose më shumë shkaqe të përcaktuara në nenin 1, të LMD. Në këtë kontekst, Komisioneri shprehet në të njëjtin vendim, për 2 ose më shumë shkaqe diskriminimi. Për këtë arsye, numri total i vendimeve të miratuara nga KMD, mund të mos përputhet me numrin e vendimeve të dhëna sipas shkaqeve të raportuara në këtë pjesë të Raportit Vjetor.

³⁶ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 "Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash".

- 1 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi çështja ka qenë në proces shqyrtimi në gjykatë.

Gjithashtu, është marrë edhe 1 sanksione me gjobë, për shkak të moszbatimit të vendimit me diskriminim.



Grafiku 17. Vendimet e vitit 2025 me shkak racën

Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat janë drejtuar kryesisht kundër institucioneve publike qendrore dhe vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të racës, janë si vijojnë:


- Pamundësia e përdorimit të portalit e-albania, nga anëtarët e pakicave egjiptiane dhe atyre rome, për të marrë shërbime nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- Mospërfitimi i bursave në arsimin parauniversitar publik, për familjet në nevojë dhe atyre që i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane në Shqipëri;
- Përdorimi i shprehjeve të papërshtatshme në media ndaj anëtarëve të pakicave kombëtare në Shqipëri;

Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar

Gjatë vitit 2025, Komisioneri është shprehur me **64** vendime, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 14 vendime diskriminimi (2 në formën e shoqërimit dhe 1 në formën e diskriminimit të rëndë, ndërsektorial dhe të tërthortë);
- 16 vendime mosdiskriminimi;
- 12 vendime mospranimi;

- 20 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendime për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës.



Grafiku 18. Vendimet e vitit 2025 me shkak aftësinë e kufizuar

Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, janë si vijojnë:

- Mungesa e aksesueshmërisë në godina dhe ambiente ku ofrohen të mira dhe shërbime, si p.sh.: institucione kulturore apo arsimore, institucione private dhe rrugë apo trotuare;
- Aksesueshmëria dhe mungesa e lehtësirave në linjat e transportit publik dhe privat;
- Ankimi kundër vendimeve të KMCAp-së;
- Përfitimi i pagesës së invaliditetit;


Referuar subjekteve ankues në çështjet e shqyrtuara, rezulton se subjekti ankues është grua në 26 raste, në 45 raste subjekti ankues është burrë, në 9 raste subjektet ankues janë organizata me interesa legjitime, në 6 raste grup personash, në 3 raste Komisioneri ka marrë informacionin nga çështjet e shqyrtuara për të nisur shqyrtimin e çështjes me iniciativën e tij, ndërsa në 3 raste të tjera Komisioneri pas informacionit të marrë nga organizatat me interesa legjitime, ka nisur shqyrtimin e çështjes me iniciativën e tij.

Vlen të theksohet fakti se numri i vendimeve të mospranimit, ka ardhur si rezultat i ankesave, në të cilat pretendimet e subjekteve ankues nuk lidheshin me fushën e veprimit dhe kompetencat e Komisionerit, si p.sh: mos përfitimi i pagesës së invaliditetit për një diagnozë apo sëmundje të caktuar, etj.

Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri është shprehur me 25 vendime për ankesat ku është pretenduar diskriminim për shkak të bindjes politike. Disa prej vendimeve të sipërpërmendura janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 10 vendime mosdiskriminimi;
- 11 vendime mospranimi;
- 3 vendime për pushimin e shqyrtimit të ankesës, pasi çështjet kanë qenë në proces në gjykatë;
- 1 vendim për pushimin e ankesës, pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i çështjes.



Grafiku 19. Vendimet e vitit 2025 me shkak bindjen politike


Çështjet me pretendim diskriminim për shkak të bindjes politike kanë konsistuar kryesisht problematika, që lidhen me rekrutimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione të administratës shtetërore qendrore ose vendore, për këtë shkak.

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike

Gjatë vitit 2025, Komisioneri është shprehur me 41 vendime, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 15 vendime diskriminimi (1 prej të cilëve është konstatuar në formën e shoqërimit; në 5 raste në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe atij të tërthortë dhe në 1 rast në formën e diskriminimit të rëndë, ndërsektorial dhe të tërthortë);
- 12 vendime mosdiskriminimi (në 2 raste janë dhënë edhe rekomandime bashkëngjitur për përmirësimin e situatës);
- 10 vendime mospranimi;

- 3 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;



Grafiku 20. Vendimet e vitit 2025 me shkak gjendjen ekonomike


Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, janë si vijojnë:

- Mungesa e mbështetjes financiare të familjeve në nevojë, nga ana e institucioneve të pushtetit vendor;
- Vonesat në procesin e legalizimit të banesave të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptiane, ku gjendja ekonomike ndërthuret me shkakun e racës;
- Mosdhënia e bursës për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë;
- Braktisja e shkollës për shkak të gjendjes ekonomike.

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri është shprehur me 21 vendime për ankesat ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 1 vendim diskriminimi (në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe atij të tërthortë);
- 2 vendime mosdiskriminimi;
- 15 vendime mospranimi;
- 1 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesave;
- 1 vendim për pushimin e shqyrtimit të ankesës, pasi çështja ka qenë në proces në gjykatë;



Grafiku 21. Vendimet e vitit 2025 me shkak gjendjen shëndetësore


Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat drejtohen kryesisht kundër institucioneve publike qendrore dhe vendore, në fushën e punësimit dhe shërbimeve. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, janë si vijojnë:

- Ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes shëndetësore;
- Përfitimi me rimbursim i medikamenteve për pacientë të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda;

Vendimet e çështjeve me shkak moshën.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri është shprehur me 23 vendime dhe 1 rekomandim mbi ankesat/çështjet ex-officio ku është pretenduar diskriminim për shkak të moshës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 4 vendime diskriminimi (në 4 raste është konstatuar në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe atij të tërthortë);
- 8 vendime mosdiskriminimi;
- 7 vendime mospranimi;
- 2 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendime për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;
- 1 rekomandim në kuadër të shqyrtimit të një çështje ex-officio.



Grafiku 22. Vendimet e vitit 2025 me shkak moshën


Çështjet me pretendim diskriminim për shkak të moshës kanë konsistuar kryesisht në problematika që lidhen me pamundësinë për të aplikuar për pensionin e pleqërisë në sistemin e-albania, largim nga puna për shkak të moshës dhe mospërfitimin e masës së plotë të pensionit të pleqërisë.

Vendimet e çështjeve me shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

Mbështetur në praktikën e çështjeve të trajtuara, Komisioneri ka konsideruar si shkak në kuadër të përkatësisë në një grup të veçantë, karakteristikat të cilat e bëjnë grupin të dallueshëm, si p.sh.: pjesëmarrja në organizata sindikale etj.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri është shprehur me 7 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 1 vendim diskriminimi në formën e udhëzimit për diskriminim;
- 3 vendime mosdiskriminimi;
- 3 vendime mospranimi;



Grafiku 23. Vendimet e vitit 2025 me shkak përkatësinë në një grup të veçantë


Çështjet me pretendim diskriminimi për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë kanë konsistuar kryesisht në problematika, që lidhen me rekrutimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione private dhe të administratës shtetërore qendrore ose vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, janë si vijojnë:

- Largimet nga puna nga ana e punëdhënësve, pikërisht pasi ata kanë marrë dijeni për veprimtarinë e ankuesve si pjesë e këtyre grupeve të veçanta, psh. qenia në një grupim sindikal në mbrojtje të të drejtave të punonjësve;
- Mosnënshkrimin e Kontratave Kolektive mes sindikatave të punonjësve dhe institucioneve publike;
- Ndëshkimin me masa disiplinore të punonjësve që marrin pjesë në organizimet sindikale.

Vendimet e çështjeve me shkak gjininë.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri është shprehur me 18 vendime, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjininë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 4 vendime diskriminimi (1 është konstatuar në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe atij të tërthortë);
- 2 vendime mosdiskriminimi;
- 9 vendime mospranimi;
- 2 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendime për pushimin e shqyrtimit të ankesës, pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i saj.



Grafiku 24. Vendimet e vitit 2025 me shkak gjininë

Pretendimet e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve lidhen kryesisht me diskriminimin në punësim dhe kryesisht:

- Largim nga puna për shkak të gjinisë;
- Trajtimi i pafavorshëm i punonjësve gjatë marrëdhënieve të punësimit;
- Përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga persona publik.

Vendimet e çështjeve për “çdo shkak tjetër”.

Për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak diskriminimi për të cilin LMD ofron mbrojtje.


Neni 1, i ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është një listë e mbyllur, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “çdo shkak tjetër” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “çdo shkak tjetër” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “shkakun” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”.

Në çështjet e trajtuara gjatë vitit 2025, Komisioneri ka vlerësuar si shkaqe që gëzojnë mbrojtje në kuadër të parashikimit “çdo shkak tjetër”, sipas nenit 1, të LMD-së, shkaqet e mëposhtme:

- ankimet apo denoncimet kundër punëdhënësve,
- prononcimet publike dhe qëndrimet kritike të korrupsionit, të cilët në pjesën kryesore i përkasin punëdhënësve të sektorit publik;
- denoncimet publike në media;
- mosmarrëveshjet me punëdhënësit/eporët.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri është shprehur me 94 vendime mbi çështjet, ku është pretenduar diskriminim në kuadër të termit “për çdo shkak tjetër”. Shumica e vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në çështjet respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 9 vendime diskriminimi;
- 16 vendime mosdiskriminimi;
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 62 vendime mospranimi;
- 1 vendim pushimi pasi çështja po trajtohet në gjykatë;
- 5 vendime për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesave.



Grafiku 25. Vendimet e vitit 2025 për "çdo shkak tjetër"

Nga analiza e vendimeve të mospranimit të çështjeve me pretendim diskriminimi në kuadër të parashikimit për "çdo shkak tjetër", rezulton se këto çështje kanë qenë të papajtueshme me dispozitat e LMD dhe për rrjedhojë Komisioneri nuk i ka marrë ato në shqyrtim.

Sipas, LMD jo çdo pretendim për trajtim të pafavorshëm dhe të pabarabartë përbën diskriminim, por vetëm ato diferenca në trajtim që bazohen në një shkak që konsiderohet i mbrojtur sipas ligjit. Ankuesit i drejtohen Komisionerit duke pretenduar se sjellja e padrejtë që i janë nënshtruar përbën diskriminim, duke mos identifikuar asnjë shkak. Në mënyrë të vazhdueshme në vendimet e tij Komisioneri thekson se, çdo sjellje diskriminuese është një sjellje e paligjshme, por jo çdo pretendim për paligjshmëri përbën diskriminim, për sa kohë nuk bazohet në një shkak i cili konsiderohet shkak i mbrojtur sipas ligjit.

Megjithatë, Komisioneri vlerëson se rritja e numrit të ankesave, "për çdo shkak tjetër" pavarësisht numrit të vendimeve për mospranimin e tyre pasi kanë qenë të papajtueshme me dispozitat e LMD, për arsyet e mësipërme, tregon një rritje të besimit të qytetare tek institucioni i Komisionerit, të cilit i drejtohen për të zgjidhur problematikat e tyre.

Vendimet për konstatimin e diskriminimit për më shumë se një shkak.

Diskriminimi për më shumë se një shkak, gjen pasqyrim në disa forma diskriminimi të parashikuara nga LMD dhe konkretisht, diskriminimi ndërsektorial, diskriminimi i shumëfishtë, si dhe diskriminimi në formën e rëndë.

Gjatë vitit 2025, Komisioneri ka konstatuar në 6 raste, konsumimin e formës së diskriminimit ndërsektorial të shoqëruar edhe me forma të tjera diskriminimi. Çështjet kryesisht kanë patur të bëjnë me konstatimin e diskriminimit për më shumë se një shkak, kryesisht për shkaqet e moshës, gjendjes ekonomike, gjendjes familjare dhe gjendjes arsimore, në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Rastet e sipërcituara lidheshin me faktin se persona të ndryshëm në moshë pensioni, për shkak të mos pasjes së njohurive për të përdorur sistemin e-albania, kanë humbur mundësinë për të përfituar pensionin e pleqërisë në kohë dhe pa pagesë.

Format e tjera të diskriminimit

Gjatë vitit 2025, veç konstatimit të diskriminimit në formën e rëndë dhe atij ndërsektorial, Komisioneri në çështjet e trajtuara, ka konstatuar diskriminim edhe në disa nga format e tjera të parashikuara nga Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si më poshtë:

1. në 3 raste është konstatuar diskriminimi në formën e viktimizimit (1 i shoqëruar me formën e shqetësimit dhe 1 me formën e diskriminimit të rëndë). Këto raste lidhen me trajtimin e punonjësve në mënyrë të pafavorshme për shkak të ankesave për diskriminim;
2. 3 në formën e diskriminimit të rëndë (2 të shoqëruar me formën e diskriminimit ndërsektorial, ku një prej tyre është shoqëruar edhe me formën e diskriminimit të tërthortë). Këto raste lidhen me mohimin e furnizimit me ujë të pijshëm të shtresave vulnerabël;
3. në 2 raste është konstatuar diskriminimi në formën e shoqërimit, që lidhet me mohimin e trajtimit me bursë të fëmijëve të cilët vijnë nga familje me prindër me aftësi të kufizuar;
4. në 1 rast është konstatuar diskriminimi në formën e shqetësimit, për shkak të bindjeve politike në fushën e punësimit;
5. në 1 rast është konstatuar diskriminimi strukturor, për shkak të racës, si pjesë e pakicës kombëtare egjiptiane, në fushën e të mirave dhe shërbimeve;
6. në 5 raste është konstatuar diskriminim në formën e diskriminimit ndërsektorial dhe atij të tërthortë, në të drejtën për të përfituar të mira dhe shërbime, për shkak të moshës, gjendjes arsimore dhe gjendjes ekonomike;
7. në 2 raste është konstatuar diskriminim në formën e udhëzimit për diskriminim, në fushën e punësimit.

6. Rezultatet e vendimeve të çështjeve të shqyrtuara

Duke u bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, me regjistrimin e ankesës, Komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, kur e çmon të nevojshme, Komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër.

Nëse ankesa nuk ka plotësuar kriteret e pranimit, ose ka pasur mungesë të informacionit, që mund të pengojë procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të saj, ankuesit i është kërkuar që brenda 10 ditëve pune nga dita që ka marrë njoftimin të plotësojë kriteret e kërkuara nga KMD, për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qenë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me përfaqësuesit e KMD-së, në Zyrat Rajonale të Korçës, Fierit dhe Shkodrës, si dhe organizatave të shoqërisë civile, subjekteve ankues u është ofruar asistencë, për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2025, është shprehur me **284 Vendime dhe 3 Rekomandime**³⁷. Nga këto, 64 vendime dhe 1 rekomandim për ankesa/çështje ex-officio të regjistruara në vitin 2024 dhe 220 vendime dhe 2 rekomandime, për ankesa të depozituara apo çështje ex-officio të iniciuara gjatë periudhës së vitit 2025.

³⁷ Këtu nuk përfshihen vendimet me gjobë për moszbatim vendimi apo mosdhënie informacioni nga subjektet përkatës;


Vendimet e dhëna nga KMD, klasifikohen si më poshtë:

- 47 vendime konstatim diskriminimi;
- 54 vendime konstatim mosdiskriminimi (në 3 raste janë dhënë edhe rekomandime);
- 134 vendime për mospranim të ankesës;
- 30 vendime për ndërprerje të procedurave të hetimit, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankesave (në 2 raste janë dhënë edhe rekomandime për përmirësimin e situatave);
- 10 vendime pushimi për shkak se ankuesit janë tërhequr nga procedura hetimore;
- 9 vendime pushimi për shkak se çështjet po ndiqeshin në gjykatë;
- 3 Rekomandime për çështje ex-officio.

Për vitin 2025, Komisioneri është shprehur me 9 (nëntë) vendime me gjobë, në vlerën 1.560.000 lekë, si vijojnë:

- për 8 vendime me gjobë për moszbatim të vendimit në themel të Komisionerit;
- për 1 vendim me gjobë kundër subjekteve, që nuk kanë dhënë informacion, pas kërkesave zyrtare së KMD-së.

Në total, numri i vendimeve dhe rekomandimeve të Komisionerit për vitin 2025, është 296 vendime (ku përfshihen edhe 9 vendimet me gjobë).



Grafiku 26. Vendimet e dhëna gjatë vitit 2025

Për sa më sipër, vlen të theksohet se për vendimet me diskriminim të dhëna gjatë vitit 2025, subjektet kanë zbatuar masat e vendosura nga KMD për rregullimin e situatës diskriminuese për 11 vendime, 23 vendime janë dërguar në gjykatë, 12 vendime janë në proces zbatimi, ndërsa në 1 vendim Komisioneri ka konstatuar diskriminim por nuk ka urdhëruar masa për subjektin.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të ankesave ka dërguar rreth 620 kërkesa për informacion ndaj palëve në proces dhe në vijim të shqyrtimit dhe hetimit administrativ të ankesave, ka zhvilluar 13 inspektime dhe 90 seanca dëgjimore publike, ku ka ftuar palët dhe çdo person tjetër të interesuar për të parashtruar pretendimet e tyre.

Nga 47 ankesa/çështje ex-officio, për të cilat, KMD është shprehur me vendime diskriminimi gjatë vitit 2025, për 24 prej tyre janë zhvilluar seanca dëgjimore, fakt që dëshmon mbi rëndësinë e zhvillimit të seancave të tilla, për mbledhjen e informacionit të nevojshëm, përgjatë kryerjes së hetimit administrativ.

Referuar subjekteve ankues, rezulton se subjekti ankues ka qenë grua në 20 vendime diskriminimi, në 19 vendime diskriminimi subjekti ankues ka qenë burrë, në 2 vendime diskriminimi subjektet ankues kanë qenë pakica kombëtare apo grup vulnerabël, në 4 vendime diskriminimi subjektet ankues kanë qenë organizata dhe në 2 vendime Komisioneri është shprehur për çështje të nisura ex-officio.

Problematikat e evidentuara nga KMD gjatë shqyrtimit të ankesave

Gjatë trajtimit të 424 çështjeve gjatë vitit 2025, janë identifikuar gjithashtu disa problematika të lidhura me aktet ligjore, nënligjore dhe rregulloret përkatëse. Ndër to, KMD ka evidentuar se:

- Në kuadër të ndjekjes kryesisht dhe ankesës së ardhur nga një grup personash që i përkisnin pakicës rome në qytetin e Shkodrës, rezultoi se Bashkia Shkodër, në kuadër të zbatimit të Projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës” dhe mbështetur në parashikimet e VKM-së nr. 117, datë 26.02.2025 “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken nga projekti “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, Bashkia Shkodër”, kishte larguar nga vend strehimet e tyre ankuesit dhe familjet e tyre, pa i siguruar më parë një strehim të përshtatshëm, duke mbajtur në konsideratë që këto familje i përkisnin një kategorie vulnerabël të shoqërisë, si pjesë e pakicës kombëtare rome. Në përfundim Komisioneri konstatoi se Bashkia Shkodër nuk kishte marrë asnjë masë për të siguruar një strehim të përshtatshëm për ankuesit/familjet e shpërngulura nga bregu perëndimor i liqenit të Shkodrës, duke i ekspozuar ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm.
- Në kuadër të ndjekjes së një çështje kryesisht, Komisioneri konstatoi diskriminimin në formën e rëndë të tij dhe në formën e diskriminimit ndërsektorial, për shkak të “moshës” dhe “gjendjes familjare” të një shtetaseje të moshuar dhe të vetmuar, nga ana e një njësie të vetëqeverisjes vendore, lidhur me mos përmbushjen e detyrimeve për rindërtimin e banesës së saj të dëmtuar rëndë nga tërmeti i vitit 2019, me të gjithë parametrat e nevojshëm teknik, për një jetesë të përshtatshme e dinjitoze.
- Gjatë shqyrtimit të 3 ankesave individuale, është evidentuar se institucione të pushtetit vendor dhe atij qendror, por edhe subjekte private, pavarësisht miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e

hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, ende nuk kanë marrë masat e duhura për plotësimin e standardeve teknike të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sa i përket: përcaktimit të vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara, aksesin në godinat e ndërtuara rishtas apo ato të rikonstruara, mungesës së aksesueshmërisë në infrastrukturën rrugore, trotuare etj.

- Gjithashtu, referuar në ankesat e depozituara nga persona me aftësi të kufizuara, të verbër, Komisioneri ka evidentuar se pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit 8098/1996 *“Për Statusin e të Verbërit”* (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban³⁸ falas dhe transport interurban³⁹/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit, ku procedurat, masat dhe kriteret e këtij përfitimi do të përcaktoheshin me Vendim të Këshillit të Ministrave. Sakaq, Komisioneri ka konstatuar se për shkak të mosmiratimit të VKM-së përkatëse, që nga momenti i miratimit të ndryshimeve ligjore sipërcituar, kategoria e personave të verbër përballen me situata të ndryshme me shoqëritë e transportit, të cilat nuk i lejojnë të udhëtojnë falas apo me 50 % të biletës.
- Edhe gjatë vitit 2025, evidentohen ankesa individuale, nga prindër të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, të cilët për shkak të paqartësive të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, institucionet e vetëqeverisjes vendore, nuk i kanë përzgjedhur përfitues të bursave këto familje.
- Gjatë trajtimit të ankesave individuale në fushën e punësimit, Komisioneri konstatoi se punëmarrësit vijnë të diskriminohen nga ana e punëdhënësve për shkak të ankimeve për diskriminim, përkatësisë në sindikata etj.
- Janë konstatuar, problematika në lidhje me praktika të ndërprerjes së furnizimit me ujë për shkak të mospagesës së detyrimeve nga ana e klientëve që i përkasin kategorive vulnerabël, sikurse janë personat me aftësi të kufizuara, si dhe klientëve të cilët për shkak të gjendjes ekonomike janë në pamundësi financiare për të shlyer detyrimin, sikurse janë personat që janë përfitues të ndihmës ekonomike nga Shteti. Në këtë kontekst, kërkohet që edhe skemat mbështetëse që ofrohen për kategoritë vulnerabël sikurse është marrëveshja për pagesën me këste të detyrimit, duhet të jenë të përshtatshme dhe të përballueshme nga ana e këtyre kategorive.
- Gjatë trajtimit të 12 ankesave individuale, është evidentuar se Agjencia Shtetërore e Kadastrës apo edhe drejtoritë vendore të saj, nuk kanë marrë në shqyrtim brenda afateve të arsyeshme ligjore kërkesat e qytetarëve për legalizimin e objekteve të tyre për periudha të gjata kohore, mbi 10 vite.
- Në kuadër të shqyrtimit të ankesave individuale, është vërejtur një rritje e numrit të tyre sa i përket subjekteve ankues të cilët janë shtetas të huaj. Kryesisht, ankesat e tyre lidhen me trajtimin e pafavorshëm në fushën e punësimit apo edhe atë të shërbimeve.

³⁸ Terminologji e përdorur në këto ligje;

³⁹ Terminologji e përdorur në këto ligje;

7. Proceset Gjyqësore

Pjesëmarrja e KMD në proceset gjyqësore

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, e vendos Komisionerin në një raport të gjerë me gjykatën, duke parashikuar mjaft kompetenca përse i takon pjesëmarrjes së institucionit në proceset gjyqësore. Vendimet e dhëna nga Komisioneri, janë të ankimeshme në gjykatë. Gjithashtu, Ligji parashikon detyrimin e gjykatës për ta njoftuar Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim (Neni 36, pika 3) dhe ka të drejtë t'i kërkojë Komisionerit, që në çdo fazë të procedimit, të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen (Neni 36, pika 4 dhe neni 32, pika 1/gj). Në varësi të pozitës procedurale, Komisioneri merr pjesë në procese gjyqësore si:

- **Palë paditëse në gjykim:** Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020, ka parashikuar se Komisioneri ka kompetencë të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive (neni 32, pika 1, germa (i) dhe 34, pika 4).
- **Palë e paditur në gjykim:** Vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë akte administrative të cilat ankimohen në Gjykatën kompetente sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (neni 33 pika 18).
- **Person i tretë/palë e interesuar në gjykim:** Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon detyrimin e Gjykatës për të njoftuar Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim (Neni 36, pika 3) dhe ka të drejtë t'i kërkojë Komisionerit, që në çdo fazë të procedimit, të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen. KMD thirret në gjykim nga Gjykata kompetente si palë e tretë, në çështje ku kërkohet drejtpërdrejtë konstatimi i diskriminimit dhe dëmshpërblimi për diskriminim në gjykatë.
- **Palë kërkuese:** KMD në cilësinë e palës kreditore, i drejtohet gjykatës me kërkesë për lëshim Urdhri Ekzekutimi për titujt ekzekutiv, me qëllim ndjekjen e procedurave përmbarimore për ekzekutimin e vendimeve me gjobë.
- **Amicus Curiae në Gjykatën Kushtetuese:** Gjykata Kushtetuese mund të vihet në lëvizje me kërkesë të KMD. Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2016 i kanë dhënë të drejtën KMD-së për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke sanksionuar, në nenin 134, se “Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të (e) çdo Komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta”. Edhe Ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me ndryshimet e pësuara me Ligjin Nr. 124/2020, ka parashikuar si kompetencë të Komisionerit dhe vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve (neni 32, pika 1, germa “i/1”)

Pjesëmarrja në proceset gjyqësore.

Gjatë vitit 2025, KMD është thirrur në **101 (njëqind e një) procese gjyqësore**⁴⁰ në raport me 122 (njëqind e njëzet e dy) procese gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2024.⁴¹

Roli i Komisionerit në proceset gjyqësore ku është thirrur si palë ndërgjyqëse, gjatë vitit 2025, paraqitet si vijon:

A. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është thirrur në cilësinë e palës së paditur në 61 (gjashtëdhjetë e një) procese gjyqësore, në raport me 89 (tetëdhjetë e nëntë) procese në vitin 2024. Këto çështje kanë objekt-gjykimi shfuqizimin apo pavlefshmërinë e vendimeve të KMD-së. Konkretisht:

- Në 44 (katërdhjetë e katër) procese gjyqësore, KMD është paditur lidhur me vendimet ku është konstatuar diskriminimi
- Në 7 (shtatë) procese gjyqësore, KMD është paditur lidhur me vendimet ku është konstatuar mosdiskriminim.
- Në 7 (shtatë) procese gjyqësore, KMD është paditur lidhur me vendime mospranim ankese, për shkak të mospërbushjes së kriterëve formale ligjore;
- Në 3 (tre) procese gjyqësore, KMD është paditur lidhur me vendimet ku është vendosur sanksion me gjobë.

B. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është thirrur në cilësinë e personit të tretë në 40 (katërdhjetë) procese gjyqësore, në raport me 33 (tridhjetë e tre) procese në vitin 2024. KMD thirret në gjykim nga Gjykata kompetente si palë e tretë, në çështje ku kërkohet konstatimi i diskriminimit dhe dëmshpërblimi për diskriminim. Në këto çështje gjyqësore, KMD thirret nga pala ndërgjyqëse apo edhe nga Gjykata për të paraqitur një mendim me shkrim të specializuar (*Amicus curiae*), rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetim administrativ, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen. Konkretisht:

- Në 26 (njëzet e gjashtë) procese gjyqësore, në raste të pa shqyrtuara më parë nga Komisioneri, ku palët i janë drejtuar drejtpërdrejtë gjykatës për konstatim diskriminimi dhe ndreqjen e pasojave të ardhura si pasojë e tij nëpërmjet caktimit të dëmshpërblimit;
- Në 14 (katërmëdhjetë) procese gjyqësore, në raste të shqyrtuara më parë nga Komisioneri, ku palët i janë drejtuar gjykatës për dëmshpërblim;

Përsa i takon përfaqësimit ligjor, gjatë vitit 2025, Drejtoria Juridike ka përfaqësuar Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në 279 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë)⁴² seanca gjyqësore, në juridiksionin administrativ dhe civil. Këto seanca gjyqësore ku përfaqësuesit e KMD marrin pjesë përfshijnë si çështjet e reja ashtu edhe çështjet e mbartura nga vitet e mëparshme, për të cilat procesi gjyqësor vijon.

⁴⁰ Të shpërndara gjeografikisht sipas kompetencës në: 53 raste nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (përfshirë këtu edhe 7 kërkesa për lëshim urdhëri pranë kësaj gjykate), 1 rast nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, 4 raste nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, 2 raste nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, 6 raste nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, 1 rast nga Gjykata Administrative e Apelit.

⁴¹ Përfshirë këtu edhe proceset gjyqësore të iniciuara nga KMD me objekt lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, si dhe gjykimet në Gjykatën Kushtetuese.

⁴² Janar - 18 seanca; Shkurt - 17 seanca; Mars - 22 seanca; Prill - 33 seanca; Maj - 29 seanca; Qershor - 33 seanca; Korrik - 13 seanca; Shtator - 19 seanca; Tetor - 37 seanca; Nëntor - 34 seanca; Dhjetor - 24 seanca.

C. URDHRAT E EKZEKUTIMIT

KMD i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshim Urdhri Ekzekutimi për titujt ekzekutiv, me qëllim ndjekjen e procedurave përmbartimore për ekzekutimin e vendimeve me gjobë

KMD i është drejtuar gjykatës me **8 (tetë) kërkesa “Për lëshim Urdhri Ekzekutimi”**, për titujt ekzekutiv, me një vlerë totale të gjobave prej **1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë**, nga të cilat:

- Në 6 (gjashtë) procedura, titujt ekzekutiv janë lëshuar për institucione publike me një vlerë totale të gjobave prej 1.000.000 (një milion) lekë;
Në 2 (dy) procedura, titujt ekzekutiv janë lëshuar për shoqëri tregtare, me një vlerë totale të gjobave prej 200.000 (dyqind mijë) lekë.

Me qëllim vijimin e procedurave të ekzekutimit të vendimeve me gjobë, KMD në cilësinë e palës kreditore, i është drejtuar Zyrrave të Përmbartimit Shtetëror, në cilësinë e palës kreditore, me **8 (tetë) kërkesa “Për vënien në ekzekutim të Urdhërit të Ekzekutimit të lëshuar nga gjykata”**, me një vlerë totale të gjobave prej **2.400.000 (dy milion e katërqind mijë) lekë**, nga të cilat:

- Në 7 (shtatë) procedura, subjekte debitoare janë institucione publike me një vlerë totale të gjobave prej 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) Lekë;
- Në 1 (një) procedurë, subjekt debitor është shoqëri tregtare, me një vlerë gjobe prej 600.000 (gjashtëqind mijë) Lekë.

Zyrrat e Përmbartimit Shtetëror, sipas kompetencës territoriale, zbatojnë procedurat që ligji u ngarkon, me qëllim ekzekutimin e Urdhrave të Ekzekutimit për titujt ekzekutiv, vendimet me gjobë të KMD. Në disa raste, njoftimet lidhur me procedurat e përmbartimit nuk janë kryer rregullisht dhe për këtë arsye, ka lindur nevoja për t’iu drejtuar shkresërisht.

Aktualisht, ndodhen në proces pranë Zyrrave të Përmbartimit, 21 (njëzet e një) vendime gjobe të KMD, për të cilat janë zhvilluar komunikime shkresore gjatë vitit 2025, me qëllim vijimin e ekzekutimit të tyre.

Gjatë vitit 2025, nga Zyrrat e Përmbartimit Shtetëror **janë komunikuar 8 (tetë) vendime për pushimin e Urdhrave të Ekzekutimit, pasi janë ekzekutuar tërësisht vendimet me gjobë të KMD, me një vlerë totale të vjelur prej 2.100.000 (dy milion e njëqind mijë) Lekë.**

- 7 (shtatë) vendime për pushimin e urdhërit të ekzekutimit, si pasojë e shlyerjes së detyrimit, ku palë debitoare kanë qenë institucione publike, dhe vlera totale e gjobës së vjelur është 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë.
- Në 1 (një) procedurë, subjekt debitor ka qenë shoqëri tregtare, dhe vlera totale e gjobës së vjelur është 600 (gjashtëqind mijë) Lekë.

Vendimet Gjyqësore⁴³

Statistika

Gjatë vitit 2025, Gjykatat kompetente kanë dalë me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) vendime gjyqësore, lidhur me çështje ku KMD ka qenë palë, në raport me 98 (nëntëdhjetë e tetë) vendime gjatë vitit 2024.

Nga këto 97 (nëntëdhjetë e shtatë) vendime gjyqësore, rezultojnë:

- 19 (nëntëmbëdhjetë) vendime të gjykatave të juridiksionit civil
- 78 (shtatëdhjetë e tetë) vendime të gjykatave të juridiksionit administrativ.

A. Në rastet kur KMD ka marrë pjesë në cilësinë e palës së e paditur ne proces, gjykatat kanë dhënë 51 (pesëdhjetë e një) vendime gjyqësore, nga të cilat:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka dhënë **39 (tridhjetë e nëntë) vendime** nga të cilat, ka vendosur:
 - 13 vendime “*Rrëzim padie*”, duke lënë në fuqi vendimet e Komisionerit,
 - 5 vendime “*Pranim padie*”, duke shfuqizuar vendimet e Komisionerit, (ankimuar nga KMD, përveç një vendimi të paankimueshëm sipas ligjit)
 - 2 vendime “*Pranim i pjesëshëm i padisë*”, duke shfuqizuar pjesërisht vendimet e Komisionerit, (lenie në fuqi e diskriminimit, shfuqizimi i masës së rikthimit në detyrë)
 - 1 vendim shfuqizim vendimi për konstatim mosdiskriminimi të KMD dhe konstatim diskriminimi të paditëses në të drejtën për punësim
 - 2 vendim “*Kthim padie*”
 - 11 vendime “*Mospranim padie*”
 - 2 vendime “*Rrëzim i kërkesës për sigurim padie*”
 - 2 vendime pushim gjykimi
 - 1 vendim i ndërmjetëm “*Refuzim kërkesë për thirrje personi i tretë*”
2. Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë dhënë **1 (një) vendim**, nëpërmjet të cilit është vendosur:
 - 1 vendim për pushimin e gjykimit.
3. Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë **11 (njëmbëdhjetë) vendime**, nga të cilat:
 - 1 vendim lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka vendosur: rrëzimin e padisë me objekt shfuqizimin e vendimit për konstatim mosdiskriminimi nga KMD
 - 1 vendim lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka vendosur: rrëzimin e padisë me objekt shfuqizimin e vendimit për konstatim diskriminim për bindje politike në punësim.
 - 1 vendim “*Mospranim ankimi*”

⁴³ Kjo pjesë nuk detajon të dhënat në lidhje me përfundimin e të gjitha proceseve gjyqësore, të trajtuara më sipër. Disa prej tyre, kanë përfunduar me vendimmarrje brenda vitit, për të tjerat vijon gjykimi. Për këtë arsye, këtu trajtohen vendimet gjyqësore të komunikuara dhe administruar nga KMD nga Gjykata gjatë periudhës janar – dhjetor 2025 (mund të përfshihen këtu edhe vendime të zbardhura gjatë vitit 2024, por komunikimi i të cilave është bërë gjatë vitit 2025).

- 1 vendim për “Ndryshimin e vendimit të Gj.Adm.Sh.I Tiranë”: rrëzimin e padisë;
- 1 vendim për “Prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim, në të njëjtën gjykatë, me tjetër trup gjykues”;
- 1 vendim “Lënien në fuqi të vendimit Gjykata e Shkallës së Parë, që ka vendosur pranim padie, Shfuqizim vendimi nr. 90 datë 05.04.2018 të KMD”;
- 1 vendim për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që ka vendosur: rrëzim padie të MAS dhe lënie në fuqi të Vendimit nr. 135, datë 02.10.2019 të KMD;
- 1 vendim për “Ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesë padisë me objekt: Shfuqizim i aktit administrativ, Vendimit nr. 66 datë 16.03.2018 të KMD;
- 1 vendim për “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka vendosur: Rrëzimin e padisë me objekt shfuqizim i pikës 1 të Vendimit nr. 32 datë 25.05.2017 të KMD-së dhe konstatimin e diskriminimit;
- 1 vendim për “Lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka vendosur pranimin e padisë me objekt shfuqizim vendimi 128, datë 29.05.2018 të KMD. (depozituar Rekurs nga KMD);
- 1 vendim “Prishje të vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e Shkallës së parë Tiranë”.

B. Në rastet kur KMD ka marrë pjesë në cilësinë e personit të tretë, në çështjet me objekt konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim, gjykata kanë dhënë 41 (katërdhjetë e një) vendime gjyqësore, nga të cilat:

1. **Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë kanë dhënë 17 (shtatëmbëdhjetë) vendime, nga të cilat:**
 - 1 vendim: “Pranim padie, Konstatim diskriminimi për shkak të bindjeve politike; shpërblim dëmi jopasuror: biologjik, moral, ekzistencial, për paditësen A.T. në vlerën 3,477,928 lekë; dëmshpërblim për paditësin B.T në vlerën 1,738,964 lekë, për dëmin jopasuror: moral dhe ekzistencial, të shkaktuar nga diskriminimi i bashkëshortes.”. (Vlera totale e përlogaritur e dëmshpërblimit për diskriminim është: 5,216,592 Lekë)
 - 4 vendime për pranim i pjesëshëm të padisë, nga të cilat është vendosur përkatësisht:
 - a. Konstatim diskriminimi dhe shpërblim dëmi jopasuror në vlerën prej 4,431,466 Lekë⁴⁴
 - b. Shpërblim dëmi jopasuror në formën e dëmit moral në shumën gjithsej 1,373,239 lekë⁴⁵.
 - c. Detyrimin e pales së Paditur MSHMS t’i paguaje paditësit për shkak të diskriminimit dëmin pasuror në shumën 4.883.752 lekë dhe dëmin jo-pasuror në shumën 1.500.000 lek.
 - d. Shfuqizim akti të Komisionit Disiplinor
 - 4 vendime për rrëzim padie
 - 2 vendim pushim gjykimi
 - 3 vendime për kthimin e padisë

⁴⁴ Ankimuar vendimi në apel

⁴⁵ Ankimuar vendimi në apel

- 1 vendim për pezullimin e gjykimit të çështjes
 - 2 vendime për refuzimin e kërkesës për sigurim padie
2. **Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm** kanë dhënë **17 (shtatëmbëdhjetë)** vendime, nga të cilat:
- 7 (shtatë) vendime për pranimin e pjesës së padisë:
 - a. Në 1 rast është vendosur konstatim diskriminimi për shkak të "bindjes politike" dhe "shtatëzani" dhe shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si pasojë e faktit të diskriminimit në shumën 5.338.795,48 Lekë
 - b. Në një rast është vendosur shpërblim dëmi në vlerën 2.910.000 plus interesat nga 2017 deri në ekzekutimin e vendimit;
 - c. Në një rast është vendosur: Detyrimin e Bashkise të rikthje paditesen në periudhë prove, të cilën e ushtronte përpara se të lirohej nga detyra ose në një pozicion ekuivalent me të;
 - d. Në një rast është vendosur ndër të tjera: Konstatimi i diskriminimit dhe detyrimi i punedhënesit të paguaj 500.000 mije për shpërblim dëmi moral dhe 500.000 si shpërblim dëmi ekzistencial;
 - e. Dëmshpërblim për zgjidhje të marrëdhënies së punës (jo dëmshpërblim për diskriminim);
 - f. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses 3 muaj pagë si dëmshpërblim për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës; 1 muaj pagë si shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. (jo dëmshpërblim për diskriminim);
 - g. Konstatimin e diskriminimit të paditëses, detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses 12 paga mujore për zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme.
 - 3 vendime për rrëzimin e padisë
 - 2 vendime për kthimin e padisë
 - 1 vendim për pushimin e gjykimit
 - 1 vendim për pezullimin e gjykimit të çështjes civile deri në përfundim të shqyrtimit administrativ.
 - 1 vendim për rrëzimin e kerkimit lidhur me konstatimin e diskriminimit, pasi përmben gjë të gjykuar,
 - 1 vendim për ngritjen e çështjes së mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore midis Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë dhe Gjykatës Administrative të Apelit.
 - 1 vendim për veçimin e gjykimit lidhur me kerkimin: "Detyrimin e palës të dëmshperbleje paditesin për dëmi pasuror, jopasuror në vlerën 2.000.000 lek, shkaktuar nga diskriminimi i terthorte nga ana e palës së paditur.
3. **Gjykata Administrative e Apelit** ka dhënë **4 (katër) vendim** duke vendosur:
- 1 vendim për lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me objekt: "konstatimin e zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme"

- 1 vendim për “Prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.”.
- 1 vendim për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që ka vendosur: Mospranimin për shqyrtim të ankimit.
- 1 vendim për lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që ka vendosur: Rrëzim padie me objekt konstatim diskriminimi dhe shpërblim dëmi

4. **Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** ka dhënë **3 (tre) vendime**, nga të cilat:

- 1 vendim për “Lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që ka Konstatuar diskriminim në formën e viktimizimit dhe dëmshpërblim 3 paga mujore për dëmin e shkaktuar nga viktimizimi”
- 1 vendim për “Lënien në fuqi të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier” i cili ka vendosur dëmshpërblim 12 paga mujore për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme”
- 1 vendim për “Ndryshimin e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier; Pranimit dhe padisë. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me 12 paga mujore, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme”

C. Gjykata e Lartë ka dhënë **5 (pesë) vendime**, nga të cilat:

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka dhënë **1 (një) vendim**, konkretisht:

- 1 vendim për “Rrëzimin e kërkesës me objekt: “Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit nga Gjykata e Lartë, të çështjes civile datë regjistrimi 10.05.2021. Marrjen e masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes”.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka dhënë **4 (katër) vendime**, nga të cilat:

- 3 vendime për mospranim rekursi.
- 1 vendim për lënien në fuqi të vendimit nr. 1063, datë 18.06.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili ka vendosur: “Kthim i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.”

PRAKTIKA GJYQËSORE LIDHUR ME VENDIMARRJET E KMD

Referuar të dhënave të vendimeve gjyqësore të parashtruara më herët në këtë kapitull, rezulton se në 43 (dyzet e tre) procese gjyqësore të zhvilluara pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Apelit, me objekt kundërshtimin e vendimit të KMD-së (gjykime themeli), pra ku KMD ka marrë pjesë si palë e paditur, në 21 (njëzet e një) prej tyre gjykatat kanë lënë në fuqi vendimin e Komisionerit dhe në 7 (shtatë) raste kanë shfuqizuar vendimin e Komisionerit. Në një analizë më të thellë, rezulton se:

Arsyetimi i gjykatave kompetente në lidhje me disa vendimmarrjet e Komisionerit, që janë bërë objekt gjykimi administrativ, parashtrahet në vijim:

- Në çështjen ku objekt kundërshtimi ka qenë vendimi i gjobës së Komisionerit, sipas të cilit Shoqëria është gjobitur në vlerën 60 000 lekë, për mosdhënie informacioni të kërkuar zyrtarisht në lidhje me ankesë (për të cilën KMD ka dalë me vendimin e themelit Nr. 205 datë 23.11.2022, i cili është lënë pjesërisht në fuqi nga gjykata), Gjykata ka arsyetuar se "vlerësimi i pales paditese mbi masen e informacionit, te pashoqeruar me dokumentacion, nuk e justifikon kete te fundit nga permbushja e detyrimit ligjor, sikunder Komisioneri ka kerkuar ... vendimi Nr. 192/2022 i KMD-se, vleresohet i bazuar ne ligj e ne prova, ndaj gjykata vendos lenien ne fuqi te tij, duke rrezuar padine e shoqerise ... Akti administrativ qe kundërshtohet ne kete padi permban nje denim administrativ me vlere me te vogel se njezetfishi i pages minimale ne shkalle vendi, ndaj ky vendim eshte ligjerisht i paankimueshem."
- "... Në rastin objekt gjykimi, rezulton se pditësi kundërshton vendimin e palës së paditur, i cili ka ngarkuar me detyra për të marrë masa efektive Bashkinë Korçë dhe jo palën paditëse. Për pasojë, Gjykata vlerëson se ngritja e padisë nga paditësi nuk plotëson kushtet e parshikuara nga neni 15 i ligjit të posaçëm nr. 49/2012, pasi nuk evidentohet që ky paditës të ketë interes të ligjshëm për ngritjen e padisë objekt gjykimi. Pra, nuk rezulton prima facie asnjë veprim i palës së paditur e cila ti kundërdrejtohet palës paditëse, përkundrazi vendimi i drejtohet Bashkisë Korçë dhe jo paditësit. Për pasojë, interesat e Bashkisë Korçë mund dhe duhet të mbrohen vetëm nga ky subjekt dhe jo nga paditësi."
- Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6404 datë 17.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka shfuqizuar vendimin nr. 128 datë 08.09.2015 të KMD-së (vendim diskriminimi). Vlerësimi i Kolegjit Administrativ: Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" (i ndryshuar), ekzistenca e të cilave mund ta bënte të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo dispozitë ka renditur qartësisht tre shkaqe për të cilat ushtrohet rekursi në Gjykatën e Lartë.
- Gjykata ka arsyetuar se: "... objekt i këtij gjykimi është vendimi i KMD dhe jo përcaktimi nëse personi i trete ne kete gjykim është diskriminuar apo jo. Kjo është një kompetencë e Komisionerit dhe gjykata nuk ndërhyr në kompetencat e këtij organi publik por verifikon vetëm nëse ato janë zbatuar apo jo në përputhje me ligjin. Ne rastin konkret nga ana e gjykses nuk u verifikua asnje shkak ligjor me pasoje shfuqizimin e pikes 1 te vendimit Nr. 205/2022 te KMD-se per konstatimin e diskriminimit ndaj personit te trete ... Lidhur me pikën e vendimit Nr. 205 datë 23.11.2022, i cili ka disponuar me rikthimin në detyrë të personit të tretë Tom Martini. Gjykata vlerëson se detyrimi për rikthimin në punë të personit të tretë është në kundërshtim me parashikimet e neneve 146/3 dhe 155/3 të Kodit të Punës, i cili ka rregulluar marrëdhënien mes OSSH sh.a., dhe personit të tretë. Çështja e rivendosjes së të drejtave të një punonjësi ka qenë, në disa raste, objekt i rregullimit edhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë e cila në një sërë vendimesh ka mbajtur qëndrimin se e vetmja e drejtë që gëzon ish punëmarrësi nga zgjidhja e marrëdhënies së punës është kërkimi i pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës dhe jo rikthimi në pozicionin e mëparshëm. ... Në këto rrethana, gjykata vlerëson se në kuadër të rivendosjes së të drejtave në rastet e marrëdhënies të punësimit, pavarësisht se Ligji Nr. 10 221/2010 parashikon se në përfundim të hetimit i cili konstaton diskriminimin, duhet bërë rikthimin në gjendjen e mëparshme, për aq sa është e mundur, ky parashikim i përgjithshëm nuk mund të rregullojë situata specifike siç është marrëdhënia e punës, e cila rregullohet nga Kodi i Punës. Ky i

fundit, përveç se është ligj i posaçëm që rregullon marrëdhënien e punësimit, është edhe ligj i cili ka epërsi ndaj Ligjit Nr. 10 221/2010, pasi është miratuar me shumicë të cilësuar. Nga sa më sipër, Gjykata çmon se vendimi Nr. 205 datë 23.11.2022, i cili ka disponuar me rikthimin në detyrë të personit të tretë Tom Martini është i paligjshëm duke qenë se është në tejkalim të kompetencave nga ana e KMD-së. "

- Në një çështje ku KMD është shprehur me vendim mospranimi ankese, Gjykata ka gjetur te ligjshem arsyetimin e KMD-së në vendim, si dhe ka arsyetuar në të njëjten linjë me prapësimet me shkrim të depozituara nga KMD dhe mbrojtjen e realizuar gjate seancave të zhvilluara, sa i takon argumentave në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e vendimit të KMD-se si akt i nxjerre në kundërshtim me ligjin, si dhe kërkimin për detyrimin e KMD-se të marre vendim. Sa i takon kërkimit për konstatimin e diskriminimit ndaj paditesit, gjykata është shprehur ndërsa tjetra se: "*... Në ligjin "Per gjendjen civile, nuk ka të percaktuar nje dispozite ne te cilen te parashikohet ndryshimi i gjinise se shtetasve me kerkese te tyre. ... Pamundesia e paditesit per te ndryshuar gjinine, si perberes te gjendjes civile, eshte nje pamundesie objektive, e cila nuk mund te kategorizohet si diskriminim, ne asnje prej formave te tij."*
- Gjykata ka arsyetuar se: "*Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, Gjykata vlerëson se qëllimi i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, nuk mund të fokusohet vetëm në parimet e përcaktuara në të, por ai synon që gjatë hetimit administrativ, zyra e Komisionerit të vlerësojë çdo të dhënë dhe sjellje të organit publik apo individit që pretendohet se ka diskriminuar, krahasuar me legjislacionin e brendshëm dhe duke mos mbetur vetëm në parashikimet e një ligji të posaçëm, por duke bërë një vlerësim tërësor të legjislacionit. Pasur në konsideratë sa më sipër, Gjykata vlerëson se referimi nga ana e palës së paditur në përmbajtje të vendimit edhe në parashikimeve nga KP, nuk përbën shkak për pavlefshmëri. KMD ka për detyrë që në vlerësimin e sjelljeve të bëjë një hetim tërësor të legjislacionit dhe fakteve e po ashtu, ka në fokus të shtuar mbrojtjen e diskriminimit në marrëdhëniet e punës. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ky pretendim i palës paditëse rezultoi i pambështetur në ligj. ... Paditësi pretendoi se në rastin konkret nuk jemi para diskriminimit në punë për shkak të bindjeve politike, por për faktin se ndërhyrësja dytësore, nuk kishte përmbushur detyrat e saj funksionale siç dhe ishte konstatuar nga auditi. Lidhur me sa më sipër, nga hetimi administrativ, siç u provua dhe nga hetimi gjyqësor, rezultoi se largimi nga puna i ndërhyrësës dytësore është bërë në datën 27.04.2022. Në këtë periudhë nuk kishte përfunduar raporti i auditit siç dhe rezultoi nga përgjigjia që vetë pala paditëse kishte vënë në dispozicion të palës së paditur në fazën administrative. Referuar fakteve, pretendimi se largimi nga puna është bërë për shkak të shkeljeve, nuk qëndron duke qenë se evidentimi i tyre është bërë në një fazë të mëvonshme se ndërhyrësja dytësore të largohet nga detyra. Lidhur me pretendimin e ekzistencës së bindjeve politike si shkak për shkarkimin e ndërhyrësës dytësore, Gjykata i gjen të drejta përfundimet e hetimit administrativ. Kështu, rezultoi e provuar se vetëm para pak ditësh se të bëhej shkarkimi i ndërhyrësës dytësore nga detyra, personi që e zëvendësoi, kishte dhënë dorëheqjen si nëpunës civil i bashkisë pa ndodnjë shkak. Po ashtu, ai është emëruar në pozicionin që më parë e mbante ndërhyrësja dytësore. Nga hetimi administrativ rezultoi e provuar se zëvendëuesi i saj në detyrë ishte përkrahës aktiv i të njëjtës forcë politike si dhe kryetari i zgjedhur i bashkisë. Referuar të dhënave më sipër, Gjykata krijon bindjen se hetimi administrativ i zhvilluar nga KMD është i drejtë dhe se në rastin konkret, shkaqet e paraqitura nga pala paditëse nuk qëndrojnë, por motivi i vërtetë i shkarkimit nga detyra ka qenë motivi i përkatësisë politike. Sa më sipër kërkimet e palës paditëse rezultuan të pambështetura në ligj dhe në prova dhe për këto arsye, Gjykata Administrative e Shkallë së Parë Tiranë, vlerëson se duhet rrëzuar."*

- Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se: "Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr. 552 (80-2019-535), datë 18.02.2020 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është i drejtë, në përputhje me ligjin procedural dhe atë material si dhe i bazuar në prova e për rrjedhojë duhet të lihet në fuqi. Në përfundim për sa më sipër, gjykata vlerëson se nga ana e paditësit FSDKSH, nuk u arrit të provohej një përiligje e arsyeshme dhe objektive, lidhur me mosshqyrtimin e kërkesës së Feriz Ahmetaj për trajtim diskriminues, duke krijuar kështu bindjen se qëndrimi i FSDKSH ndaj tij ishte tendencioz, dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga Ligji 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e FSDKSH, pikërisht për shkak të bindjes së tij politike. Vendimmarrja e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me pikën 3 te vendimit për marrjen e masave për rivendosjen e marrëdhënies së punësimit, adresohet në kuadër të ushtrimit prej Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me statusin e institucionit të pavarur publik, të atributëve që I jepen prej Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin; si dhe përmbushjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin Komisioneri është shprehur me vendim për shkeljen e Ligjit 10221/2010. Është në diskrecion të Komisionerit të Mbrojtjes nga Diskriminimi që bazuar në nenin 33, pika 10 të këtij ligji, të vlerësojë në përputhje me tagrin e tij, e po kështu të vendosi rregullimet dhe masat e duhura që duhen marrë për ndreqjen e situatës dhe për të rivendosur në vend të drejtën e mohuar të subjektit, si dhe gjithë pasojat e ardhura si rrjedhojë e diskriminimit të konstatuar. Për të garantuar mbrojtje efektive nga diskriminimi në punësim, I cili përfshin çdo dallim, kufizim apo përjashtim që bazohet në shkaqet e mbrojtura në ligj dhe që ndër të tjera, ka lidhje me pushimin nga puna apo zgjidhjen e kontratës së punës, duhet të merret masë për rikthimin në punë. Ligji ka të përcaktuar qartazi se "Komisioneri shprehet me vendimVendimi përmban masat dhe rregullimet e duhura, duke caktuar dhe një afat për kryerjen e tyre". Në interpretim literal të dispozitës rezulton se masa apo rregullimi i vendosur nga Komisioneri, rrjedh nga një situatë diskriminimi e konstatuar, pra rrjedh nga shkelja e ligjit organik "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" dhe masa derivon nga ky ligj i cili i ka dhënë Komisionerit diskrecionin që në varësi të konstatimit të situatës diskriminuese, të vendosë masa për rregullimin e situatës. Rregullimi i situatës do të nënkuptonte që palët në konflikt (personi I tretë dhe pala paditëse), të gëzojnë statusin që kishin përpara shfaqjes së vullnetit të paditësit, materializuar me Vendimmarrjen për zgjidhjen e menjëhershme të punës, për shkak të qenies në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kjo masë e vendosur nga Komisioneri gjendet në përputhje me "parimin e proporcionalitetit", neni 12 i K.Pr. Administrative. Ajo është e nevojshme, e përshtatshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, në përpjesëtim me nevojën për ndreqjen e diskriminimit dhe të pasojave të ardhura prej tij"
- Gjykata ka lënë në fuqi Vendimin e KMD, me të cilin ka vendosur: "1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses ..., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Shoqërisë e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a." .. duke arsyetuar, ndër të tjera, se vendimi i KMD është një akt administrativ i drejtë, i bazuar në ligj dhe i nxjerrë në respektim të kërkesave të Ligjit material Nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".
- Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se në rastin konkret pala paditëse nuk ka legjitimitimin formal dhe interes në ngritjen e padisë objekt shqyrtimi. Gjykata arrin në këtë konkluzion duke marrë në konsideratë argumentet si vijon: *Së pari*: në rastin konkret pala e tretë është ankuar pranë KMD, me pretendim se vajza e saj (Savjana Lamçe), nuk është

trajtuar me bursë duke u diskriminuar nga Bashkia Korçë. *Së dyti*, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, KMD me vendimin objekt gjykimi ka konstatuar mosdiskriminimin e nxënësës Savjana Lamçe, nga ana e Bashkisë Korçë. *Së treti*, sikurse rezulton nga rrethanat e rastit objekt shqyrtimi, me Vendimin Nr. 133, datë 16.05.2024, KMD ka disponuar për ankesën e palës ankuese në lidhje me pretendimet për diskriminim nga Bashkia Korçë, dhe si i tillë akti administrativ objekt gjykimi i kundrejtohet e passjellë pasoja vetëm ndaj palës ankuese dhe Bashkisë Korçë. *Së katërti*, akti administrativ objekt gjykimi, vendim nr. 133, datë 16.05.2024 i KMD, nuk i kundrejtohet palës paditëse. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se, nga akti administrativ i kundërshtuar gjyqësisht palës paditëse nuk i është cenuar ndonjë e drejtë subjektive apo ndonjë interes personal, por mund të jenë cenuar interesat e ankuesit (në kushtet kur nuk është konstatuar diskriminim), ose Bashkisë Korçë (në rastin kur konstatohet diskriminim nga kjo e fundit) ... *Së pesti*, në bazë dhe për zbatim të nenit 95 të Kodit të Procedurës Civile, askush nuk mundet të bëjë të vlefshme në emrin e tij të drejtat që nuk i ka. ... Në këtë kontekst, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, në Bashkinë Korçë nuk mund të legjitimohet të kundërshtojë një akt që nuk i sjell detyrime, duke qenë se nuk i cenohen interesa legjitime...

- Në një rast tjetër, në vendimin objekt gjykimi KMD ka konstatuar diskriminim (ne formen e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe viktimizimit) të vajzes së ankueses, për shkak të perkatesisë prinderore, në fushën e arsimit. Vendimi është kundërshtuar pranë Gj.Adm.Sh.I Tirane, e cila me vendim Nr. 2596 datë 04.07.2018 ka vendosur "*Pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit të KMD-se*". Vendimi i cili është ankimuar nga KMD, dhe në gjykimin në dhomë keshillimi, Gjykata e Apelit Administrativ ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit të Gj.Adm.Sh.I Tirane (për pranimin e padisë). Rrezimin e padisë*", me arsyetimin se: "*Vendimi i KMD-se i plotëson kërkesat formale të aktit administrativ pasi është i qartë dhe përmban shpjegimin e situatës faktike, shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe vleresimit të provave, si dhe bazën ligjore. ... Lidhur me situatën faktike, gjykata konstaton se personi i trete vlerësohet ta ketë bazuuar ankesën me të cilën ka vene në levizje KMD, në fakte mbi të cilat mund të prezumohej sjellje diskriminuese nga Kolegji. ... Gjykata vlerëson se pretendimet e personit të trete do të mund të ishin konsideruar të pabazuara vetëm nëse Kolegji do të kishte vertetur para KMD: - plotësimin e numrit të nxenesve për klasën e parë ... - mosregjistrimin prej tij të një numri me të lartë nxenesish nga numri i lejuar. ... Mosvertetimi i rrethanës së plotësimit të numrit të nxenesve dhe regjistrimit të tyre në përputhje me numrin e percaktuar në rregulloren, konfirmon njëherësh: trajtim të vajzes në mënyrë me pak të favorshme sesa shoket e saj në parashkollor; të mosqenit tjetër të trajtimit ndryshe, vecse reagim i kolegjit, ndaj verejtjeve të nënës së vajzes, lidhur me metodat e punës që perdoreshin në Kolegj dhe performancën e mesimdhënies. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson tejet korrekt përfundimin e Komisionerit ...*".
- Paditësi në gjykim, ka paraqitur ankesë në KMD, i cili e ka shqyrtuar dhe në përfundim të hetimit administrativ, me Vendimin Nr. 153 datë 28.07.2022, ka vendosur: "*Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit ,, , për të gjitha shkaqet e pretenduara prej tij, ...*" Ky vendim është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, pasi me kërkesëpadinë e depozituar, pala paditëse kërkon shfuqizimin e vendimit të Komisionerit, me pretendimin se është i pabazuar në ligj dhe prova. Gjykata ka rrëzuar padinë e palës paditëse dhe ka lënë në fuqi Vendimin Nr. 153 datë 28.07.2022 të KMD, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: *Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vlerësuar se ankuesi Edmond Abedinaj nuk i është nënshtruar një trajtimi diskriminues nga punëdhënësi i tij, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e SHISH. Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese për shkaqet e pretenduara nga ankuesi dhe rrjedhimisht nuk konstatohen shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010*

“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” KMD në vendimin e tij, ka arsyetuar në mënyrë provuese, ekzistencën e sjelljes jodiskriminuese të të paditurit ndaj paditësit, si dhe motivin që e ka nxitur paditësin në paraqitjen e ankimit para KMD. Gjykata e gjen të drejtë përfundimin e KMD se trajtimi i ankuesit nga ana e punëdhënësit SHISH është bërë sipas parashikimeve të ligjit të zbatueshëm nr. 9357/2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”. Gjykata arrin në përfundimin si më sipër në kushtet kur rezultoi e provuar në gjykim se: KMD ka zbatuar me përpikmëri procedurën për nxjerrjen e aktit administrativ objekt gjykimi, Vendimit nr. 153 datë 28.07.2022. Në këtë aspekt, është bërë njoftimi i të gjitha palëve për të marrë pjesë në proces dhe për të paraqitur pretendimet dhe provat përkatëse ku mbështesin pretendimet e tyre. Akti administrativ, Vendimi Nr. 153 datë 28.07.2022 përmban të gjithë elementët e formës dhe përmbajtjes dhe është i arsyetuar në përputhje me nenin 99 të KPA-së. Paditësi nuk mundi të provojë se është diskriminuar në mos emërimin e tij si inspektor përsa kohë që mos emërimi i tij ka ardhur për shkaqe që lidhen me kriteret e vendosura nga ligji dhe jo me sjelljen e eprorëve apo drejtuesve të palës së paditur. Mosplotësimi i kriterëve ligjore për tu emëruar si inspektor pranë SHISH nuk mund të konsiderohet si diskriminim për shkak të gjendjes arsimore të paditësit nga ana e organeve publike të paditura në këtë gjykim... Përsa më sipër, në analizë të provave dhe dispozitave ligjore të sipërcituara, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesëpadia e paraqitur nga paditësi Edmond Abedinaj është e pambështetur në prova dhe në ligj në lidhje me kërkimin e saj për konstatimin e diskriminimit dhe paligjshmërinë e aktit administrativ, Vendimit nr. 153, datë 28.07.2022 të KMD.....

- Arsyetim i Gjykatës Administrative të Apelit: "Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk përmban cënim të standarteve, në konceptin e vendimit nr.26, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese e cila nënvizon ndër të tjera se: 9. Gjykata rithekson se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (shih vendimet nr. 55, datë 18.12.2012, nr. 8, datë 28.02.2012, nr. 8, datë 16.03.2011 dhe nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese). 10. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka nënvizuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (shih vendimet nr. 8, datë 16.03.2011, nr. 7, datë 09.03.2009 dhe nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese). 11. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht. duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të

bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në arsyetimin e saj i është përmbajtur edhe orientimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë të shprehura në vendimin unifikues nr.3/2012, duke identifikuar saktë natyrën e mosmarrëveshjes dhe duke vlerësuar në mënyrë të pavarur pretendimet e palëve dhe provat e marra gjatë gjykimit. Në analizë të sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vjen në përfundimin se ankimi i paraqitur nga pala paditëse nuk përmban shkaqe për të ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe për të pranuar padinë e paditësit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në vendimarrjen e ankimit nga paditësi ka cilësuar saktë faktet dhe veprimet lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, duke identifikuar dispozitat ligjore të detyrueshme për tu zbatuar, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, të cilat janë interpretuar me korrektësi."

- Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se: Në seancë gjyqësore u provua se përfundimet e nxjerra nga KMD në dhënien e aktit administrativ objekt shqyrtimi gjyqësor janë të bazuara në prova shpresore dhe për rrjedhojë kërkesë padia e palës paditëse duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova. Në seancë gjyqësore u provua ekzistenca e trajtimit të diferencuar, i pabarabartë dhe i pafavorshëm i nxënësës Antonela dhe Florjan Stojani në raport me nxënësit e tjerë të trajtuar me bursë nga Bashkia Korçë. Nxënësit Antonela dhe Florjan Stojani kanë qenë në të njëjtat kushte dhe rrethana me nxënësit e tjerë që nga Bashkia Korçë janë diferencuar në mostrajtimin e tyre me bursë. Gjykata i gjen të drejta konkluzionet dhe përfundimet e KMD mbi të cilat është bazuar në dhënien e aktit administrativ objekt shqyrtimi gjyqësor.

Arsyet e shfuqizimit të vendimeve të Komisionerit nga Gjykatat.

Arsyetimi i gjykatave kompetente në lidhje me shfuqizimin e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që janë bërë objekt gjykimi administrativ, parashtrohet në vijim:

- Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se: "... Duke hetuar në tërësi provat e administruara në gjykim vlerëson se pala e paditur KMD ka gabuar kur ka vlerësuar se faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se ankuesja Beglie Rada është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshme në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për shkak të bindjeve politike nga Bashkia Kavajë."
- Gjykata ka arsyetuar në lidhje me legjitimitetin aktiv se: "... Paditësi legjitimohet për t'iu drejtuar me padi gjykates për të kërkuar rivendosjen e së drejtës të pretenduar, si të cenuar apo shkelur nga pala e paditur. ... Paditësi në kohën e paraqitjes së padisë nuk ka pasur pozicionin e titullarit të ZV ASHK Tropoje, dhe në kushtet kur në vendimin e KMD-se argumentohet se shtetasi K.Gashi në cilësinë e titullarit të institucionit ka diskriminuar të paditurën A.Alfredaj në formën e shqetësimit ... e vetmja formë për tu mbrojtur ndaj vendimit të KMD-se është të paraqesë padi në cilësinë e individit dhe ish përgjegjesit të ZV ASHK Tropoje. ... Edhe pse vendimi i KMD i referohet formalisht Përgjegjesit të ZV ASHK Tropoje duke mos cituar minimalisht emrin e paditësit, në arsyetimin e vendimit referon në sjellje dhe veprime antiligjore nga paditësi duke shënuar emrin e tij me iniciale. ... Po në arsyetimin e vendimit rezulton se pala e paditur referon tek paditësi here si titullar institucioni dhe here si individ, ndaj gjykata e legjitimon paditësin për t'ju drejtuar gjykates në cilësinë e individit dhe ish përgjegjesit të ZV ASHK Tropoje." Ndersa në lidhje me themelin e çështjes, Gjykata ka arsyetuar se: "Gjate procesit gjyqësor janë administruar mjaft prova të përpiluara nga ankuesja ... prova që rrezojnë pretendimet e ngritura në ankesën drejtuar KMD-se se ajo nuk është zënë me punë gjate kohës së punësimit ... Në vendimin e KMD-se nuk parashtrohet ndonjë rrethane faktike që paditësi ka kryer apo që të ketë trajtuar në mënyrë të padrejte znj.

A. Alfredaj, qe ti krijoje bindjen gjykates mbi vendim-marrjen e saj te drejte. Ne vendimin e KMD-se argumentohet gjeresisht dhe teorikisht trajtimi i pafavorshem, por pa e lidhur me faktet konkrete te ceshtjes. ... Fakti qe ankuesja eshte nen hetim nuk nenkupton se kjo permendje qenka diskriminim ... KMD nuk ka arritur te argumentoje me prova konkrete momentin qe ndan sjelljen diskriminuese te paditesit ndaj ankueses, dhe aq me pak te beje lidhjen mes propozimit per largim nga puna dhe sjelljes diskriminuese".

- *Gjykata e ka shfuqizuar si të pa ligjshem vendimin e Komisionerit me argumentet e meposhtme: Nga aktet e ndodhura në dosje, por edhe nga parashtrimet e palëve gjatë gjykimit, rezultoi se pala e paditur, nuk ka bërë njoftimin në adresën e komunikuar nga Zyra e Gjendjes Civile, duke pretenduar se kjo zyrë nuk ka dhënë informacion për Olsi Jazexhi por për Olsi Jazxhiu. Për këtë arsye, ka vijuar me njoftimin publik të aktit, parashikuar nga neni 162 i Kodit të Procedurave Administrative. Duke ju referuar procedurës së ndjekur nga pala e paditur, gjykata konstaton se pala e paditur në kuadër të identifikimit të subjektit për të cilin ka filluar procedimin administrativ, ka anashkaluar informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si autoriteti më i lartë i shërbimit të gjendjes civile i njohur nga ligji 10 129/2009 "Për gjendjes civile", i ndryshuar, ligj i cili parashikon ndër të tjera se: "Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile" në vijim "Regjistri Kombëtar", është baza e të dhënave shtetërore, ku pasqyrohen dhe përditësohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë". Nga aktet e depozituara nga pala e paditur nuk rezulton që në kuadër të procedimit administrativ të jenë administruar të dhëna të tjera lidhur me gjeneralitetet e paditësit por procedura është inicuar dhe zhvilluar ndaj subjektit me emrin Olsi Jazexhi, ndërkohë që nga informacioni i dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme Gjendjes Civile konfirmohet se "Me të dhënat (emër, mbiemër) ..., nuk rezulton asnjë shtetas i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile". Pra shihet qartë se pavarësisht se pala e paditur i referohet paditësit si subjekt i identifikuar nga pamjet filmike të emisionit televiziv dhe pala paditëse nuk kundërshton faktin se ka marrë pjesë on line në emisionin televiziv, në aspektin e elementëve të formës së aktit, në fakt ka ndëshkuar me masë administrative një person "inekzistent", që nuk identifikohet në regjistrin kombëtar të shtetasve me gjeneralitetet Cënimi i elementëve të formës së aktit ka prekur jo vetëm vendimin objekt gjykimi, por edhe vendimin e mëparshëm nr. 236 datë 29.12.2022, i cili nuk është objekt i këtij gjykimi, por referohet nga gjykata në kuadër të konstatimeve lidhur me tregimin e emrit të subjektit kundravajtës të ndëshkuar administrativisht. Në këtë rast kemi të bëjmë më ndëshkim me gjobë për kryerjen e një kundravajtje administrative të parashikuar nga ligji i posaçëm dhe gjykata i referohet edhe ligjit 10 279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", i cili zbatohet për të gjitha vendimet e organeve të administratës publike, që parashikojnë dënime administrative e që krijojnë pasoja juridike në raste individuale. Në vijim, duke analizuar përmbajtjen e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rastet e dënimeve për kundërvajtje administrative që lidhen me shkelje të ligjit 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtje nga diskriminimi" i ndryshuar, dhe kontrollit të ligjshmërisë në dhënien e dënimeve administrative, shihet qartë se akti administrativ, si një nga format e ushtrimit të veprimtarisë administrative të organeve të ngarkuara në nxjerrjen e tij, duhet të nxirret për një qëllim të caktuar, për të krijuar, ndryshuar apo shuar pasoja konkrete ndaj subjekteve të cilët duhet të individualizohen qartë, pikërisht për shkak të faktit se është subjekti që i kundërshtohet akti ai që mbart detyrimin ligjor për të zbatuar urdhërimet e tij. Pala e paditur edhe pse ka patur informacionin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mik ka zhvilluar procedimin administrativ ndaj shtetasit .., pra me gjeneralitetet që figuron në aktet e gjendjes civile, e për më tepër, edhe pse e ka patur këtë këtë informacion zyrtar gjatë procedimit administrativ dhe para marrjes së vendimit, nuk ka saktësuar gjeneralitetet e subjektit ndaj të cilit zhvillohej procedimi administrativ duke njoftuar*

paditesin në adresën e konfirmuar nga kjo Drejtori, por ka vijuar me procedurat e shpalljes për subjektin me gjeneralitete ... Neni 162 i Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se njoftimi publik bëhet a) kur palët janë të panjohura, b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi: c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur, ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji. Në rastin konkret nuk ndodhemi përpara asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 162 i KPrA pasi palët janë të njohura nga organi publik, vendi për njoftimin është i njohur sipas përgjigjes së kthyer nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe neni 151 i këtij Kodi parashikon se njoftimi bëhet në aj vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit, bj çdo vend, ku marrësi ndodhet, përfshirë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, c) selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, nëse ky i fundit është person juridik ç) vendin e punës, d) vendin e ushtrimit të veprimtarisë ose zyrën e marrësit: dh) çdo vend tjetër, i specifikuar dhe i njoftuar paraprakisht nga pala. Gjykata vlerëson se Kodi i Procedurave Administrative, në Kreun II të tij, ka të mirëpërcaktuar mënyrat dhe mjetet e njoftimit dhe është detyrë e organit publik që të ndjekë dhe të zbatojë me përpikmëri procedurën e njoftimit të parashikuar në këtë Kod. Data nga e cila akti administrativ bëhet detyrues merret si data e fillimit të tij. Data e fillimit është e rëndësishme, jo thjesht për arsye teorike e studimi, por për të llogaritur afatin, kohën që akti fillon të prodhojë efekte juridike për subjektet pasi ky moment shërben për të llogaritur datën e mbarimit të afatit për depozitimin e ankimeve administrative në organet më të larta, të kërkesëpadive në gjykatë, të aplikimeve për rishikim, të veprimeve për dëmshpërblime dhe të çdo lloji kërkesë tjetër që paraqet rëndësi për subjektin konkret. Data e fillimit të efekteve juridike për aktin varet nga Kushtetuta, legjislacioni në fuqi, si dhe nga vetë akti, kur ai e përcakton këtë moment fillimi. Fuqia detyruese e aktit administrativ ndaj subjekteve, të cilëve u drejtohet, është e lidhur me momentin se kur bëhet e zbatueshme kjo fuqi e aktit.”

- Në një çështje konstatim mosdiskriminimi nga Komisioneri, Gjykata ka arsyetuar se: "Referuar provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor sipas parimit të kontradiktoritetit, gjykata vlerëson se... në rastin konkret provohet që pala e paditur ISHTI, të ketë diskriminuar paditësen Pamela Isufati në të drejtën për punësim, për shkak të “zënies së saj me punë për shkak të bindjes politike”. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se akti administrativ, Vendimi nr. 263, datë 03.10.2024 i KMD, me anë të të cilit është rrëzuar kërkesa për të konstatuar diskriminimin e paditëses, në të drejtën për punësim, për shkak të “zënies së saj me punë për shkak të bindjes politike”, është i pabazuar në prova dhe në ligj, ndaj si i tillë duhet shfuqizuar. Në këtë kuadër, pretendimet e palës paditëse janë të bazuara në prova dhe ligj, ndaj padia duhet pranuar. Nga hetimi gjyqësor, rezultoi se pala e paditur KMD ka konstatuar: ... Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorit të DIPNP-së të ISHTI-t. Lidhur me trajtimin në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, të ankueses krahasuar me kolegët e saj, Komisioneri ka vlerësuar se “Pavarësisht faktit që ankuesja ka qenë në një grup inspektimi me kolegen e saj, provohet që ajo është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, krahasuar me të, pasi pavarësisht se ndodheshin në të njëjtat kushte, vetëm për të u mor masa disiplinore më e rëndë, ajo e largimit nga puna, ndërsa ndaj koleges së saj nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë disiplinore, qoftë edhe më e lehtë.”. ... KMD duke marrë në konsideratë mungesën e eksperiencës në procedurat e inspektimit, referuar gabimeve të bëra nga ana e znj. Isufati, ISHTI mund të kishte marrë një masë më të lehtë disiplinore dhe jo të kishte marrë masën më të rëndë, atë të largimit nga puna. Në dhënien e aktit administrativ objekt shqyrtimi gjyqësor, Komisioneri ka vlerësuar se ISHTI, mbështetur në parashikimet e Nenit 13 dhe 15, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, është i detyruar që të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloji diskriminimi, si dhe tu përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra

për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre. Komisioneri nëpërmjet aktit administrativ ka arritur në përfundimin se trajtimi i pabarabartë dhe i pafavorshëm nuk ka ardhur për shkaqe politike, për çdo shkak tjetër..... Gjykata e gjen të pabazuar në prova përfundimin e KMD-së, trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm nga ana e Drejtorit të DIPNP-së të ISHTI të paditëses në punësimin e saj, nuk ka ardhur për bindje politike..... Paditësja si para KMD ashtu dhe në seancë gjyqësore paraqet akte shkresore që tregojnë se ajo për shkak të bindjes politike të familjarëve të saj, pala e paditur ISHTI, e ka trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, në zënie e saj me punë dhe në përfundimin e marrëdhënieve të punës. Në seancë gjyqësore pala paditëse paraqiti aktin shkresor që tregojnë arsyet politike në moszënie e saj me punë, konkretisht: Shkrimet në App Whatsapp, bisedën e kryer ... tregohen emra që i kërkojnë paditëses të votojnë.. Shkresa ... e Partisë Demokratike të Shqipërisë, Dega Gjirokastër, nëpërmjet të cilës tregohet se motra e paditëses, .. është anëtare e degës së PD Gjirokastër.... Angazhimi i saj ka qenë i plotë.. Paditësja është ngarkuar me punë vetëm në muajin Tetor 2023, muaj në të cilin pala e paditur ISHTI ka vendosur zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me shkak disiplinor. KMD nuk ka hetuar shkaqet përse nga pala e paditur ISHTI janë nxjerrë Urdhrat e mësipërm si dhe nuk është zbatuar kontrata individuale e punës.. dt. 16.04.2021 për emërimin në pozicionin Inspektore në Sektorin e Rajonit Jugor-Fier, Vlorë, Berat Gjirokastër në Drejtorinë e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion, mbi bazën e të cilës ajo ka vepruar në zënie e saj me punë vetëm në Tetor 2023. Gjykata çmon se pala e paditur ISHTI për arsye politike nuk ka zënë me punë paditësen si inspektore në zbatim të kontratës individuale të punës nr. 2155/2 Prot, datë 16.04.2021 për emërimin në pozicionin Inspektore në Sektorin e Rajonit Jugor-Fier, Vlorë, Berat Gjirokastër në Drejtorinë e Inspektimit të Pajisjeve Nën Presion. Bazuar në provat shkresore të shqyrtuara në seancë gjyqësore Gjykata çmon se ISHTI ka diskriminuar paditësen Pamela Isufati në të drejtën për punësim për arsye politike dhe për këtë fakt Gjykata çmon se vendimi nr. 263, datë 03.10.2024 i KMD është një akt administrativ i paligjshëm pasi ai është nxjerrë në kundërshtim me rrethanat e faktit dhe dispozitat urdhëruese të ligjit material nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar, ç’ka e bën këtë akt të paligjshëm në kuptim të nenit 109, germa “d” të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin thuhet se: Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është në kundërshtim me ligjin material.”.

- Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se: ... vlerëson se pika 1 e vendimit nr. 128, date 29.05.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që ka të bëjë me konstatimin e diskriminimit për shkak të vendbanimit”, nuk gjen mbështetje në ligj dhe prova dhe si e tillë, me të drejtë është shfuqizuar nga gjykata administrative e shkallës së parë. Po kështu, me vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. krahas të tjerave, është vendosur që: ... DPSHTRR si subjekt ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj subjektit ankues ..., të bëjë rikthimin në vendin e punës. Në lidhje me këtë disponim, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se detyrimi për rikthimin në punë ... është në kundërshtim me të gjithë legjislacionin në Republikën e Shqipërisë, dhe në mënyrë specifike me Kodin e Punës, i cili ka rregulluar marrëdhënien juridike të punës midis pales paditëse dhe personit të tretë. Sa më sipër është arsyetuar, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, vendimi nr. 128, date 29.05.2018 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. nuk gjen mbështetje në ligjin Nr. 10221 date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Kodin e Punës, vendimin unifikues nr 7 date 01.06.2011. të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lane. dhe si tillë me të drejtë është shfuqizuar nga gjykata administrative e shkallës së parë. Për njëdhjetë, ankimi i pales së paditur dhe personit të tretë nuk ka shkaqe ligjore për pranimin e tij, dhe në këto kushte, duhet rrëzuar. Në përfundim Gjykata Administrative e Apelit çmon se, vendimi or. 3365(80-2018-3455), datë 01.10.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet lenë në fuqi.

Praktika gjyqësore lidhur me shpërblimin e dëmit si pasojë e diskriminimit

Arsyetimi i gjykatave kompetente në lidhje me çështjet e shpërbimit të dëmit të shkaktuar nga diskriminimi, si në rastet e shqyrtuara nga KMD ashtu edhe në rastet e diskriminimit të shqyrtuar drejtpërdrejtë nga gjykatat, objekt gjykimi administrativ apo civil, parashtrohet në vijim:

- 1. Vendim me subjekt publik, me masë shpërblim dëmi në vlerën prej 4,431,466 (katër million e katërqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë, për dëmin jopasuror: biologjik, moral dhe ekzistencial, të shkaktuar nga diskriminimi i paditëses, për shkak të bindjeve politike:**

Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se: "*... Në rastin konkret, paditësi ka zgjedhur t'i drejtohet me ankim Komisionerit, organ i cili me vendim, ka vendosur: [...] 1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses, për shkak të bindjeve politike.... Ky vendim i është nënshtruar kontrollit të ligjshmërisë në rrugë gjyqësore mbi padinë e organit publik. Në përfundim të këtij gjykimi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur: "Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova...". Rezulton se ky vendim ka marrë formë të prerë.*

Në këto rrethana të faktit të vërtetuar në gjykim, çështja e konstatimit të diskriminimit për shkak të bindjeve politike të paditëses .., është një fakt i vërtetuar si në hetimin administrativ të kryer nga Komisioneri, ashtu edhe në rrugë gjyqësore. Për rrjedhojë, tashmë kjo çështje në kuptim të ligjit procedural ka efektet e "gjësë së gjykuar" (për më tepër shih vendimin ... e Gjykatës Administrative të Apelit). Në këto kushte, Gjykata vlerëson të disponojë për konstatimin e diskriminimit të ankueses ... për shkak të bindjeve politike, nga ana e palës së paditur. Në vijim të sa më sipër u arsyetua, për gjykatën administrative shtrohet për zgjidhje çështja nëse paditësja përmbush kushtet ligjore të përfitimit të dëmit jopasuror nisur nga mënyra e formulimit të kërtimeve në objektin e padisë në gjykim dhe shkakut ligjor të saj. Referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paditësja i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë, për shkak të bindjeve politike. Në bazë të ligjit 10221/2010 Komisioneri nuk ka tagër për dhënie dëmshpërblimi financiar, ndaj është orientuar ankuesi t'i drejtohet gjykatës për të përfituar këtë dëmshpërblim. Në këtë analizë ligjore, Gjykata vlerëson të evidentojë parashikimet e posaçme të ligjit 10221/2010, i cili ka shërbyer si bazë juridike e padisë në gjykim...".

- 2. Vendim me subjekt shoqëri aksionare, me masë shpërblim dëmi tre paga mujore, të shkaktuar nga diskriminimi i paditësit, për shkak të diskriminimit të konstatuar me vendim të KMD-së.**

Rezulton se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur: - Pranimin e padisë. - Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit.....- Detyrimin e palës së paditur ti paguajë paditësit si dëmshpërblim dëmin e shkaktuar nga viktimizimi në shumën e tre pagave mujore qe ka përfituar paditësi në përfundim të marrëdhënieve të punës.. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar, ndër të tjera, se: "*Gjykata e Apelit vlerëson se, e drejta e paditësit ... e cënuar nga një gjendje e re fakti dhe konkretisht sjellja me natyrë diskriminuese nga ana e palës së paditur si rezultat i paraqitjes së kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, nuk rezulton të jetë e shqyrtuar në dy proceset e mëparshme gjyqësore mes paditësit dhe ... sh.a, për rrjedhojë kërkesëpadia objekt gjykimi ka objekt kërkimi dhe shkak ligjor të ndryshëm nga paditë e mëparshme.... Në konkluzion, Gjykata e Apelit vlerëson se, në rastin konkret nuk ndodhemi përpara institutit të gjësë së gjykuar, për pasojë me të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi janë*

shqyrtuar në themel pretendimet e paditësit nga pikëpamja e faktit dhe e së drejtës, është vendosur pranimi i kërkesëpadisë si i bazuar në ligj e në prova."

3. Vendim me shoqëri aksionare, që njeh konstatimin e pavlefshmërisë së zgjidhjes së Kontratës së Punës mes palëve ndërgjyqëse, referuar parashikimit të nenit 146/1, c dhe Ligjit 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të ndryshuar.

Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se: "Gjykata arrin në konkluzionin se jemi përpara pavlefshmërisë së zgjidhjes së Kontratës së Punës. Neni 146/1/c parashikon mbrojtjen e punëmarrësit nga zgjidhja e pajustificuar e kontratës së punës për arsye diskriminuese. Në rastin konkret, ekzistojnë elementë të qartë të diskriminimit... Në lidhje me kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Gjykata çmon se kërkimi për kthimin në vendin e mëparshëm të punës si dhe detyrimi për të paguar pagat nga momenti i pezullimit e deri në rikthimin në detyrë nuk mund të pranohet për shkak se: *... natyra specifike e pozicionit të Kontrollorit të Trafikut Ajror, që kërkon liçencë të veçantë dhe përmbushje të kushteve specifike sipas Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr. 96/2020), e bën të pamundur urdhërimin e menjëhershëm të rikthimit në pozicionin e mëparshëm. ... Pavarësisht se është konstatuar diskriminimi në zgjidhjen e kontratës së punës, kjo nuk nënkupton automatikisht detyrimin për rikthim në punë. Mbrojtja efektive e të drejtave të punëmarrësit në këtë rast mund të realizohet përmes masave të tjera ligjore, duke përfshirë dëmshpërblimin për zgjidhje të pajustificuar të kontratës dhe për diskriminim."*

4. Vendim me subjekt shoqëri aksionare, me masë shpërblim dëmi 12 paga mujore, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme.

Me këtë vendimmarrje, Gjykata e Apelit ka arsyetuar, ndër të tjera, se: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-5357 (1428), datë 24.10.2019, ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë-padisë.... Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në shqyrtim të akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, objektit dhe shkakut ligjor të kërkesë-padisë, pretendimeve të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, në interpretim të dispozitave të Kodit të Punës, të zbatueshme në rastin konkret, e gjen të pabazuar në ligj dhe në prova arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e për pasojë vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit duhet të pranohet. Në apelin e tij, pala paditëse pretendon se zgjidhja e marrëdhënies së punës është bërë për shkak të bindjes politike të paditësit dhe se ai është diskriminuar. Në nenin 146 të Kodit të punës "Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme", parashikohet se: "*1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: a) punëmarrësi ka pretendime që rrjedhin nga kontrata e punës; b) punëmarrësi ka përmbushur një detyrim ligjor; c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi....*" Gjykata e Apelit sjell në vëmendje se me vendimin nr. 16, datë 12.03.2024 Gjykata Kushtetuese është shprehur se: "*....40. Për sa më lart, Gjykata thekson se neni 18 i Kushtetutës, që parashikon ndalimin e diskriminimit, para së gjithash, sanksionon një detyrim negativ, sipas të cilit askush të mos diskriminohet padrejtësisht për shkaqe që lidhen, ndër të tjera, me bindjet politike ose me gjendjen shoqërore. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit*

ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi. 41. Duke iu rikthyer edhe njëherë çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se në kushtet kur “bindjet politike” dhe “gjendja shoqërore” përbëjnë shkaqe kushtetuese për diskriminim të padrejtë në marrëdhëniet e punës, gjykatat kishin detyrimin të verifikonin pretendimin e kërkueses dhe t’i jepnin përgjigje të arsyetuar, pasi ai ka qenë vazhdimisht i shprehur prej saj dhe vetë pala paditëse e ka konfirmuar këtë në prapësimet e saj përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por edhe në prapësimet e paraqitura në gjykimin kushtetues të çështjes. Në këtë proces verifikimi, gjykatat duhej të analizonin në mënyrë të shprehur nëse faktet e paraqitura nga kërkuësja shërbenin në mënyrë të mjaftueshme që barra e provës për diskriminim të kalonte te punëdhënësi, Posta Shqiptare dhe, eventualisht, ky i fundit, të vërtetonte se nuk kishte ndonjë lidhje shkakësore midis gjendjes shoqërore dhe bindjeve politike të kërkueses dhe trajtimit të pafavorshëm të pretenduar prej saj. Ndërkohë, edhe Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur në lidhje me të, pavarësisht se shkak i pretenduar ka natyrë kushtetuese....” Në zbatim të konkluzioneve të arritura nga Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, Gjykata e Apelit vlerëson se nga ana e palës paditëse është arritur të paraqiten fakte nga të cilat supozohet se ka pasur diskriminim (dhe kjo sipas tij ka ndodhur për shkak të bindjes politike e vërtetuar kjo me kartën e tij të anëtarësisë në Partinë Demokratike), dhe tashmë pala e paditur është ajo që pati barrën e provës, në këtë rast, për të provuar se largimi nga puna i paditësit nuk kishte lidhje me përkatësinë e tij politike apo pse personat e tjerë që ishin në të njëjtat kushte sikurse dhe paditësi ishin vlerësuar më shumë me pikë dhe ishin mbajtur në punë. Kjo palë e paditur dështoi në të provuarit e këtij fakti. Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vendimin nr..., datë, është arritur në përfundimin se nuk konstatohet diskriminim për shkak të bindjes politikenga ana e sh.a. Ky institucion arrin në konkluzion, ndër të tjera, duke patur parasysh se ka patur dhe punonjës të tjerë që kanë punuar në pozicionin rojë dhe kanë patur masa disiplinore dhe janë shkarkuar si dhe shkak për largimin e paditësit është bërë masa disiplinore në fuqi. Nga ana e Gjykatës së Apelit çmohet se ky fakt nuk mund të shërbejë i vetëm për të konkluduar se paditësi nuk është diskriminuar pasi dhe punonjësit e tjerë të marrë në referencë mund të jenë diskriminuar si paditësi, pasi diskriminimi ndodh jo vetëm ndaj një personi të vetëm por edhe një grupi personash.....

Ndryshe nga sa argumenton Gjykata e Shkallës së Parë, paditësi nuk ka detyrimin që të provojë diskriminimin por ai ka detyrimin të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm, ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Pra ndryshe nga sa argumenton kjo gjykatë, barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi. Dhe në rastin konkret rezulton se punëdhënësi nuk përmbushi barrën e provës pasi nuk paraqiti prova të tilla që të ishin të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Gjykata e Apelit, duke i’u referuar këtij fakti, si dhe përmbajtjes së neneve 146/1 germa "c" dhe 144/3 të K. Punës, vlerëson se

zgjdhja e kontratës së punës së paditësit është bërë pa shkaqe të arsyeshme, nga i padituri ... sh.a... Nga përmbajtja e këtij neni rezulton se në rastet kur gjykata ka vlerësuar se zgjidhja e kontratës së punës është bërë pa shkaqe të arsyeshme, punëdhënësi detyrohet që t'i paguajë një dëmshpërblim punëmarrësit, i cili mund të jetë deri në një vit pagë. Gjykata vendos për masën e dëmshpërblimit mbi bazën e kërkesës së punëmarrësit, si dhe duke vlerësuar në kompleks të gjitha rrethanat e çështjes. Në lidhje me masën e këtij dëmshpërblimi, gjykata vlerëson se ai duhet të jetë në masën e një viti pagë. Gjykata arrin në këtë përfundim duke iu referuar kohëzgjatjes së konsiderueshme të marrëdhënieve të punës mes palëve ndërgjyqëse, moshës së thyer të paditësit si dhe veprimeve konkrete të kryera nga i padituri në zgjidhjen e kontratës së punës."

8. Rekomandime dhe opinione ligjore

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të ushtrimit prej tij, me statusin e institucionit të pavarur publik, të attributeve që i jepen prej Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*", (i ndryshuar), për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin; përmbushjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit Nr. 10 221/2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin; si dhe zbatimit të nenit 32, pika 1, gërma "ë", të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon se: "*Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues*", gjatë vitit 2025 ka dhënë rekomandimet për akte ligjore dhe nënligjore, si më poshtë vijon:

Rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore:

1. **Rekomandim për Projektvendimin "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendim nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë."**

Në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Brendshme nr. 3007/1 Prot, datë 30.04.2025, administruar me tonën me nr. 720 Prot, daë 02.05.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar:

1. Rishikimin e pikës 2 të projektvendimit dhe ndryshimin e nenit 158, pika 13, shkronja "dh", të Vendimit nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë*", duke shtuar ndalimin e punonjësit të Gardës së R.Sh. për të shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tij politike, në rrjete, media online apo platforma sociale. Konstatimet për publikime të tilla, nëse janë të bazuara në indicie të qenësishme, mund të përbëjnë bazë për nisjen e një ecurie disiplinore ndaj punonjësit të Gardës së R.Sh. Megjithatë, kujdes duhet patur në drejtim të saktësisimit dhe vërtetimit nëse ky punonjës është i njëjtë me përdoruesin e asaj llogarie në rrjetet e sipërcituara, në çdo rast që përbën indicie për nisjen e një ecurie disiplinore.

- Rishikimin e pikës 3 të projektvendimit dhe shtimin e shkronjës “ë” në pikën 13, të nenit 158, të Vendimit nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, pas shkronjës “e”, të këtij neni, duke pasur në vëmendje lirinë dhe të drejtat e punonjësve të Gardës së Republikës për të marrë pjesë në veprimtari sindikale, me përmbajtje si vijon: “13. Punonjësi gjatë veprimtarisë së tij, zbaton rregullat, si më poshtë vijon:... ë) Punonjësi ka të drejtë të anëtarësohet dhe aktivizohet në organizata sindikale dhe organizatat e punëdhënësve, duke zbatuar parimin e ndalimit të diskriminimit në lidhje me anëtarësinë dhe pjesëmarrjen në veprimtari sindikale, në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin e Punës dhe legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi;”.

Rekomandime në lidhje me Projekt-ligjin "Për Barazinë Gjinore"

Në përgjigje të shkresës së Mnishtisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 1797 Prot., datë 22.04.2025, administruar me tonën me nr. 674 Prot., datë 24.04.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar:

Së pari, në nenin 6, pika 1 të Projekt-ligjit, parashikohet se: “1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes së identitetit gjinor, ose karakteristikave të seksit, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t’i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të njëjtë ose të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. Ky ndalim përfshin edhe diskriminimin ndërsektorial dhe të gjitha format e tjera të diskriminimit.” Pra, në këtë nen garantohet një mbrojtje për disa shkaqe specifike të cituara, të cilat në vlerësimin e Komisionerit janë të gjitha shkaqe që përfshihen nën shkaku të “gjinisë”. Është për t’u vlerësuar fakti që në Projekt-ligj garantohet një mbrojtje më e gjerë duke i përfshirë këto shkaqe, të cilat janë të parashikuara edhe në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, **mirëpo** në dispozitat pasuese të Projekt-ligjit nuk rezultojnë të përcaktuara shkaqet si “orientimi seksual, identiteti gjinor, shprehja e identitetit gjinor, karakteristikat e seksit”, si shkaqe të mbrojtura, por bëhet referimi vetëm tek shkaku i “gjinisë”.

Sa më sipër, KMD rekomandon që në të gjitha fushat/sectorët e veçantë që Projekt-ligji parashikon mbrojtje, të konsiderohen si shkaqe të mbrojtura, jo vetëm “gjinia” por edhe “orientimi seksual, identiteti gjinor, shprehja e identitetit gjinor, karakteristikat e seksit”. Pra, të përcaktohet se ndalohet diskriminimi në këto fusha/sectorë, jo vetëm për shkak të “gjinisë”, por edhe për shkak të “orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes së identitetit gjinor, ose karakteristikave të seksit”.

Së dyti, në nenin 23 “Përfaqësimi gjithpërfshirës dhe i barabartë gjinor në sistemet e vendim-marrjes”, është parashikuar në tërësi se përfaqësimi gjithpërfshirës dhe i barabartë gjinor në sistemet e vendim-marrjes arrihet nëse sigurohet barazia në masën 50 për qind për secilën gjini, përmes transparencës dhe integritetit në proceset e emërimit dhe përzgjedhjes për pozicionet vendimmarrëse në pozicionet drejtuese **vendore**, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, duke mos lejuar në asnjë rast përfaqësimin më pak se 30 për qind për secilën gjini.

Komisioneri vlerëson që është marrë në konsideratë rekomandimi i tij për caktimin e 30% si kuotë dysheme dhe 50% si kuotë tavan, por do të vlerësonte që në pikën 1 të këtij neni, të bëhej një

riformulim pasi ka një lloj lapsusi në përkufizimin e hartuar: “1. Përfaqësimi gjithpërfshirës dhe i barabartë gjinor në sistemet e vendimmarrjes arrihet nëse sigurohet barazia në masën 50 për qind, duke mos lejuar në asnjë rast përfaqësimin më pak se 30 për qind barazia në masën 30 – 50 për qind për secilën gjini, përmes transparencës dhe integritetit në proceset e emërimit dhe përzgjedhjes për pozicionet vendimmarrëse dhe në pozicionet drejtuese vendore, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. ...”, veçanërisht me termin e nënvijëzuar si më lart, i cili vlerësojmë që duhet hequr, për të patur një kuptim më të saktë e të qartë dispozita, si dhe për të qenë uniforme dhe me parashikimet në pikat e tjera të këtij neni.

Së treti, në Pjesën IV “Mbrojtja dhe trajtimi i barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës”, neni 24 “Detyrimet e punëdhënës/sit në marrëdhëniet e punës” i Projekt-ligjit ka përfshirë një pjesë të detyrimeve që edhe Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon në Kreun II të tij “Mbrojtja nga diskriminimi në punësim”. Komisioneri vlerëson që në këtë nen të bëhet referimi tek Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në mënyrë që të gjithë parashikimet e Kreut II të LMD-së të bëhen pjesë e detyrimeve që parashikon neni 24 i Projekt-ligjit “Për barazinë gjinore”.

Së katërti, në Pjesën VII të Projekt-ligjit “Masat dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve”, parashikohen masat dhe sanksionet për arritjen e barazisë gjinore. Konkretisht, në nenin 44, pika 1, parashikohet se: “Masat e përcaktuara në këtë ligj për arritjen e barazisë gjinore nuk përjashtojnë zbatimin e masave të përcaktuara në ligje të tjera për këtë çështje”. Komisioneri vlerëson se megjithë përcaktimin se nuk përjashtohen masa nga ligje të tjera, kjo pjesë e draftit bie deri diku në kontradiktë me Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Përsa kohë në këtë pjesë është referuar se KMD, në zbatim të këtij ligji (“Për barazinë gjinore”), mund të vendosë gjoba dhe masa rregulluese, si dhe është përcaktuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga zbatimi i këtij ligji, palët mund t’i drejtohen KMD-së me ankesë, krijon paqartësinë se kujt ligji do i referohet KMD në të tilla raste. Parashikimeve të nenit 33 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, apo parashikimeve të kësaj pjese të draftit të Ligjit “Për barazinë gjinore”.

Kjo paqartësi krijohet në veçanti nga parashikimi në pikën 1, 2 dhe 3 të nenit 46 të draftit, ku thuhet se: “1. Shkelja e neneve 23, deri 31 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohen nga Inspektorati i Përgjithshëm në përputhje me ligjin për inspektimin në fuqi. 2. Shkelja e neneve 32 deri 43 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga Autoriteti i Medias Audiovizive, Inspektorati i Përgjithshëm, ose nga Komisionerja/Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas rastit. 3. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji dënohen me gjobë si më poshtë: a) personi fizik, nga 60 000 deri 120 000 lekë; b) personi juridik nga 120 000 deri 200 000 lekë; c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkeljen, nga 60 000 deri 160 000 lekë; ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkeljen në bazë të këtij ligji, nga 60 000 deri 160 000 lekë ...”.

Së pari, ndarja e bërë në pikën 1 të nenit 46, në lidhje me nenet, shkelja e të cilave do të përbëjë kundërvajtje administrative, e që dënohen nga Inspektorati i Përgjithshëm, si dhe ndarja e bërë në pikën 2 të nenit 46, e cila e fokuson të drejtën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për të vënë gjoba, vetëm në sektorë të veçantë, automatikisht përjashton institucionin e Komisionerit e Mbrojtjes nga Diskriminimi, në vendosjen e gjobave, për rastet kur konstaton shkelje të dispozitave

nga neni 23 deri në nenin 31. Nene të cilat lidhen veçanërisht me mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë në marrëdhëniet e punës, fushë në të cilën, KMD, referuar Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, shtrin aktivitetin dhe kompetencat e tij.

Pra, ky parashikim në këto dy pika, deri diku mund të themi se kufizon kompetencat e Komisionerit vetëm në fushën e punësimit.

Së dyti, parashikimi në pikën 3 të nenit 46 të draftit, ku përcaktohen vlerat e gjobave në rast të shkeljes së Ligjit “Për barazinë gjinore”, nuk vjen i njëjtë me vlerat e gjobave të përcaktuara në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, në rast shkelje të këtij të fundit. Kjo situatë, krijon konfuzion në rastet kur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në një ankesë/situatë konkrete, mund të konstatojë shkelje të të dy ligjeve në fjalë. Në një situatë të tillë, lind pyetja, se cilat vlera të gjobave do të prevalojnë? A do të përbëjë zbatimin i të dy ligjeve njëkohësisht, një mbivendosje dënimesh?

Sa më sipër, Komisioneri rekomandon që të merret në konsideratë analiza e mësipërme, dhe të vlerësohet për një ndryshim më specifik të këtij neni, duke hequr përjashtimin e vendosur në lidhje me kompetencat e KMD-së në raport me çështjet e punësimit (*nenit 23 – 31 të draftit të Ligjit “Për barazinë gjinore”*), si dhe duke adresuar më qartë situatën e mbivendosjes së dënimeve më gjobë.

Së pesti, Komisioneri vëren se në Projekt-ligj, citohet në disa nene (*konkretisht në nenin 2, germa “a”, nenin 5, pika 1, nenin 10, pika 1, nenin 16, pika 1, germa “e”, nenin 24, pika 1, germa “a” dhe “d”, nenin 32, pika 1, nenin 33, pika 5, germa “c”, nenin 34, pika 1, germa “a”, nenin 35, pika 1, germa “a”, nenin 36, pika 2, germa “f”, nenin 37, pika 1, germa “c” dhe nenin 43, germa “b”*) terminologjia “*diskriminimi gjinor dhe pabarazitë gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë*”, por është e paqartë se çfarë nënkupton ky përcaktim. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson të nevojshëm shtimin në nenin 4 të Projekt-ligjit, të një përkufizimi lidhur me kuptimin e terminologjisë “*diskriminim gjinor dhe pabarazi gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë*”, me qëllim që të bëhet një përshkrim i qartë se çfarë kuptohet me termin në fjalë dhe zbatimin i dispozitave në fjalë të jetë sa më efektiv.

Së gjashti, rezulton në tërësi nga Projekt-ligji, se roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është rritur në raport me parashikimet e ligjit aktual në fuqi, kjo pasi janë shtuar sektorë të veçantë ku do të shtrihen kompetencat dhe detyrimet e këtij institucioni. Nuk rezulton të jetë parashikuar efekti që këto kompetenca dhe detyrime në kuadër të ligjit, do të sjellin në buxhetin e institucionit të KMD-së.

Komisioneri çmon që për zbatimin efektiv të Projekt-ligjit të ri, të parashikohet edhe nevoja për forcimin e kapaciteteve njerëzore të institucionit të KMD-së, me shtesa në strukturë, për të kontribuar kështu efektivisht në zbatimin e ligjit, si dhe për të kontribuar në krijimin e një databaze të re dhe elaborimin e një profili të ri për institucionin.

Bashkërendim për Projekt-Ligjin "Per vullnetarizmin"

Në përgjigje të shkresës së Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, nr. 6874/1 Prot., datë 17.12.2024, administruar me tonën me nr. 1673 Prot., datë 17.12.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar:

➤ Në lidhje me nenin 6, "Vullnetari", të Projekt-ligjit.

Neni 6, pika 2 e Projekt-ligjit, parashikon se: "2. Vullnetar mund të jetë dhe i mituri, një person të cilin i është kufizuar zotësia për të vepruar, ose një person me nevoja të veçanta, që kryen vullnetarizëm sipas përcaktimeve të këtij ligji.". Në kushtet kur në dispozitat vijuese të Projekt-ligjit, konkretisht neni 19 dhe neni 20, njihet një kategori më e gjerë individësh që mund të jenë vullnetarë, të cilët përfshihen tek kategoria e "personave me nevoja të veçanta", Komisioneri rekomandon në mënyrë që dispozitat të ndjekin të njëjtën linjë juridike dhe të garantojnë të njëjtën mbrojtje, pika 2 e nenit 6 të riformulohet duke përfshirë në mënyrë specifike kategoritë që përmenden në nenin 19 dhe 20, të tilla si "persona që i përkasin kategorive të posaçme shoqërore, si personat me aftësi të kufizuara, personat që i përkasin grupeve sociale dhe ekonomike të disavantazhuara", ose duke referuar në këtë nen konkretisht këto dy dispozita.

➤ Në lidhje me nenin 9, "Parimi i trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit të vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit", të Projekt-ligjit.

Në këtë nen është parashikuar se: "1. Ofruesi vullnetarizmit trajton çdo vullnetar në bazë të parimit të shanseve dhe mundësive të barabarta për të gjithë, dhe ndalon diskriminimin për shkak të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, shtetësinë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjinisë, identitetit, gjinor, orientimit seksual, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjen familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjes së jashtme, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. 2. Nuk përbën diskriminim trajtimi i ndryshëm i vullnetarëve, kur: a. bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në pikën 1, e cila, për shkak të natyrës ose kushteve në të cilat do të kryhet vullnetarizmi përbën një kërkesë të vërtetë, profesionale dhe të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj. b. bazohet në kapacitetin e vullnetarëve për të kryer punën ose shërbimin vullnetar. c. parashikohet shprehimisht në këtë ligj. 3. Ofruesi vullnetarizmit dhe vullnetari trajtojnë çdo individ, që është përfitues i vullnetarizmit, në bazë të parimit të shanseve dhe mundësive të barabarta për të gjithë, si dhe ndalojnë diskriminimin për shkak të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, shtetësinë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjinisë, identitetit, gjinor, orientimit seksual, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjen familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjes së jashtme, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. 4. Kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e të drejtës për kryerjen ose përfitimit të vullnetarizmit, sipas këtij ligji, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi."

Komisioneri vlerëson faktin që në nenin 9 të Projekt-ligjit është mbajtur në konsideratë parimi i mosdiskriminimit, dhe jo vetëm, pasi në tërësi në frymën e Projekt-ligjit, është pasqyruar gjerësisht parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe referimi tek Ligji i posaçëm “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Megjithatë, në mënyrë që parashikimi të vijë në përputhje të plotë me listën e shkaqeve të mbrojtura që parashikon neni 1 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri rekomandon që pika 1 dhe 3, e nenit 9, të këtij Projekt-ligjit të riformulohet si vijon: “1. Ofruesi vullnetarizmit trajton çdo vullnetar në bazë të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. ... 3. Ofruesi vullnetarizmit dhe vullnetari trajtojnë çdo individ, që është përfitues i vullnetarizmit, në bazë të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Sa i takon pikës 2 të nenit 9 të Projekt-ligjit, Komisioneri vlerëson se edhe ky parashikim vjen në përputhje të plotë me parashikimin e nenit 6 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Megjithatë, sa i takon germës “b”, të pikës 2, të nenit 9, ku parashikohet se: “... 2. Nuk përbën diskriminim trajtimi i ndryshëm i vullnetarëve, kur: b. bazohet në kapacitetin e vullnetarëve për të kryer punën ose shërbimin vullnetar ...”, Komisioneri rekomandon të bëhet një riformulim i këtij parashikimi pasi në pamje të parë nuk del qartë qëllimi i kësaj dispozite, e mbi të gjitha duket sikur termi “kapacitet” i përdorur, paragjykon atë kategori individësh, për të cilët përlligjet trajtimi i ndryshëm.

Ndërsa sa i takon parashikimit në germën “c” në pikën 2, të nenit 9, Komisioneri rekomandon që të bëhet referimi edhe tek Ligji i posaçëm “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, apo tek ligje të tjera, për një mbrojtje më gjithëpërfshirëse, duke u riformuluar dispozita si vijon: “... 2. Nuk përbën diskriminim trajtimi i ndryshëm i vullnetarëve, kur: ... c. parashikohet shprehimisht në këtë ligj apo në ligje të tjera specifike”.

➤ Në lidhje me nenin 10, “Parimi i mbrojtjes së personalitetit të vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit”, të Projekt-ligjit.

Në lidhje me parashikimin e këtij neni, se: “Ndalohet kryerja e çdo veprimi që përbën shqetësim seksual për vullnetarin ose përfituesin e vullnetarizmit. Shqetësim seksual është çdo formë e padëshiruar sjelljeje, e shprehur me fjalë ose veprime fizike e simbolike, me natyrë seksuale, e cila ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal, në mënyrë të veçantë kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, poshtërues, përcmues ose fytes, që kryhet nga ofruesi i vullnetarizmit

kundrejt një vullnetari ose përfitues vullnetarizmi, midis vullnetarëve, ose midis vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit.” Komisioneri rekomandon riformulimin e tij me qëllim që kjo dispozitë të jetë e përjashtueshme me parashikimin e nenit 3, pika 13 dhe 14 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i cili i konsideron “Shqetësimin” dhe “Shqetësimin seksual”, si forma diskriminimi, duke mos u ndalur kështu vetëm tek sjelljet shqetësuese me natyrë seksiste: “1. Ndalohet kryerja e çdo veprimi që përbën shqetësim për vullnetarin ose përfituesin e vullnetarizmit. Shqetësim është çdo sjellje e padëshiruar, që kryhet nga ofruesi i vullnetarizmit kundrejt një vullnetari ose përfitues vullnetarizmi, midis vullnetarëve, ose midis vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 9 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë. 2. Ndalohet kryerja e çdo veprimi që përbën shqetësim seksual për vullnetarin ose përfituesin e vullnetarizmit. Shqetësim seksual është çdo sjellje e padëshiruar, verbale ose joverbale, e natyrës seksuale, që kryhet nga ofruesi i vullnetarizmit kundrejt një vullnetari ose përfitues vullnetarizmi, midis vullnetarëve, ose midis vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit, e cila ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për të.”

► Në lidhje me nenin 19, “Vullnetari me nevoja të veçanta”, të Projekt-ligjit.

Referuar parashikimit në këtë nen se: “1. Ofruesi i vullnetarizmit duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë krijimit të kushteve për angazhimin si vullnetarë, të personave që i përkasin kategorive të posaçme shoqërore, si personat me aftësi të kufizuara, personat që i përkasin grupeve sociale dhe ekonomike të disavantazhuara dhe personave që u është kufizuar zotësia për të vepruar, me qëllim zhvillimin e personalitetit, fuqizimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. 2. Ofruesi i vullnetarizmit siguron mbështetje dhe mbikëqyrje të përshtatshme gjatë vullnetarizmit, për vullnetarët që i përkasin kategorinë e personave të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni. 3. Vullnetari, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar, mund të kryejë vullnetarizëm dhe lidhë kontratë vullnetarizmi vetëm me pëlqimin me shkrim të kujdestarit të tij ligjor. 4. Vullnetari të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar mund ta ndërpresë vullnetarizëm në çdo kohë, pa nevojën e pëlqimit me shkrim, por duke vënë në dijeni kujdestarin ligjor.” Komisioneri rekomandon me qëllim trajtimin e barabartë të gjithë kategorive vunerabël të cituara, si dhe ofrimin e mundësive dhe garantimin e një aksesit cilësor dhe në baza të barabarta me të tjerët, të riformulohet pika 2 e nenit 19 si vijon: “... 2. Ofruesi i vullnetarizmit siguron mbështetje, aksesueshmëri, trajtim të barabartë dhe mbikëqyrje të përshtatshme gjatë vullnetarizmit, për vullnetarët që i përkasin kategorisë së personave të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni. ...”.

► Në lidhje me nenin 20, “Përfituesi i vullnetarizmit me nevoja të veçanta”, të Projekt-ligjit.

Në këtë nen është parashikuar se: “1. Ofruesi vullnetarizmit, duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë përzgjedhjes, trajnimit dhe mbikëqyrjes së vullnetarëve që angazhohen në një program vullnetarizmi me përfitues individët, që i përkasin kategorive të posaçme shoqërore, si: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me çrregullime të shëndetit mendor, të moshuarit, të miturit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e krimeve seksuale dhe të trafikimit, personave që u është hequr ose kufizuar

zotësia për të vepruar. 2. Ndalohet angazhimi si vullnetarë, në një program vullnetarizmi me përfitues individët, që i përkasin kategorive të posaçme shoqërore, si: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me çrregullime të shëndetit mendor, të moshuarit, të miturit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e krimeve seksuale dhe të trafikimit, personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, i personave si vijon: a) personat të cilët po i nënshtrohen detyrimit për trajtim të pavullnetshëm për sëmundjet e rënda mendore, detyrimit për pjesëmarrje në programe rehabilitimi psikosociale, të alkoologjisë, ose të toksikologjisë, detyrimit për pjesëmarrje në program të aftësimin prindëror, ose ndaj të cilit është vendosur një nga masat e mbrojtjes ndaj dhunës në familje, sipas legjislacionit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. b) personat ndaj të cilëve zbatohet një masë e ndalimit të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale, kur këto lidhen me vullnetarizmin, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi. c) personat që janë në procedim penal ose janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale kundër jetës, shëndetit, krimeve seksuale, lirisë së personit, kundër moralit dhe dinjitetit ose kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi. 3. Në rastin e kryerjes së vullnetarizmit sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 25, ofruesi i vullnetarizmit do të sigurojë mbikëqyrjen e vazhdueshme profesionale të vullnetarit, dhe që vullnetari nuk do të vendoset në kontakt të pa mbikëqyrur me përfituesin e vullnetarizmit, përgjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit. 4. Në rastin e kryerjes së vullnetarizmit sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 25, ofruesi i vullnetarizmit do të sigurojë mbikëqyrjen e vazhdueshme profesionale të vullnetarit, dhe që vullnetari nuk do të vendoset në kontakt të pa mbikëqyrur me përfituesin e vullnetarizmit, derisa të sigurojë dokumentacionin që vërteton se nuk ndodhemi në rastet e ndalimit, të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.”

Në lidhje me dispozitën e mësipërme, vërehet se është përdorur në disa raste, terminologjia “personat me çrregullime të shëndetit mendor”. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se parashikimet e mësipërme duhen riformuluar në raport me këtë terminologji të përdorur duke marrë në konsideratë parashikimet e Konventës “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ratifikuar nga shteti shqiptar me Ligjin Nr. 108/2012.

Në nenin 1 të kësaj Konvente, parashikohet se: “Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.”

Megjithëse, në Ligjin Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, nenin 3, pika 2 jepet përkufizimi “2. “Çrregullim i shëndetit mendor” është çrregullimi thelbësor i mendimit, perceptimit, orientimit ose kujtesës, që dëmtojnë sjelljen, gjykimin, kapacitetin për të njohur realitetin ose aftësinë e personit për të përmbushur kërkesat e jetës, çka e bën atë mendërisht të sëmurë, ose është prapambetja mendore, kur shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të papërgjegjshme”; Komisioneri vlerëson se në Projektligjin “Për vullnetarizmin”, në nenin 20, pika 1 dhe 2, duhet të hiqet terminologjia “persona me ç’rregullime të shëndetit mendor”, duke u zëvendësuar me termin “persona me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor”, duke i’u përshtatur kështu termave universalë të Konventës “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

Sa i takon parashikimit në pikën 1, të nenit 20, në lidhje me kategoritë e individëve përfitues të vullnetarizmit, Komisioneri rekomandon të mbahen në vëmendje si kategori përfituese edhe viktimat e diskriminimit. Në vijë logjike me këtë rekomandim, Komisioneri do të vlerësonte që sa i takon

parashikimit në pikën 2 të nenit 20, në kategoritë e individëve të cilëve i'u ndalohet angazhimi si vullnetarë, të shtohen edhe personat të cilët janë gjetur në shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, me vendim gjykate të formës së prerë apo vendim të organit publik kompetent që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi.

Sa më sipër, Komisioneri rekomandon që pika 1 dhe 2 e nenit 20 të riformulohet si vijon: “1. *Ofruesi vullnetarizmit, duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë përzgjedhjes, trajnimit dhe mbikëqyrjes së vullnetarëve që angazhohen në një program vullnetarizmi me përfitues individët, që i përkasin kategorive të posaçme shoqërore, si: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor, të moshuarit, të miturit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e krimeve seksuale dhe të trafikimit, viktimat e diskriminimit, personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.* 2. *Ndalohet angazhimi si vullnetarë, në një program vullnetarizmi me përfitues individët, që i përkasin kategorive të posaçme shoqërore, si: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor, të moshuarit, të miturit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e krimeve seksuale dhe të trafikimit, viktimat e diskriminimit, personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, i personave si vijon: a) personat të cilët po i nënshtrohen detyrimit për trajtim të pavullnetshëm për sëmundjet e rënda mendore, detyrimit për pjesëmarrje në programe rehabilitimi psikosociale, të alkoologjisë, ose të toksikologjisë, detyrimit për pjesëmarrje në program të aftësimit prindëror, ose ndaj të cilit është vendosur një nga masat e mbrojtjes ndaj dhunës në familje, sipas legjislacionit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. b) personat ndaj të cilëve zbatohet një masë e ndalimit të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale, kur këto lidhen me vullnetarizmin, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi. c) personat që janë në procedim penal ose janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale kundër jetës, shëndetit, krimeve seksuale, lirisë së personit, kundër moralit dhe dinjitetit ose kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi. ç. personat të cilët janë gjetur në shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, me vendim gjykate të formës së prerë apo vendim të organit publik kompetent që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi.”*

- Në lidhje me nenin 21, “Vullnetari i huaj”, dhe nenin 5, “Vullnetarizmi” të Projekt-ligjit.

Në nenin 21 është parashikuar se: “1. *Vullnetari, i cili nuk është shtetas shqiptar, mund të kryejë vullnetarizëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë ligj, legjislacionin kombëtar në fuqi dhe aktet e detyrueshme ndërkombëtare.* 2. *Qëndrimi i vullnetarit të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë rregullohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të huajt.* 3. *Vullnetari i huaj, në moshë të mitur, gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj për vullnetarët e mitur.*”

Komisioneri vlerëson faktin që në këtë Projekt-ligj, është parashikuar dhe garantohet mbrojtje edhe për vullnetarët, shtetas jo shqiptarë, si dhe mbrojtja ligjore referon edhe në ligje të tjera në fuqi. Ndër të tjera, referojmë se edhe Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë këtu edhe personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër, në lidhje me pikën 2 dhe 3 të kësaj dispozite, Komisioneri rekomandon që të riformulohen duke parashikuar se: “... 2. *Qëndrimi dhe trajtimi i vullnetarit të huaj në territorin e*

Republikës së Shqipërisë rregullohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të huajt. 3. Vullnetari i huaj, në moshë të mitur, gëzon në mënyrë të barabartë, të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj për vullnetarët e mitur”.

Njohja e së drejtës për të kryer vullnetarizëm edhe të shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimit të nenit 21 apo nenit 6, pika 1 të Projekt-ligjit ku parashikohet se “1. Vullnetar mund të jetë çdo person, vendas ose i huaj, që gëzon zotësi të plotë për të vepruar sipas legjislacionit në fuqi dhe me vullnet të lirë kryen vullnetarizëm.”, në vlerësimin e Komisionerit, bën automatikisht që kjo e drejtë të reflektohet edhe në dispozita të tjera, të tilla si neni 5, pika 5, duke u riformuluar në: “5. Çdo shtetas shqiptar apo i huaj ka të drejtë kryejë vullnetarizëm dhe të japë kontribut në të mirë dhe interes të publikut ose në dobi të personave të tjerë, pa pasur nevojë të organizohet pranë ose përmes një ofruesi vullnetarizmi.”, në mënyrë që brenda ligjit të ndiqet e njëjta linjë.

➤ Në lidhje me nenin 25, “Përmbajtja e kontratës”, të Projekt-ligjit.

Në lidhje me parashikimin e këtij neni se: “1. Kontrata e vullnetarizmit përmban, veçanërisht: a) identitetin, vendbanimin ose vendqëndrimin e vullnetarit ose prindit/përfaqësuesit ligjor për vullnetarin e mitur. b) numrin personal të identifikimit të vullnetarit ose prindit/përfaqësuesit ligjor për vullnetarin e mitur. c) identitetin dhe adresën e ofruesit të vullnetarizmit. ç) numrin personal të identifikimit të ofruesit të vullnetarizmit. d) identitetin dhe adresën e përfituesit të vullnetarizmit. dh) datën e fillimit, kohëzgjatjen javore dhe vendin e kryerjes së vullnetarizmit. e) përshkrimin e vullnetarizmit që do të kryhet. ë) të drejtat dhe detyrimet e palëve. f) shkaqet dhe mënyrën e zgjidhjes së kontratës. g) të dhënat për shpenzimet që kanë të bëjnë me kryerjen e vullnetarizmit dhe mënyrën e kompensimit të tyre. 2. Në rastin e vullnetarizmit afatshkurtër, ku përfitues të vullnetarizmit janë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me çrregullime të shëndetit mendor, të moshuarit, të miturit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e krimeve seksuale dhe të trafikimit, personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kontratës së vullnetarizmit i bashkëngjitet dhe deklarimi me shkrim i vullnetarit, që ai nuk ndodhet në rastet e ndalimit të përcaktuara në pikën 2, të nenit 21, të ligjit. 3. Në rastin e vullnetarizmit afatgjatë, ku përfitues të vullnetarizmit janë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me çrregullime të shëndetit mendor, të moshuarit, të miturit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e krimeve seksuale dhe të trafikimit, personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kontratës së vullnetarizmit i bashkëngjiten dëshmitë dhe vërtetimet përkatëse nga organet publike kompetente, që vërtetojnë se vullnetari nuk ndodhet në rastet e ndalimit të përcaktuara në pikën 2, të nenin 21, të ligjit. Vullnetari mbledh dokumentacionin provues për llogari të ofruesit të vullnetarizmit. 4. Kontrata e vullnetarizmit mund të përmbajë dhe elemente të tjerë, për të cilat palët bien dakord, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”, Komisioneri vlerëson se, përsa kohë që Projekt-ligji njeh në makro të drejtën për të qenë vullnetar çdo person, vendas ose i huaj, që gëzon zotësi të plotë për të vepruar sipas legjislacionit në fuqi dhe me vullnet të lirë kryen vullnetarizëm, përcaktimi i elementëve të tillë si identiteti apo numri personal i identifikimit, në përmbajtjen e kontratës së vullnetarizmit (pika 1 e nenit 25), do të krijojë problematika për personat pa shtetësi, të cilët mund të rezultojnë pa mjet identifikimi. Në thelb, edhe parashikimi në nenin 24 të Projekt-ligjit ku parashikohet se kontrata e vullnetarizmit është e detyrueshme kur vullnetari është shtetas i huaj apo person pa shtetësi, krijon problematika parë në këtë aspekt, ndaj do duhet të rishikohet ky parashikim i Projekt-ligjit, për të shmangur situata konfliktuale në të ardhmen, gjatë zbatimit të tij.

Sa i takon, parashikimeve në pikën 2 dhe 3, të nenit 25, Komisioneri rekomandon që në linjën e rekomandimeve të mësipërme, të ndryshohet terminologjia “*personat me çrregullime të shëndetit mendor*”, me terminologjinë “*personat me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor*”, si dhe të shtohen si kategori edhe *viktimat e diskriminimit*, përveç kategorisë së cituar si fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit, të miturit, viktimat e dhunës etj.

➤ Në lidhje me nenin 27, “Përfundimi i kontratës”, të Projekt-ligjit.

Komisioneri vlerëson se parashikimi në germën “b” të këtij neni, ku thuhet se “*Kontrata e vullnetarizmit përfundon: ... b) kur vullnetari bëhet i paaftë për të kryer vullnetarizmin.*”, duhet riformuluar pasi termi i “*paaftë*” i përdorur, është një term i papërshtatshëm në kuptim të Konventës “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*”, ratifikuar me Ligj Nr. 108/2012, e cila e konsideron dhe trajton çdo person si të aftë, por me kufizime të caktuara, specifike dhe në asnjë rast nuk përdor këtë terminologji në përcaktim. Në këto kushte rekomandojmë riformulimin e këtij parashikimi ligjor në: “*Kontrata e vullnetarizmit përfundon: ... b) kur vërtetohet fakti i pamundësisë së vullnetarit për të kryer vullnetarizmin.*”

Rekomandime në lidhje me Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 66/2016 "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë"

Në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nr. 8355/1 Prot., datë 24.06.2025, administruar me tonën me Nr. 1014 Prot., datë 30.06.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar:

- Në lidhje me nenin 2, pika 5 të Projekt-ligjit, sipas të cilit “*Në nenin 2, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme: 5. Shkronja “g” ndryshohet si më poshtë: “g) shërbimeve sociale që lidhen me strehimin social, kujdesin për fëmijët dhe mbështetjen e familjeve dhe personave që janë në nevojë të përhershme ose të përkohshme, të cilat ofrohen nga Shteti, nga ofrues të autorizuar nga Shteti ose nga organizata bamirëse të njohura si të tilla nga Shteti.*”

Komisioneri shpreh paqartësinë nëse citimi në fjalë është ezaurues për të gjitha kategoritë e shërbimeve sociale, apo është kufizues vetëm në lidhje me shërbimet sociale që kanë të bëjnë me strehimin social, kujdesin për fëmijët apo mbështetjen e familjeve në nevojë. Sa më sipër, KMD thekson se në rast se dispozita e mësipërme është kufizuese apo përjashton disa kategori të caktuara, duhet të justifikohet për arsye legjitime në relacionin e Projekt-ligjit, në mënyrë që të shmangen në të ardhmen praktika diskriminuese mbi këtë prashikim ligjor.

- Në lidhje me nenin 6 të Projekt-ligjit, sipas të cilit janë shtuar pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3 në nenin 5, pika 1 të ligjit ekzistues: “*Në nenin 5 bëhen këto shtesa: ... 2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3 si më poshtë: “1/1. Ndalimi për të pasur një vendosje në më shumë se një Shtet Anëtar ose për t’u regjistruar në regjistra ose në organizata profesionale ose shoqata në më shumë se një Shtet Anëtar; 1/2. Kufizime mbi lirinë e ofruesit për të zgjedhur ndërmjet një vendosjeje kryesore ose dytësore, veçanërisht detyrimin për ofruesin që të ketë vendosjen kryesore në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose kufizime mbi lirinë për t’u vendosur në formën e një agjencie, dege ose adrese dytësore; 1/3 Kushte të reciprocitetit me Shtetin*

Anëtar në të cilin ofruesi tashmë ka një vendosje, me përjashtim të rasteve të kushteve të reciprocitetit të parashikuara në instrumentet e Bashkimit Evropian në lidhje me energjinë.”

KMD shpreh vlerësimin e tij që janë zgjeruar parashikimet që kufizojnë zbatimin e kriterëve diskriminuesë, megjithatë KMD do të vlerësonte marrjen në konsideratë që kriteret diskriminuesë të mos lidheshin vetëm me “shtetësinë” si shkak i mbrojtur; me numrin e regjistrimeve në shtete anëtare, apo me formën e zgjedhur nga ofruesi.

Sa më sipër, KMD do të rekomandonte që të shihej mundësia që në nenin 4 të Ligjit ekzistues, i cili nuk është përfshirë nga ndryshimet në këtë Projekt-ligj, të refleктоhej një mbrojtje më e gjerë dhe e barabartë para ligjit për çdo person fizik apo juridik, për një listë më të gjerë dhe jo shteruese të shkaqeve të mbrojtura.

Kështu, KMD rekomandon ndryshimin e nenit 4 të ligjit ekzistues, si vijon: “*Ushtrimi i veprimtarisë së shërbimit, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga persona fizikë ose juridikë, duhet të përmbushë këto kritere: a) të mos kushtëzohet nga kritere diskriminuese bazuar në racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër; b) nëse kufizohet, kufizimi duhet të vendoset vetëm për një arsye madhore, që lidhet me interesin publik; c) kufizimet, sipas shkronjës “b”, të këtij neni, në rast se ka të tilla, duhet të jenë të përshtatshme për arritjen e qëllimit të përcaktuar dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij qëllimi.”*

Një formulim i tillë i këtij neni, garanton një mbrojtje më të gjerë dhe më efektive nga diskriminimi, pasi pasqyron një listë më gjithëpërfshirëse dhe joshteruese të shkaqeve të mbrojtura, duke mos u kufizuar vetëm tek “shtetësia”.

Ndryshimi i nenit 4, do t'i hapte rrugë edhe parashikimit në dispozita të tjera, siç është neni 6 i Projekt-ligjit, apo nene të tjera të cituara në vijim, të një liste më të gjerë shkaqesh të mbrojtura.

- Në lidhje me nenin 10 të Projekt-ligjit, sipas të cilit është shtuar Kreu II/1 “*Liria për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare dhe përjashtimet*”.

Komisioneri, sikurse edhe ka argumentuar më sipër, rekomandon që në nenin 9/1 “*Liria për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare*” të Projekt-ligjit, ku parashikohet se: “1. Ofruesit sipas pikës 8 të nenit 4 të këtij ligji i sigurohet qasje falas për ofrimin e shërbimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Kriteret për ofrimin e shërbimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) jo-diskriminuese, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për shtetësinë dhe, në rastin e personave juridikë, për Shtetin e Vendosjes; b) të domosdoshme dhe të justifikuara për arsye të politikës publike, sigurisë publike, shëndetit publik ose mbrojtjes së mjedisit; c) proporcionale dhe të përshtatshme për arritjen e objektivit të synuar, pa tejkalar masën e domosdoshme për arritjen e këtij objekti. 3. Ofruesi nuk mund të kufizohet në lirinë për të ofruar shërbime ndërkufitare në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet parashikimeve të mëposhtme: a) Detyrimit për ofruesin për tu vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) Detyrimi që ofruesi të marrë një autorizim nga autoritetet kompetente shqiptare duke përfshirë edhe regjistrimin pranë një regjistri ose një organi a shoqate profesionale, përveç rasteve të parashikuara në këtë ligj ose akte të tjera të posaçme; c) Ndalimit

për të ngritur një strukturë të çdo lloji dhe forme në territorin shqiptar, e cila është e nevojshme për të realizuar shërbimet në fjalë; ç) Zbatimit të marrëveshjeve specifike kontraktore ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të cilat pengojnë ose kufizojnë ofrimin e shërbimeve nga të vetëpunësuarit; d) Detyrimit të ofruesit për të zotëruar një dokument identifikimi të posaçëm për ushtrimin e një veprimtarie shërbimi, të lëshuar nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë; dh) Kërkesat, përveç atyre të nevojshme për shëndetin dhe sigurinë në punë, të cilat ndikojnë në përdorimin e pajisjeve dhe materialeve që janë pjesë përbërëse e shërbimit të ofruar; e) Kriteret e parashikuara në nenin 13 të këtij ligji. 4. Kushtet e justifikuara për arsye të rendit publik, sigurisë publike, shëndetit publik ose mbrojtjes së mjedisit dhe në përputhje me paragrafin 1, mund të vendosen ndaj ofruesve të shërbimeve ndërkufitare, me kusht që këto kushte të jenë proporcionale me mbrojtjen e kategorive të sipërpërmendura”, të bëhet një reformulim i pikës 2, me qëllim që kriteret jo – diskriminuese për ofrimin e shërbimeve në territorin e R.Sh., të jenë më gjithëpërfshirëse dhe të mos lidhen vetëm me shkakun e “shtetësisë” apo “vendin e vendosjes”: “... 2. Kriteret për ofrimin e shërbimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) jo-diskriminuese, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për shtetësinë dhe, në rastin e personave juridikë, për Shtetin e Vendosjes; apo për çdo shkak tjetër të mbrojtur sipas këtij ligji.⁴⁶”

- Në lidhje me nenin 12 të Projektligjit, sipas të cilit është ndryshuar Kreu IV “Të drejtat e përfituesve dhe cilësia e shërbimeve”.

Duke ndjekur logjikën e mësipërme, Komisioneri rekomandon që në nenin 13 “Të drejtat e përfituesve të shërbimeve”, ku parashikohet se: “... 2. Autoritetet kompetente nuk mund të vendosin kufizime që pengojnë apo vështirësojnë përdorimin e një shërbimi të ofruar nga një ofrues i vendosur në Republikën e Shqipërisë apo në një Shtet Anëtar, përfshirë në mënyrë të veçantë: - kërkesave për autorizim ose për deklaram paraprak; - kufizime diskriminuese mbi dhënien e ndihmës apo mbështetjes financiare për përfituesit, për shkak të vendosjes së ofruesit në një Shtet Anëtar ose për shkak të vendit të ofrimit të shërbimit. 3. Autoritetet kompetente sigurojnë që kushtet e përgjithshme për përfitimin e një shërbimi të caktuar, të bëra publike nga ofruesi, nuk përmbajnë kritere diskriminuese, lidhur me shtetësinë apo vendin e qëndrimit të përfituesit. Ndryshimet, në kushtet për përfitimin nga shërbimi, lejohen vetëm kur justifikohen drejtpërdrejt nga kritere objektive. 4. Përfituesit e shërbimeve kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin në territorin e Republikës së Shqipërisë, informacione të përgjithshme mbi: a) kërkesat e zbatueshme për ushtrimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve e përfitimin prej tyre dhe ato që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve; b) mjetet e ankimit, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet ofruesit dhe përfituesit; c) të dhënat e kontaktit të shoqatave ose organizatave, duke përfshirë qendrat e Rrjetit Evropian të Qendrave të Konsumatorit (European Consumer Centres Network), nga të cilat ofruesit ose përfituesit mund të marrin ndihmë praktike. 5. Kur është e përshtatshme, autoritetet kompetente, vendosin në dispozicion një udhëzues të thjeshtë hap pas hapi, për të përfituar nga të drejtat dhe informacionet e parashikuara në këtë nen. Informacioni dhe ndihma e parashikuar në këtë nen ofrohen në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të paanshme, në distancë, përfshirë edhe përmes mjeteve elektronike, dhe mbahen të përditësuara ...”, të bëhet gjithashtu një formulim duke parashikuar se: “... 2. Autoritetet kompetente nuk mund të vendosin kufizime që pengojnë apo vështirësojnë përdorimin e një shërbimi të ofruar nga një ofrues i vendosur në Republikën e Shqipërisë apo në një Shtet Anëtar, përfshirë në mënyrë të veçantë: - kërkesave për autorizim ose për deklaram paraprak; - kufizime diskriminuese mbi dhënien e ndihmës apo mbështetjes financiare

⁴⁶ Duke patur si referencë në këtë rast, rekomandimin e KMD-së për ndryshimin e nenit 4 të ligjit ekzistues.

për përfituesit, për shkak të vendosjes së ofruesit në një Shtet Anëtar, për shkak të vendit të ofrimit të shërbimit apo për çdo shkak tjetër të mbrojtur në këtë ligj. 3. Autoritetet kompetente sigurojnë që kushtet e përgjithshme për përfitimin e një shërbimi të caktuar, të bëra publike nga ofruesi, nuk përmbajnë kritere diskriminuese, lidhur me shtetësinë, vendin e qëndrimit të përfituesit, apo çdo shkak tjetër të mbrojtur në këtë ligj. Ndryshimet, në kushtet për përfitimin nga shërbimi, lejohen vetëm kur justifikohen drejtpërdrejt nga kritere objektive. 4. Përfituesit e shërbimeve kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin në territorin e Republikës së Shqipërisë, informacione të përgjithshme mbi: a) kërkesat e zbatueshme për ushtrimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve e përfitimin prej tyre dhe ato që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve; b) mjetet e ankimit, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet ofruesit dhe përfituesit, përfshirë edhe procedurat për adresimin e ankesave në rast të pretendimeve për diskriminim nga ofruesit e shërbimeve; c) të dhënat e kontaktit të shoqatave ose organizatave, duke përfshirë qendrat e Rrjetit Evropian të Qendrave të Konsumatorit (European Consumer Centres Netëork), nga të cilat ofruesit ose përfituesit mund të marrin ndihmë praktike. 5. Kur është e përshtatshme, autoritetet kompetente, vendosin në dispozicion një udhëzues të thjeshtë hap pas hapi, për të përfituar nga të drejtat dhe informacionet e parashikuara në këtë nen. Informacioni dhe ndihma e parashikuar në këtë nen ofrohen në mënyrë të qartë, të kuptueshme, të aksesueshme dhe të paanshme, në distancë, përfshirë edhe përmes mjeteve elektronike, dhe mbahen të përditësuara ...”. Reformulimi bëhet jo vetëm që dispozitat të jenë më gjithëpërfshirëse, por edhe për të qenë në përputhje me rekomandimin e bërë nga Komisioneri lidhur me nenin 4 të Ligjit ekzistues.

Ndërsa sa i takon, pikës 5, të nenit 13 të Projekt-ligjit, Komisioneri ka rekomanduar shtimin e termit “të aksesueshme”, me qëllim që informacioni për përfituesit e shërbimeve, në çdo rast, duhet të jetë i tillë që të jetë efektiv dhe të mundësojë aksesueshmëri për të gjithë kategoritë e subjekteve. Madje, duke qenë se një pjesë e mirë e procedurave sipas Projekt-ligjit do të ofrohen online, Komisioneri rekomandon se duhet të mbahet në konsideratë edhe një pikë shërbimi për personat në pamundësi për të kryer vetë këto veprime. Kjo do të ulë burokracinë dhe do të sjellë përputhje më të fortë me Direktivat e BE për shërbimet digjitale.

- Në lidhje me nenin 14 “*Informacion për ofruesit dhe shërbimet e tyre*”, Kreu IV, i ndryshuar, sipas nenit 12 të Projekt-ligjit.

Ku parashikohet se: “1. Ofruesit vendosin në dispozicion të përfituesve informacionin e mëposhtëm: a) emrin, statusin dhe formën juridike, adresën, ku të jenë përcaktuar edhe të dhëna për kontaktim e komunikim të drejtpërdrejtë, sipas rastit, edhe në mënyrë elektronike; b) numrin e regjistrimit në regjistrin përkatës në Shtetin e Vendosjes dhe nëse është e zbatueshme edhe numrin e regjistrimit si subjekt i tatueshëm; c) në rastin kur veprimtaria është objekt i autorizimit, të dhëna për autoritetin kompetent për këtë qëllim apo PVK-në; ç) në rastin e profesioneve të rregulluara, organin profesional apo ndonjë institucion të ngjashëm, ku ofruesi është regjistruar, titullin profesional dhe Shtetin Anëtar ku e ka fituar këtë titull; d) kushtet kontraktore të përgjithshme që përdor ofruesi (nëse ka); dh) dispozitat kontraktore, të përdoruara nga ofruesi, në lidhje me dispozitat e zbatueshme dhe/ose gjykatat kompetente (nëse ka); e) garancitë pas shitjes (nëse ka), jo ato të përcaktuara në ligj; ë) çmimin e shërbimit, kur, për një shërbim të caktuar, është paracaktuar një çmim nga ofruesi për një lloj të caktuar shërbimi; f) karakteristikat kryesore të shërbimit, nëse nuk janë të qarta nga konteksti; g) kontratat e sigurimit dhe garancitë e përgjegjësisë profesionale, të përmendura në nenin 14/1, dhe në veçanti të dhënat e kontaktit të sigurvearit ose garantuesit si dhe mbulimin

territorial. 2. Autoritetet kompetente sigurojnë që informacioni i përmendur në paragrafin 1, sipas preferencës së ofruesit të shërbimit: a) të jepet nga vetë ofruesi me nismën e tij; b) të jetë lehtësisht i arritshëm nga përfituesi në vendin ku ofrohet shërbimi ose ku lidhet kontrata; c) të mund të arrihet lehtësisht në mënyrë elektronike nga përfituesi përmes një adrese të vendosur ne dispozicion nga ofruesi; ç) të përfshihet në çdo dokument informues që i jepet përfituesit nga ofruesi, i cili përmban një përshkrim të hollësishëm të shërbimit që ofron. 3. Me kërkesë të përfituesve, ofruesit kanë detyrimin të paraqesin informacionin e mëposhtëm shtesë: a) çmimin, në rastet kur, për një shërbim të caktuar, ky nuk është paracaktuar nga ofruesi i shërbimit për një lloj të caktuar shërbimi, ose, kur një çmim i saktë nuk mund të jepet, mënyrën e përlllogaritjes së tij apo një vlerë të përafërt të detajuar; b) rregullat profesionale të zbatueshme, sa u takon profesioneve të rregulluara, dhe ku gjenden ato; c) informacion për veprimtaritë e tjera apo partneritetet, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimin e ofruar, dhe masat e marra për të shmangur konfliktin e interesit. Ky informacion përfshihet në çdo dokument informues, ku ofruesi jep një përshkrim të hollësishëm të shërbimit të tij; ç) kodin e sjelljes, mbi të cilin mbështetet ofruesi, si dhe adresën në të cilat këto kode mund të konsultohen, në mënyrë elektronike, me treguesin e versioneve gjuhësore të mundshme (nëse ka); d) në rastet kur ofruesi është anëtar i ndonjë shoqate apo organizate profesionale, që ofron mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore, ofruesi specifikon karakteristikat dhe kushtet e zbatimit të saj. 4. Informacioni i parashikuar në këtë nen ofrohet në kohë të mjaftueshme, përpara nënshkrimit të kontratës apo, në mungesë të një kontrate të shkruar, përpara ofrimit të shërbimit.”

Duke vlerësuar rëndësinë që ka transparencja dhe informimi i përfituesve për garantimin e një tregu të hapur dhe të drejtë të shërbimeve, vëmë në dukje se neni 14 i Projekt-ligjit në fjalë nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjen e mosdiskriminimit në ofrimin e informacionit, ashtu siç kërkohet nga parimet bazë të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i cili ndalon çdo formë diskriminimi, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në fushën e ofrimit të mallrave dhe shërbimeve për publikun, si dhe garanton barazinë në akses dhe informacion për të gjithë.

Në këto kushte, rekomandohet shtimi i dispozitave që sigurojnë përputhshmërinë me këto parime, si vijon: “5. Ofruesit e shërbimit duhet të garantojnë që informacioni të jetë i aksesueshëm, i kuptueshëm dhe i përshtatshëm për të gjithë përfituesit. Ky informacion duhet të jetë i disponueshëm edhe në formate të aksesueshme, sipas nevojave të grupeve të ndryshme. 6. Autoritetet kompetente marrin masa për të monitoruar dhe parandaluar çdo praktikë diskriminuese në mënyrën e ofrimit të informacionit apo përmbajtjen e tij, duke siguruar që të gjitha kategoritë e qytetarëve të kenë qasje të barabartë në informacionin mbi shërbimet.”

Komisioneri gjykon se shtimi i këtyre dispozitave do të harmonizojë projekt-ligjin me standardet e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; do të parandalojë diskriminimin përmes barrierave në aksesin në informacion; do të garantojë një treg shërbimesh të drejtë dhe gjithëpërfshirës; si dhe do të rrisë transparencën dhe besimin e qytetarëve ndaj institucioneve dhe ofruesve të shërbimeve.

- Në lidhje me nenin 13 të Projekt-ligjit, sipas të cilit është shtuar Kreu IV/I “Bashkëpunimi administrativ”

Neni 15/7 i shtuar “Mbikqyrja në rast të zhvendosjes së përkohshme të ofruesit”, parashikon se: “1. Autoritetet kompetente marrin pjesë në mbikëqyrjen e veprimtarisë së ofruesve në territorin e

Republikës së Shqipërisë. Në veçanti, autoritetet kompetente: a) Marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ofruesit të respektojnë kërkesat e përmendura më sipër lidhur me hyrjen në veprimtari dhe ushtrimin të saj; b) Kryejnë kontrollet, inspektimet dhe hetimet e nevojshme për mbikëqyrjen e shërbimeve të ofruara. 2. Për kërkesat që nuk përmenden në paragrafin 1, kur një ofrues zhvendoset përkohësisht në një Shtet Anëtar për të ofruar një shërbim pa qenë i vendosur atje, autoritetet kompetente të atij Shteti Anëtar marrin pjesë në mbikëqyrjen e ofruesit në përputhje me paragrafët 3 dhe 4. 3. Me kërkesë të Shtetit të Vendosjes, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohet shërbimi kryejnë çdo kontroll, inspektim dhe hetim të nevojshëm për të siguruar mbikëqyrjen efektive nga Shteti i Vendosjes. Në këtë mënyrë, autoritetet kompetente veprojnë në masën e lejuar nga kompetencat e tyre. Autoritetet kompetente mund të vendosin për masat më të përshtatshme të zbatueshme në secilin rast individual për të përmbushur kërkesën e Shtetit të Vendosjes. 4. Me iniciativën e tyre, autoritetet kompetente mund të kryejnë kontrolle në terren, inspektime dhe hetime lidhur me ofruesit e shërbimeve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me kusht që këto masa të jenë jo-diskriminuese, të mos bazohen në Shtetin e Vendosjes së ofruesit dhe të jenë proporcionale.”

Në paragrafin 4, theksohet se kontrollet duhet të jenë “jo-diskriminuese”, por Komisioneri sugjeron të shtohet qartazi që kontrollet, inspektimet dhe hetimet të mos bazohen në asnjë kriter diskriminues, përfshirë shtetësinë, vendin e vendosjes së ofruesit, apo çdo shkak tjetër të mbrojtur sipas ligjit të posaçëm. Kjo do të shmangte në vlerësimin tonë, trajtime të padrejta dhe do të promovonte transparencën dhe barazinë.

Gjithashtu, KMD vlerëson se në tekstin e Projekt-ligjit, referohet jo në pak raste parimi i proporcionalitetit, por nuk referohet në asnjë rast se cilat do të jenë kriteret që do të përdoren për të vlerësuar proporcionalitetin. Me qëllim shmangien e arbitraritetit, si dhe për efekt transparence, Komisioneri sugjeron që të merret në konsideratë përcaktimi i këtyre kriterëve në Projekt-ligj.

- Në lidhje me nenin 13 të Projekt-ligjit, sipas të cilit është shtuar Kreu IV/I “*Bashkëpunimi administrativ*”

Neni 15/9 i shtuar “*Informacion për reputacionin e ofruesve të shërbimit*”, parashikon se: “1. Në bazë të një kërkesë me shkrim nga një Shtet Anëtar, autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin përkatës, përcjellin në mënyrë elektronike informacionin mbi masat disiplinore ose administrative, sanksionet penale dhe vendimet që lidhen me falimentimin ose paaftësinë paguese, duke përfshirë mashtrimin dhe krimin ekonomik, të marra nga autoritetet kompetente në lidhje me ofruesin, kur këto masa janë drejtpërdrejt të rëndësishme për aftësitë dhe besueshmërinë profesionale të tij. 2. Autoriteti kompetent informon edhe ofruesin për informacionin e përcjellë tek Shteti Anëtar kërkuar. Kërkesa e bërë sipas paragrafit 1 paraqitet e justifikuar dhe e shoqëruar me arsyetim të qartë për objektin e informacionit të kërkuar. 3. Sanksionet dhe masat e përmendura në paragrafin 1 komunikohen vetëm kur është marrë një vendim përfundimtar dhe i detyrueshëm për ekzekutim. Për vendimet e tjera të zbatueshme të përmendura në paragrafin 1, informacioni i përcjellë përmban sqarimin nëse vendimi është përfundimtar dhe i detyrueshëm apo nëse ndodhet ende në proces ankimi. Në këto raste, autoriteti kompetent raporton edhe datën e pritshme të hyrjes në fuqi të formës së prerë dhe të ekzekutueshme të vendimit. 4. Autoriteti kompetent është i detyruar të specifikojë bazën ligjore mbi të cilën është marrë vendimi përfundimtar. 5. Zbatimi i paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni kryhet në përputhje me parashikimet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe duke respektuar të drejtat e garantuara për personat e shpallur fajtorë ose të dënuar në Shtetet

Anëtare përkatëse, përfshirë edhe vendimet e organizatave profesionale. Informacioni i tillë, kur është publik, vihet në dispozicion të konsumatorëve.”

Ky nen i Projekt-ligjit trajton shkëmbimin e informacionit ndërmjet shteteve anëtare në lidhje me reputacionin profesional të ofruesve të shërbimeve. Duke qenë se ky informacion mund të përmbajë të dhëna të ndjeshme dhe të ndikojë drejtpërdrejt në mundësinë për të ushtruar një aktivitet ekonomik, është thelbësore të garantohet që ky shkëmbim të mos shkelë parimin e mosdiskriminimit.

Komisioneri vlerëson se informacioni për sanksione ose vendime nga shtete të tjera mund të përdoret jo në pak raste për të penguar hyrjen ose operimin e ofruesve të caktuar në tregun shqiptar, sidomos nëse ata i përkasin shteteve më pak të integruara në BE ose komuniteteve vulnerabël.

Kjo dispozitë nuk parashikon qartazi një proces ku ofruesi mund të shprehet ose të kundërshtojë informacionin para transmetimit. Lejimi i publikimit të të dhënave “kur është informacion publik” mund të çojë në stigmatizim disproporcional, sidomos në mungesë të një vlerësimi paraprak mbi ndikimin në reputacionin profesional. Vendosja në një kategori e të gjitha masave sjell rrezik që një shkelje administrative e vogël të përkthehet në diskreditim profesional të padrejtë.

Në këto kushte, KMD sugjeron që në këtë dispozitë të shtohet si parashikim, formulimi si vijon: *“Çdo përdorim ose vlerësim i informacionit mbi reputacionin e ofruesve të shërbimit kryhet në mënyrë objektive, të paanshme dhe jo-diskriminuese, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastet kur informacioni i përcjellë lidhet me vendime jo përfundimtare ose të ankimeshme, autoriteti kompetent duhet të garantojë të drejtën e ofruesit për të dhënë mendimin e tij me shkrim përpara dërgimit të informacionit. Publikimi i informacionit ndaj publikut lejohet vetëm nëse është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesit publik dhe nuk cenon disproporcionalisht të drejtën e ofruesit për privatësi dhe mosdiskriminim.”*

Dispozitat e nenit 15/9 janë të rëndësishme për garantimin e transparencës dhe shkëmbimit të informacionit profesional ndërkufitar. Megjithatë, në mungesë të garancive të forta për mosdiskriminim, proporcionalitet dhe respekt të procedurave të drejtësisë, ekziston rreziku që ky informacion të përdoret në mënyrë selektive ose paragjyquese ndaj ofruesve të caktuar.

Zbatimi i rekomandimeve të mësipërme do të forcojë besimin e palëve në treg, do të shmangë diskriminimin dhe do të garantojë përputhjen e ligjit me të drejtën evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në mbyllje të mendimit të tij, Komisioneri do të vlerësonte nëse në relacionin e Projekt-ligjit do të theksohej nevoja që gjatë përgatitjes së akteve nënligjore dhe harmonizimit sektorial, të ketë konsultime të rregullta me dhomat e tregtisë, shoqatat profesionale dhe OJF-të, për të shmangur pengesa të panevojshme. Ndërsa sa i takon dispozitave kalimtare, të theksohej më qartë se cilat dispozita do të hyjnë në fuqi menjëherë, cilat pas anëtarësimit në BE, dhe cilat mund të testohen me marrëveshje pilot me disa vende anëtare, për të siguruar zbatim të butë.

Rekomandime ne lidhje me Projekt-ligjin "Për Avokatin e Popullit"

Në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit, administruar me datë 26.06.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar:

➤ Në lidhje me nenin 3, “*Parimet e veprimtarisë*”

Ku parashikohet se: “1. Avokati i Popullit, në ushtrimin e funksioneve të tij, udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: a) Pavarësia: Avokati i Popullit vepron në pavarësi të plotë gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tij në përputhje me këtë ligj, si dhe nuk ndikohet qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë e nuk kërkon apo merr udhëzime. b) Paanësia: Avokati i Popullit kryen funksionet e tij paanshmërisht, duke trajtuar të gjitha ankesat, kërkesat apo çështjet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, pa favorizuar asnjë individ, grup apo institucion dhe duke shmangur çdo konflikt interesi. c) Llogaridhënia: Avokati i Popullit është i detyruar të raportojë rregullisht për veprimtarinë e tij para Kuvendit të Shqipërisë, si dhe të sigurojë transparencën e nevojshme para publikut. d) Mbrojtja e konfidencialitetit dhe të dhënave personale: Gjatë hetimit të çështjeve dhe trajtimit të ankesave, Avokati i Popullit dhe stafi i tij ruajnë konfidencialitetin e informacionit dhe të të dhënave të sensitive, përveç rasteve kur është e nevojshme për zbatimin e ligjit apo për mbrojtjen e të drejtave të palëve të përfshira. e) Efikasiteti dhe profesionalizmi: Avokati i Popullit vepron në mënyrë të shpejtë, të efektshme dhe profesionale, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ai siguron që veprimtaria e tij të jetë e bazuar në kompetenca të larta profesionale, me synim dhënien e zgjidhjeve cilësore dhe të qëndrueshme. f) Transparenca: Avokati i Popullit vepron me transparencë të plotë, duke informuar publikun, median dhe shoqërinë civile në mënyrë të vazhdueshme dhe të kuptueshme mbi aktivitetin, gjetjet, rekomandimet dhe qëndrimet e institucionit.” Komisioneri rekomandon që të shtohet si parashikim më vete edhe parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, si vijon: “1. Avokati i Popullit, në ushtrimin e funksioneve të tij/saj, udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: ... g) Barazisë dhe mosdiskriminimit: Avokati i Popullit ushtron kompetencat dhe funksionet e tij/saj duke siguruar të drejtën e çdo personi për barazi dhe mbrojtje të barabartë;”, ose të riformulohet pika 1, germa “b” e këtij neni si vijon: “1. Avokati i Popullit, në ushtrimin e funksioneve të tij, udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: ... b) Paanësisë, barazisë dhe mosdiskriminimit: Avokati i Popullit kryen funksionet e tij/saj paanshmërisht, duke trajtuar të gjitha ankesat, kërkesat apo çështjet në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe të paanshme, pa favorizuar asnjë individ, grup apo institucion dhe duke shmangur çdo konflikt interesi.” **Ky rekomandim evidenton gjithashtu aspektin gjinor i cili duhet reflektuar në vlerësimin tonë, në të gjithë draftin e projekt-ligjit, në mënyrë që të theksohet në ligj e drejta e çdo individ për barazi gjinore dhe për mbrojtje efektive nga diskriminimi me bazë gjinore, në jetën publike dhe private, si dhe të përdoret një gjuhë sa më në përputhje me gjininë gramatikore.**

➤ Në lidhje me nenin 4, “Kushtet për t’u zgjedhur Avokat i Popullit”:

Pika 1, germa “gj”, e këtij neni parashikon se: “1. Avokat i Popullit mund të zgjidhet shtetasi, që në momentin e kandidimit përmbush njëkohësisht këto kushte: ... gj) nuk ka mbushur moshën e plotë ose të pjesshme për pension pleqërie.” Në kushtet kur kjo dispozitë parashikon një kufizim të së drejtës për t’u zgjedhur Avokat Populli, për shkak të “moshës”, Komisioneri rekomandon që kjo dispozitë të gjejë një interpretim apo arsyetim të ligjshëm në relacionin e projektligjit, në mënyrë që

në të ardhmen mos të ndeshemi me praktika diskriminuuese lidhur me këtë kriter. Gjithashtu, Komisioneri rekomandon që për parashikimin në lidhje me “*moshën e pjeseshme të pensionit*”, të bëhet një riformulim, pasi nuk del qartë se çfarë do të kuptohet me këtë terminologji, ose të bëhet referimi tek ligji i posaçëm mbi pensionet.

Nga konsultimi me draftin e Projekt-ligjit, rezulton se në nenin 8, pika 1, germa “dh”, parashikohet si rast i përfundimit të mandatit të Avokatit të Popullit edhe “*mbushja e moshës së pensionit*”. Pra, mbushja e moshës së pjeseshme për pension pleqërie, parashikohet si kriter kufizues për të kandiduar si Avokat Populli, por nuk parashikohet si kriter për përfundimin e mandatit. Në këtë situatë, Komisioneri vlerëson se në mënyrë që qasja në gjithë draftin të jetë e unifikuar, do të duhet që kufizimi i “*moshës së pjeseshme të pensionit*” në nenin 4 të hiqet, duke i u përjasur parashikimit në nenin 8.

➤ Në lidhje me nenin 8, “Përfundimi i mandatit të Avokatit të Popullit”:

Konkretisht, për pikën 1, germa “d” të këtij neni, ku parashikohet se: “1. Mandati i Avokatit të Popullit përfundon në një nga rastet e mëposhtme: a) Kur jep dorëheqjen, me një njoftim të arsyetuar me shkrim drejtuar Kuvendit të Shqipërisë; b) Kur përfundon afati shtatë vjeçar i mandatit; c) Në rast të ndarjes nga jeta; ç) Kur Kuvendi vendos shkarkimin e tij sipas procedurave dhe shkaqeve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj; d) Në rast të shpalljes së paaftësisë së tij mendore ose fizike për të ushtruar funksionin, me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente; dh) Mbush moshën e pensionit.”, Komisioneri rekomandon që duhet të hiqet termi “*i paaftë*” i përdorur, pasi është një term i papërshtatshëm në kuptim të Konventës “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*”, ratifikuar me Ligjin Nr. 108/2012, e cila e konsideron dhe trajton çdo person si të aftë, por me kufizime të caktuara, specifike dhe në asnjë rast nuk përdor këtë terminologji në përcaktim. Në këto kushte, me qëllim edhe unifikimin e terminologjisë qoftë me Konventën apo legjislacionin e brendshëm, rekomandojmë riformulimin e këtij parashikimi ligjor në: “1. Mandati i Avokatit të Popullit përfundon në një nga rastet e mëposhtme: ... d) Në rast të pamundësisë së aftësisë së tij/saj mendore ose fizike për të ushtruar funksionin, vërtetuar me vendimin përkatës; ...”.

Të njëjtin arsyetim, KMD rekomandon edhe për parashikimin në nenin 9, “Shkarkimi i Avokatit të Popullit”, pika 1, germa “b”, ku thuhet se: “1. Avokati i Popullit mund të shkarkohet nga funksioni vetëm në rastet kur: ... b) Është i paaftë mendërisht ose fizikisht për të ushtruar funksionet e tij, të konstatuar me vendim të formës së prerë; ...”, si dhe për nenin 34, “Shkarkimi i komisionerëve”, pika 1, germa “b”, ku thuhet se: “1. Komisioneri mund të shkarkohet nga funksioni në rastet kur: ... b) Është i paaftë mendërisht ose fizikisht për të ushtruar funksionet e tij, të konstatuar me vendim të formës së prerë; ...”.

Sa më sipër, Komisioneri thekson detyrimin për unifikimin në gjithë Projekt-ligjin të terminologjisë që lidhet me personat me aftësi të kufizuara, duke u mbështetur në parashikimet apo përkufizimet që parashikon Konventa “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*”, si dhe Ligji Nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”.

➤ Në lidhje me nenin 10, “Kompetencat e përgjithshme”:

Pika 2, e këtij neni parashikon se: “2. Kompetencat e Avokatit të Popullit zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë individët, pa dallim kombësie, race, gjinie, gjuhe, feje, bindjeje politike ose shoqërore, origjine kombëtare ose shoqërore, apo çdo dallim tjetër”. Sa më sipër, Komisioneri

vlerëson si të arsyeshëm riformulimin e kësaj dispozite, në mënyrë që të garantohet një përfaqëse e formulimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, me parashikimet e Ligjit specifik Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i cili parashikon një gamë më të gjerë shkaqesh të mbrojtura. Kështu, KMD rekomandon riformulimin si vijon: “2. *Kompetencat e Avokatit të Popullit zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë individët, pa dallim race, etnie, ngjyre, gjuhe, shtetësie, bindjesh politike, fetare ose filozofike, gjendje ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjinie, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzënie, përkatësie prindërore, përgjegjësie prindërore, moshe, gjendje familjare ose martesore, gjendje civile, vendbanimi, gjendje shëndetësore, predispozicionesh gjenetike, pamje të jashtme, aftësie të kufizuar, përkatësie në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.*”

➤ **Në lidhje me nenin 21, “Personat dhe aktet jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit”:**

Ku parashikohet se: “1. Avokati i Popullit nuk shqyrton ankesa ose çështje që lidhen me veprimet dhe aktet e nxjerra nga: a) Presidenti i Republikës, përveç rasteve kur janë të lidhura me veprime administrative të strukturave mbështetëse të Institucionit të Presidentit; b) Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, për vendimet ose aktet individuale që lidhen me ushtrimin e kompetencave të tij. 2. Ankesa për çështje që lidhen me veprimet ose mosveprimet administrative të aparatit të Kryeministrit, përfshirë strukturat mbështetëse dhe organet vartëse, janë brenda juridiksionit të Avokatit të Popullit. 3. Avokati i Popullit nuk shqyrton urdhrat me karakter ushtarak të Forcave të Armatosura, përveç rasteve kur ankesa lidhet me të drejtat dhe liritë themelore të ushtarakëve apo qytetarëve të prekur nga këto akte. 4. Vendimet gjyqësore janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, përveç rasteve kur ankesa lidhet me veprime ose mosveprime të administratës gjyqësore, që pengojnë ushtrimin e të drejtave procedurale të palëve ose përbëjnë shkelje të standardeve të administrimit të drejtësisë. 5. Në rastet kur një çështje është duke u shqyrtuar nga gjykata ose organet e prokurorisë, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë informacion, por nuk ndërhyr në procesin e vendimmarrjes së organit të hetimit ose gjykatës. 6. Në rastin e pikave 4 dhe 5, të këtij neni, hetimi dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk cenojnë pavarësinë e gjykatës apo të prokurorisë në marrjen e vendimeve.” Komisioneri vlerëson se në kushtet kur në Projekt-ligjin e ri janë shtuar dhe zgjeruar kompetencat e Avokatit të Popullit, si në raport me sektorin privat ashtu edhe në raport me gjykatat etj., në mënyrë që të mos ketë përplasje mes kompetencave të dy institucioneve (Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi), apo ndërhyrje në veprimtarinë dhe kompetencat e çdo organi tjetër publik, në nenin 17 të Projekt-ligjit, të shtohet pika 7, e formuluar si vijon: “7. Avokati i Popullit nuk shqyrton ankesa ose çështje të cilat janë në kompetencë të institucioneve të tjera të krijuara me ligj të posaçëm, sipas fushës së tyre të veprimtarisë.”

➤ **Në lidhje me nenin 17, “E drejta për të paraqitur ankesa”:**

Pika 3 e këtij neni parashikon se: “3. *Procedurat për paraqitjen e ankesave duhet të jenë të thjeshta dhe të aksesueshme, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të grupeve vulnerabël, përfshirë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat kombëtare.*”

Komisioneri vlerëson së pari se, në mungesë të një përkufizimi të saktë ligjor në legjislationin shqiptar në lidhje me çfarë do të përfshihet apo konsiderohet si “grup vulnerabël”, do të duhet që në Projekt-ligj të reflektohet se çfarë përfshin kjo terminologji, apo të jepet një definicion i saj,

referuar praktikës ndërkombëtare apo referuar ligjeve specifike. Kjo pasi në Projekt-ligj, herë përdoret termi “grup vulnerabël”, herë “grup i marginalizuar”.

Së dyti, citimi i disa grupeve vulnerabël si fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, pakicat kombëtare etj., në dispozitën në fjalë është reduktuese dhe përjashtuese për kategori të tjera që mund të klasifikohen si “grupe vulnerabël”. Në këto kushte, KMD sugjeron që kjo dispozitë të riformulohet duke e lënë listën joshteruese, pra duke mos cituar kategori specifike të ashtukonsideruara “grupe vulnerabël”, por duke e lënë parashikimin të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, të tillë si: “3. Procedurat për paraqitjen e ankesave duhet të jenë të thjeshta dhe të aksesueshme, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të grupeve vulnerabël.”

I njëjti arsyetim mund të shërbejë edhe në rastin e pikës 2, të nenit 18, “Fillimi i shqyrtimit të çështjes” të Projekt-ligjit, ku parashikohet se: “2. Për të miturit, personat me aftësi të kufizuara mendore ose rastet që përfshijnë interesin publik të gjerë, Avokati i Popullit mund të nisë shqyrtimin pa pëlqimin e drejtpërdrejtë të individëve të dëmtuar.”, apo në rastin e pikës 3 të nenit 35, “Personeli dhe burimet njerëzore”, ku parashikohet se: “... 3. Për të garantuar diversitetet dhe përfaqësim të grupeve vulnerabël, rekrutimi synon të përfshijë edhe përfaqësues nga pakicat etnike, komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera të marginalizuara. ...”.

Sa i takon parashikimit të pikës 2 të nenit 18, se Avokati i Popullit mund të nisë shqyrtimin pa pëlqimin e drejtpërdrejtë të individëve të dëmtuar, vlerësojmë se nuk mund të qëndrojë si dispozitë, jo vetëm sepse citimi vetëm i dy kategorive është përjashtues, por edhe sepse institucioni i Avokatit të Popullit, në ligjin e mëparshëm dhe në Projekt-ligjin e ri, **e ka kompetencën për fillimin e shqyrtimit të një çështje me nismën e tij**. Në këto kushte, duket e tepërt, përsëritja e kësaj kompetence në këtë pikë të nenit 18.

Ndërsa, në lidhje me pikën 3 të nenit 35, ku parashikohet se: “... 3. Për të garantuar diversitetet dhe përfaqësim të grupeve vulnerabël, rekrutimi synon të përfshijë edhe përfaqësues nga pakicat etnike, komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera të marginalizuara.”, Komisioneri vlerëson se detyrimi për respektimin e diversitetit, meritokracisë, mosdiskriminimit, përfaqësimin gjinor etj., gjatë procedurave të rekrutimit nga ana e institucioneve publike është goxha i elaboruar në ligje të posaçme, ndaj vlerësohet e tepërt që të bëhet ky përcaktim në këtë nen, kur institucioni fare mirë mund t’i referohet drejtpërdrejtë parashikimeve në ligje specifike për zbatimin e këtyre detyrimeve, pa qenë nevoja për t’i përshtjelluar në Projekt-ligj. Për më tepër, që në pikën 3 të këtij neni, ka një listë reduktuese që kufizon përfaqësimin e grupeve të tjera vulnerabël apo të marginalizuara, përse kohë që liston vetëm tre kategori prej tyre.

➤ **Në lidhje me nenin 37, “Këshilli për të Drejtat e Njeriut”:**

Ku parashikohet se: “1. Pranë Avokatit të Popullit krijohet Këshilli për të Drejtat e Njeriut, si organ këshillimor, i përbërë nga: a) Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile; b) Akademikë dhe ekspertë të pavarur në fushën e të drejtave të njeriut; dhe/ose c) Përfaqësues të institucioneve të të drejtave të njeriut. 2. Këshilli ka për detyrë të ndihmojë Avokatin e Popullit në: a) Hartimin e strategjive për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut; b) Përgatitjen e raporteve dhe rekomandimeve mbi çështje të veçanta. 3. Anëtarët e Këshillit përzgjidhen nga Avokati i Popullit në bazë të një procesi të hapur dhe të transparent dhe mund të marrin kompensim për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre, sipas dispozitave të legjislationit në fuqi.”, Komisioneri vlerëson se përfshirja

në Këshillin për të Drejtat e Njeriut të përfaqësuesve të institucioneve të të drejtave të njeriut, përbën një vlerë të shtuar të këtij organi këshillimor, por parashikimi se të gjithë anëtarët do t'i nënshtrohen një procesi përgjedhës nga ana e Avokatit të Popullit, do duhet të riformulohet, pasi **ky parashikim mund të vlejë vetëm për përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, apo për ekspertët e pavarur, por jo për përfaqësuesit e institucioneve të të drejtave të njeriut.**

Rekomandime lidhur me Projektligjin për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje

Në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 4145 Prot, datë 24.10.2025, administruar me tonën me nr. 1497 Prot, datë 27.10.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar:

Së pari, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vëren se Direktiva 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datë 14 Maj 2024 “*Për luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*”, kërkon që Organet Kombëtare të Barazisë të jenë organe të caktuara për ofrimin e mbështetjes dhe parandalimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Konkretisht, Direktiva parashikon se: *(50) Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe rëndësinë e veprave penale të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe nevojat specifike për mbështetje të viktimave, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që organet e caktuara të ofrojnë mbështetje shtesë dhe të parandalojnë vepra të tilla penale. Duke pasur parasysh ekspertizën e tyre në çështjet e diskriminimit për shkak të seksit, organet kombëtare të barazisë, të ngritura në përputhje me Direktivën e Këshillit 2004/113/KE (9) dhe 2010/41/BE (11) dhe Direktivat 2006/54/KE (10) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, janë në një pozitë të mirë për të kryer këto detyra. Për t'u mundësuar këtyre organeve të kryejnë në mënyrë efektive detyrat e tyre, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që atyre t'u ofrohen burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.*

Në kuadër të përafrimit të Direktivës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se duhen shtuar parashikime shprehimisht në projektligj që KMD, si organ barazie i posaçëm dhe me ekspertizë në çështjet e diskriminimit për shkak të seksit, të jetë i sanksionuar për ofrimin e mbështetjes dhe parandalimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Në këtë kuadër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon, por pa u kufizuar, që projektligji të ndryshohet, si më poshtë:

Në nenin 44 “Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik” të projektligjit të ndryshohet përmbajtja si vijon “1. Nën drejtimin e autoritetit kryesor përgjegjës, autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, median, shoqërinë civile, komunitetet e prekura dhe institucione të tjera të përfshira në të drejtat dhe mbrojtjen ligjore dhe psikologjike të viktimave sipas këtij ligji, relizojnë mbi baza planifikimeve vjetore fushata ose programe të rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut.”

Në nenin 45 “Trajnimi i profesionistëve”, të projektligjit të ndryshohet përmbajtja si vijon “2. Autoriteti kryesor përgjegjës bashkëpunon, por pa u kufizuar, me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, Shkollën e Magjistraturës, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit,

Akademine e Sigurisë, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë, Shollën e Avokatisë, Urdhrin e Psikologut dhe Punonjësit Social, Shërbimin e Provës, Përmbarrimin, Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetsor dhe Shoqëror, Autoritetin e Mediave Audiovizive, OJF dhe me organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematia që lidhen me çështje të dhunës ndaj grave dhe dhunës në marrëdhëniet familjare.”

Si konkluzion, në kuadër të përafrimit të Direktivës 2024/1385 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 14 Maj 2024 “*Për luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon që të parashikohet shprehimisht KMD, si organ barazie që bashkëpunon me autoritetin kryesor përgjegjës për ofrimin e mbështetjes dhe parandalimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje/ lidhur me fushata apo programe të rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut, duke shtuar atë në Kreun VII të projektligjit “Parandalimi”.

Së dyti, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vëren se Direktiva 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 Maj 2024 “*Për luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*”, kërkon që organet kombëtare, duke përfshirë organet e barazisë, të publikojnë raporte dhe të adresojnë rekomandime lidhur me çdo çështje që lidhet me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, duke përfshirë dhe grumbulimin e praktikave më të mira ekzistuese si dhe shkëmbimin e informacionit me organet evropiane, siç është Instituti Evropian për Barazi Gjinore.

Konkretisht, Direktiva parashikon, në nenin 22 “*Roli i organeve kombëtare, duke përfshirë organet e barazisë*” se: “1. Shtetet Anëtare duhet të caktojnë dhe do të bëjnë rregullimet e nevojshme që një ose më shumë organe të kryejnë detyrat e mëposhtme: (a) publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, duke përfshirë mbledhjen e praktikave të mira ekzistuese; dhe (b) shkëmbimin e informacionit të disponueshëm me organet përkatëse evropiane, siç është Instituti Evropian për Barazi Gjinore. Për qëllimet e nënparagrafit të parë, Shtetet Anëtare mund të konsultohen me organizatat e shoqërisë civile. 2. Organet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni mund të jenë pjesë e organeve të barazisë të krijuara në përputhje me Direktivat 2004/113/KE, 2006/54/KE dhe 2010/41/BE.”

Sa më sipër, rezulton se nuk ka parashikime shprehimisht në projektligj sa i takon publikimit të raporteve dhe dhënies së rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje apo shkëmbimit të informacionit të disponueshëm me organet përkatëse evropiane, siç është Instituti Evropian për Barazi Gjinore.

Në kuadër të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikohet se “*Komisioneri ka kompetencë: të publikojë raporte dhe të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*” (neni 32, pika 1, germa “f”). Në zbatim të saj, KMD mund të bëjë rekomandime për çështje që lidhen me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, por në kuadër të konsiderimit si formë e diskriminimit. Pra, vlerësojmë se fusha e zbatimit të këtij ligji, nuk ezauron kërkesat e Direktivës. Për më tepër, mbetet e pa adresuar dhe kërkesa për shkëmbimin e informacionit.

Si konkluzion, në kuadër të përafrimit të Direktivës 2024/1385 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 14 Maj 2024 “Për luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon që të parashikohet shprehimisht në projektligj që organet kombëtare, duke përfshirë organet e barazisë, të publikojnë raporte dhe të adresojnë rekomandime lidhur me çdo çështje që lidhet me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, duke përfshirë dhe grumbullimin e praktikave më të mira ekzistuese si dhe shkëmbimin e informacionit me organet evropiane, siç është Instituti Evropian për Barazi Gjinore.

Së treti, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vëren se Direktiva 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 Maj 2024 “Për luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”, kërkon krijimin e një sistemi për mbledhjen, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave mbi dhunën ndaj grave ose dhunën në familje, i cili duhet të përmbajë të dhëna të disagreguara sipas seksit, grupmoshës (fëmijë/i rritur) të viktimës dhe të autorit të veprës penale dhe, kur është e mundur dhe e përshtatshme, marrëdhënien midis viktimës dhe autorit të veprës penale si dhe llojit të veprës penale, lidhur me sa kërkoht që të evidentohen si statistika të disponueshme në nivel qendror.

Konkretisht, Direktiva parashikon, në nenin 44 “Mbledhja dhe grumbullimi i të dhënave”, se:

“1. Shtetet Anëtare duhet të kenë një sistem për mbledhjen, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave mbi dhunën ndaj grave ose dhunën në familje.

2. Statistikat e përmendura në paragrafin 1, duhet të përfshijnë si minimum, të dhënat ekzistuese të mëposhtme, të disponueshme në nivel qendror, të disagreguara sipas seksit, grupmoshës (fëmijë/i rritur) të viktimës dhe të autorit të veprës penale dhe, kur është e mundur dhe e përshtatshme, marrëdhënien midis viktimës dhe autorit të veprës penale si dhe llojit të veprës penale:

(a) numri vjetor i veprave penale të raportuara dhe i dënimeve për dhunë ndaj grave ose dhunë në familje, të marra nga burimet administrative kombëtare;

(b) numri i viktimave që janë vrarë për shkak të dhunës ndaj grave ose dhunës në familje;

(c) numri dhe kapaciteti i strehëzave për çdo Shtet Anëtar; dhe

(d) numri i thirrjeve në linjat kombëtare të ndihmës.”

Sa më sipër, rezulton se nuk ka parashikime shprehimisht në projektligj sa i takon llojit të statistikave të kërkuara dhe të mënyrës së mabjtjes së të dhënave të dhënavtë disagreguara, gje që nuk ezauron kërkesat e Direktivës.

Si konkluzion, në kuadër të përafrimit të Direktivës 2024/1385 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 14 Maj 2024 “Për luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon që të parashikohet shprehimisht në projektligj krijimi i një sistemi për mbledhjen, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave mbi dhunën ndaj grave ose dhunën në familje, i cili duhet të përmbajë statistika, të disponueshme në nivel qendror, me të dhëna të disagreguara sipas seksit, grupmoshës (fëmijë/i rritur) të viktimës dhe të autorit të veprës penale dhe, kur është e mundur dhe e përshtatshme, marrëdhënien midis viktimës dhe autorit të veprës penale si dhe llojit të veprës penale, dhe që duhet të përfshijnë si minimum, të dhënat ekzistuese, por pa u kufizuar në: (a) numrin vjetor të veprave penale të raportuara dhe të dënimeve për dhunë ndaj grave ose dhunë në familje, të marra nga burimet administrative kombëtare; (b) numrin e viktimave që

janë vrarë për shkak të dhunës ndaj grave ose dhunës në familje; (c) numrin dhe kapacitetin e strehëzave; dhe (d) numrin ethirrijeve në linjat kombëtare të ndihmës.

Sa më sipër, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandoi:

1. Të parashikohet shprehimisht KMD, si organ barazie që bashkëpunon me autoritetin kryesor përgjegjës për ofrimin e mbështetjes dhe parandalimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje/lidhur me fushata apo programe të rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut, duke shtuar atë në Kreun VII të projektligjit “Parandalimi”.
2. Të parashikohet shprehimisht në projektligj që organet kombëtare, duke përfshirë organet e barazisë, të publikojnë raporte dhe të adresojnë rekomandime lidhur me çdo çështje që lidhet me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, duke përfshirë dhe grumbulimin e praktikave më të mira ekzistuese si dhe shkëmbimin e informacionit me organet evropiane, siç është Instituti Evropian për Barazi Gjinore.
3. Të parashikohet shprehimisht në projektligj krijimi i një sistemi për mbledhjen, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave mbi dhunën ndaj grave ose dhunën në familje, i cili duhet të përmbajë statistika, të disponueshme në nivel qendror, me të dhëna të disagreguara sipas seksit, grupmoshës (fëmijë/i rritur) të viktimës dhe të autorit të veprës penale dhe, kur është e mundur dhe e përshtatshme, marrëdhënien midis viktimës dhe autorit të veprës penale si dhe llojit të veprës penale, dhe që duhet të përfshijnë si minimum, të dhënat ekzistuese, por pa u kufizuar në: (a) numrin vjetor të veprave penale të raportuara dhe të dënimeve për dhunë ndaj grave ose dhunë në familje, të marra nga burimet administrative kombëtare; (b) numrin e viktimave që janë vrarë për shkak të dhunës ndaj grave ose dhunës në familje; (c) numrin dhe kapacitetin e strehëzave; dhe (d) numrin ethirrijeve në linjat kombëtare të ndihmës

Rekomandime lidhur me Projekt-Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.11.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Në përgjigje të shkresë së Mnishtisë së Drejtësisë nr. 5078/2 Prot, datë 14.10.2025, administruar me tonën me Nr. 1456 Prot, datë 16.10.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar:

Së pari, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstaton se termi “fëmijë të mitur” parashikohet në mënyrë të vazhdueshme në përmbajtje të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.11.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, konkretisht në nenin 1, pika 3, germa “ç”, nenin 5, nenin 7, pika 2, nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 2, nenin 15, nenin 16, pika 2, 3 dhe 4 e të tjerë.⁴⁷

⁴⁷ Pa qenë shteruese dhe referuar projektligjit, të ardhur për mendim dhe të konsultuar në këtë fazë.

Ndërkohë që, Kodi Penal i RSh në fuqi përdor të dy termat, edhe “i mitur” edhe “fëmijë”.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se terminologjia “fëmijë të mitur”, ku përdoren njëkohësisht dy terma që kanë të njëjtin kuptim (“fëmijë” dhe “i mitur”) nuk është e përshtatshme.

Në aspektin e përafrimit me Direktivën 2011/92/BE “Për luftimin e abuzimit seksual dhe shfytëzimit seksual të fëmijëve”, por dhe Kartën Themelore të të Drejtave të Njeriut të BE apo Konventën e Kombeve të Bashkuar për të Drejtat e Fëmijës, që përdorin termin “child ose children” do të përdoret termi “fëmijë”, ndërsa në aspektin e përdorimit dhe unifikimit të legjislacionit penal shqiptar referuar Kodit Penal të RSh në fuqi apo Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, do të përdoret termi “i mitur”.

Duke qenë se qëllimi i projektaktit është përafrimi i legjislacionit shqiptar në fushën penale me *acquis* e BE, pasi rrit sigurinë juridike dhe harmonizon standartet e mbrojtjes së të drejtave themelore me ato të Bashkimit Evropian:

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon zëvendësimin e termit “fëmijë të mitur” në përmbajtje të nenit 1, pika 3, germa “ç”, nenit 5, nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 2, nenit 15 dhe nenit 16, pika 2, 3 dhe 4 të projektvendimit duke përdorur dhe unifikuar atë ose me termin “i mitur” ose “fëmijë”, në të gjithë përmbajtjen e Kodit Penal të RSh, në zbatim të Direktivës 2011/92/BE “Për luftimin e abuzimit seksual dhe shfytëzimit seksual të fëmijëve”, me të cilën do të përafrohet projektakti, dhe legjislacionit penal shqiptar.

Së dyti, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstaton se, në përmbajtje të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.11.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, parashikohet në mënyrë të vazhdueshme, konkretisht në nenin 8, pika 2 (dy herë), nenin 9, pika 3, germa “a”, nenin 10, pika 2, germa “a”, nenin 15, paragrafi 3, germa “a”, nenin 16, pika 4, germa “a”,⁴⁸ rrethana kur, citohet: “vepra penale është kryer kundër një fëmije të mitur në një situatë veçanërisht të cënueshme, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në një gjendje paaftësie fizike ose mendore”.

Në vlerësimin e Komisionerit, ky formulim duket i paqartë dhe konfuz, nga pikëpamja e mënyrës së formulimit.

Referuar dispozitave të projektligjit në të cilat është përdorur kjo rrethanë, konkretisht atyre që lidhen me “Aktet seksuale”, rezulton se Direktiva 2011/92/BE “Për luftimin e abuzimit seksual dhe shfytëzimit seksual të fëmijëve”, përdor terminologjinë e shprehur si: “...particularly vulnerable situation of the child, in particular because of a mental or physical disability or a situation of dependence” (neni 3, pika 5, prg. “ii”) dhe terminologjinë e shprehur si: “the offence èas committed against a child in a particularly vulnerable situation, such as a child èith a mental or physical disability, in a situation of dependence or in a state of physical or mental incapacity” (neni 9). Ndërkohë që, në paragrafin (22) Direktiva jep përkufizimin e asaj se çfarë nënkupton “pamundësia fizike ose mendore”, duke parashikuar shprehimisht se: “Physical or mental incapacity under this

⁴⁸ Pa qenë shteruese dhe referuar projektligjit, të ardhur për mendim dhe të konsultuar në këtë fazë.

Directive should be understood as also including the state of physical or mental incapacity caused by the influence of drugs and alcohol.”. Pra, në kuptim të Direktivës, pamundësia fizike ose mendore nënkupton edhe përfshirjen e gjendjes së pamundësisë fizike ose mendore të shkaktuar si pasojë e ndikimit të drogave dhe alkoolit.

Referuar sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminim vlerëson se, në kuadër të përafrimit të legjislacionit do duhet të integrohet edhe kuptimi që vetë aktet shprehin në përmbajtje të tyre, jo vetëm traspozimi i neneve, pa përfshirë përkufizimin që vetë akti i'u jep. Nëse nga pikëpamja e teknikës legjislative, në përafrimin e Kodit nuk mund të jepet përkufizimi më vehte i një shprehje, atëherë ajo do duhet të inkorporohet në përmbajtje të vetë nenit, në aktin ligjor që e përfaron.

Në kuadër të përafrimit të Direktivës 2011/92/BE “*Për luftimin e abuzimit seksual dhe shfytëzimit seksual të fëmijëve*”,

- KMD rekomandon riformulimin e rrethanës së parashikuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 3, germa “a”, nenin 10, pika 2, germa “a”, nenin 15, paragrafi 3, germa “a”, nenin 16, pika 4, germa “a”, të projektvendimit, në mënyrë të njëjtë apo të ngjashme me shprehjen: “... *situatë veçanërisht vulnerabël e fëmijës, sidomos për shkak aftësisë së kufizuar mendore ose fizike apo një situatë varësie ose në gjendje pamundësie fizike ose mendore të shkaktuar si pasojë e ndikimit të drogave dhe alkoolit*”, apo, sipas rastit, me shprehjen: “...*vepra penale e kryer ndaj një fëmije në një situatë veçanërisht vulnerabël, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në gjendje pamundësie fizike ose mendore të shkaktuar si pasojë e ndikimit të drogave dhe alkoolit*”.

Së treti, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon që, pavarësisht se, termat e përdorur “*aftësi e kufizuar mendore ose fizike*” janë sipas përcaktimeve që parashikohen në Direktivë “*mental or physical disability*”, duke mbajtur në konsideratë Konventën e OKB-së “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”, e cila është ratifikuar nga Shqipëria (ratifikuar gjithashtu edhe nga BE), Konventë kjo e cila përbën standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, e cila ka të parashikuar mosdiskriminimin jo vetëm si një nga parimet themelore, por edhe si një të drejtë të veçantë të parashikuar nga kjo konventë, termi më i përshtatshëm dhe më gjithpërfshirës për llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar do të ishte “*aftësi e kufizuar*” duke eliminuar përdorimin e vetëm dy llojeve, asaj mendore dhe fizike. Duke referuar vetëm dy llojet e aftësisë së kufizuar, mendore dhe fizike, përjashtohen nga mbrojtja e dispozitave të Kodit Penal llojet dhe kategoritë e tjera të aftësisë së kufizuar. Përdorimi i termit “*aftësi e kufizuar*” në vend të “*aftësi e kufizuar mendore dhe fizike*”, nuk e cënon përputhshmërinë me Direktivën, përkundrazi garanton një mbrojtje të plotë dhe pa diskriminim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar që ata kanë.

Konventa e OKB-së “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*” nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalit dhe ambjentit që pengojnë pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, germa “e”). Neni 1 i Konventës sanksionon: “*Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo*

shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.”.

Së fundmi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se përfarimi i këtyre Direktivave, nëpërmjet shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal të R.Sh në fuqi, do të duhet të reflektohet dhe në përmbajtjen e draft Kodit të ri Penal, i cili aktualisht është në fazën e konsultimit publik.⁴⁹ Kjo pasi, miratimi i Kodit të ri Penal do të passillte shfuqizimin e Kodit Penal në fuqi, ndërkohë që përafrimi me standartet që imponojnë Direktivat në fjalë do të vazhdojë të mbetet një domosdoshmëri si në kuadër të procesit të integritimit të vendit ashtu dhe një aspekt i vazhdimësisë së mbajtjes së këtyre standarteve në legjisacionin e brendshëm penal kombëtar.

Sa më sipër, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandoi:

1. Zëvendësimin e termit “fëmijë të mitur” në përmbajtje të nenit 1, pika 3, germa “ç”, nenit 5, nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 2, nenit 15 dhe nenit 16, pika 2, 3 dhe 4 të projektvendimit duke përdorur dhe unifikuar atë ose me termin “i mitur” ose “fëmijë”, në të gjithë përmbajtjen e Kodit Penal të RSh, në zbatim të Direktivës 2011/92/BE “Për luftimin e abuzimit seksual dhe shfytëzimit seksual të fëmijëve”, me të cilën do të përafrohet projektakti, dhe legjisacionit penal shqiptar.
2. Reformulimin e rrethanës së parashikuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 3, germa “a”, nenin 10, pika 2, germa “a”, nenin 15, paragrafi 3, germa “a”, nenin 16, pika 4, germa “a”, të projektvendimit, në mënyrë të njëjtë apo të ngjashme me shprehjen: “... *situatë veçanërisht vulnerabël e fëmijës, sidomos për shkak aftësisë së kufizuar mendore ose fizike apo një situatë varësie ose në gjendje pamundësie fizike ose mendore të shkaktuar si pasojë e ndikimit të drogave dhe alkoolit*”, apo, sipas rastit, me shprehjen: “...*vepra penale e kryer ndaj një fëmije në një situatë veçanërisht vulnerabël, siç është një fëmijë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, në një situatë varësie ose në gjendje pamundësie fizike ose mendore të shkaktuar si pasojë e ndikimit të drogave dhe alkoolit*”.
3. Zëvendësimin e termit “aftësi e kufizuar mendore ose fizike” me termin “aftësi e kufizuar” në përmbajtjen e projektvendimit. Konkretisht, termat e përdorur “*aftësi e kufizuar mendore ose fizike*” janë sipas përcaktimeve që parashikohen në Direktivë “*mental or physical disability*”, duke mbajtur në konsideratë Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, e cila është ratifikuar nga Shqipëria (ratifikuar gjithashtu edhe nga BE), Konventë kjo e cila përbën standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, e cila ka të parashikuar mosdiskriminimin jo vetëm si një nga parimet themelore, por edhe si një të drejtë të veçantë të parashikuar nga kjo konventë, termi më i përshtatshëm dhe më gjithpërfshirës për llojet e ndryshme të aftësisë së kufizuar do të ishte “*aftësi e kufizuar*” duke eliminuar përdorimin e vetëm dy llojeve, asaj mendore dhe fizike. Duke referuar vetëm dy llojet e aftësisë së kufizuar, mendore dhe fizike, përjashtohen nga

⁴⁹ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po harton rekomandime ligjore edhe në kuadër të draft Kodit të ri Penal, të cilat do të përcillen, sipas afateve ligjore.

mbrojtja e dispozitave të Kodit Penal llojet dhe kategoritë e tjera të aftësisë së kufizuar. Përdorimi i termit “aftësi e kufizuar” në vend të “aftësi e kufizuar mendore dhe fizike”, nuk e çënon përputhshmërinë me Direktivën, përkundrazi garanton një mbrojtje të plotë dhe pa diskriminim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar që ata kanë.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalit dhe ambjentit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Neni 1 i Konventës sanksionon: “*Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.*”.

Rekomandime për draftin e Kodit të ri Penal

Në përgjigje të shkresë së Mnistrisë së Drejtësisë nr. . 4364/1 Prot, datë 04.09.2025, administruar me tonën me Nr. 1280 Prot, datë 08.09.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar:

1. Riformulimin e nenit 5 “Parimet e legjislacionit penal” të projektligjit, duke shtuar në mënyrë eksplicite parimin e mosdiskriminimit, me përmbajtje si vijon: “1. Kodi Penal ndërtohet mbi parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, mbi marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. 2. Kodi Penal bazohet në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit të shtetasve përpara ligjit, drejtësinë në përcaktimin e fajësisë, mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve dhe viktimave të veprës penale, humanizmin dhe proporcionalitetin e dënimit penal.”
2. Heqjen e Nenit 302 “Diskriminimi i shtetasve” të projektligjit, duke mos e parashikuar si veprë penale diskriminimin e shtetasve.

Asnjë nga Direktivat e BE-së në fushën e mosdiskriminimit nuk sanksionon detyrimin për të parashikuar ndalimin e diskriminimit në legjislacionin penal.

Këto direktiva janë përafuar në legjislacionin shqiptar, ku garantohet mbrojtje nëpërmjet legjislacionit civil dhe atij administrativ.

Referuar formulimit të dispozitës në draft Kodin Penal, konstatohet se dispozita në fjalë për afron parashikime të Direktivave të BE-së, të cilat tashmë janë përafuar në legjislacionin administrativ dhe atë civil. Këto Direktiva nuk kërkojnë që të përafrohen me ligjin penal.

Përfshirja e një parashikimi kaq të gjerë të diskriminimit në Kodin Penal është problematike për disa arsye. Duke qenë se vepra penale mund të marrë forma dhe nivele të ndryshme ashpërsie apo rrezikshmërie, kriminalizimi i diskriminimit mund të jetë si i pamundur ashtu edhe i pabazuar. Kjo mund të rezultojë në një numër të konsiderueshëm palësh që mund të përballen me ndjekje/kallëzime penale për akte diskriminimi që janë të një niveli të ulët rrezikshmërie. Për shembull, nëse një palë bën një koment diskriminues ndaj një palë tjetër për nivelin e arsimit, ajo mund të përballlet me

një dënim penal, që mund të jetë dënim financiar/gjobë, arrest shtëpie ose burgim. Ky lloj diskriminimi duhet adresojë përgjegjësinë administrative të punëdhënësit për të garantuar një mjedis pa diskriminim për punëmarrësit, nëpërmjet parandalimit apo masave të tjera, në vend që t'i lihet sistemit të drejtësisë penale të imponojë dënime në të gjitha rastet.

Gjithashtu, sipas Direktivave të BE në fushën e diskriminimit, standarti i të provuarit në çështjet e diskriminimit ka një rregullim të posaçëm në legjislacionin civil, sipas të cilit aplikohet *parimi i i zhvendosjes së barrës së provës*. Ky parim/standart nuk aplikohet në procedurat penale.⁵⁰

Në përfundim, rekomandohet që vetëm format e diskriminimit që janë të një niveli të lartë rrezikshmërie apo ashpërsie për persona apo grupe të caktuara personash, të parashikohen si vepra penale në Kodin Penal, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: genocid, sulmet seksuale, të cilat mund të jenë një formë ngacmimi seksual, krimet e urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes, akte të dhunës të cilat cenojnë integritetin fizik ose psikologjik të personave, dhuna ndaj grave, dhuna në familje apo aktet seksuale ndaj të miturve.

Bazuar në parimin kushtetues të shtetit të së drejtës, nuk mund dhe nuk duhet të kriminalizohet çdo formë diskriminimi, referuar kjo formulimit në draft Kodin e ri Penal, të përngjashëm me atë të legjislacionit civil.

3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon heqjen e Nenit 659 “*Diskriminimi i punonjësve*” të projektligjit, duke mos e parashikuar si vepër penale

Referuar legjislacionit dhe standarteve evropiane, diskriminimi në punësim duhet trajtuar kryesisht përmes një sistemi të plotë të të drejtave dhe detyrimeve që përmban ligji i punës. Këto standarte përmbushen tashmë nga legjislacioni ynë kombëtar, sipas këtyre kërkesave, në ligjin 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*” dhe Kodi i Punës. Përsa është argumentuar edhe më sipër lidhur me nenin 302 të projektligjit, KMD gjykon se po ashtu nuk mund të kriminalizohet diskriminimi në punësim sipas parashikimit në nenin 659 “*Diskriminimi i punonjësve*”.

4. Në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me “Racizmin”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon që në Kodi e ri Penal të adresohen standartet e vendosura në Rekomandimin Nr. 7 “*Për Politikën e Përgjithshme “Mbi Legjislacionin Kombëtar për Luftën kundër Racizmit dhe Diskriminimit Racial*”, miratuar më 13 dhjetor 2002 dhe amenduar më 7 dhjetor 2017, të Komisionit Evropian Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)⁵¹, në lidhje me aktet që lidhen specifikisht me diskriminimin racial, të cilat duhet të penalizohen në kuadër të legjislacionit penal.

5. Në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me “Krimet e urrejtjes”

⁵⁰ Council Directive 2000/78/EC of 27 November 2000, Article 10 “Burden of proof“*1. Member States shall take such measures as are necessary, in accordance with their national judicial systems, to ensure that, when persons who consider themselves wronged because the principle of equal treatment has not been applied to them establish, before a court or other competent authority, facts from which it may be presumed that there has been direct or indirect discrimination, it shall be for the respondent to prove that there has been no breach of the principle of equal treatment. 2. Paragraph 1 shall not prevent Member States from introducing rules of evidence which are more favourable to plaintiffs. 3. Paragraph 1 shall not apply to criminal procedures....”*

⁵¹ Shih paragrafin 18 e vijues të Rekomandimit, në link:

<https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-7-revised-on-national-legislatio/16808b5aa8>

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon që në Kodi e ri Penal të adresohen standartet e vendosura në Rekomandimin (2024)⁵² të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare “Për luftimin e Krimeve të Urrejtjes”, (i miratuar nga Komiteti i Ministrave me 7 Maj 2024 në Mbledhjen e 1498-të të Zëvendësministrave), në lidhje me:

- standartet që krimet e urrejtjes të mbulojnë detyrimisht shkaqet e parashikuara shprehimisht në këtë rekomandim, si: racën, ngjyrën, gjuhën, fenë, shtetësinë, origjinën kombëtare ose etnike, moshën, aftësinë e kufizuar, seksin, gjininë, orientimin seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore dhe karakteristikat e seksit.
- Krimet e urrejtjes të parashikohen në mënyrë gjithëpërfshirëse në Kodin e ri Penal, sipas njërës prej modeleve të referuara. KMD mbështet qasjen e adresuar në draft Kodin e ri Penal, ku nuk ka një dispozitë të vetme lidhur me krimin e Urrejtjes por elementi i urrejtjes parashikohet në dispozitë të veçanta si dhe konsideron pozitive parashikimin në një dispozitë më vehte lidhur me “Rrethanat rënduese” (neni 140 i projektligjit).

6. Në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me “Gjuhën e urrejtjes”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon që në Kodi e ri Penal të adresohen standartet e mësipërme, në lidhje me:

- kriminalizimin e të gjitha shprehjeve të *Gjuhës së Urrejtjes*, sipas Rekomandimit CM/Rec (2022)16 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare “*Mbi luftën kundër gjuhës së urrejtjes*”, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 maj 2022 në Sesionin e 132-të të Komitetit të Ministrave;
- parashikimin e shkaqeve, ku hyjnë karakteristikat ose statusi personal, i vërtetë apo i atribuar/përceptuar, të tilla si: raca, ngjyra, gjuha, feja, shtetësia, origjina kombëtare ose etnike, moshë, aftësia e kufizuar, seksi, identiteti gjinor, orientimi seksual, gjinia dhe karakteristikat e seksit.
- shprehjet e *Gjuhës së Urrejtjes* të përfshijnë të gjitha format dhe mjetet e përhapjes së saj, duke parashikuar shprehimisht mjetet digjitale.

7. Rishikimin e shkaqeve të parashikuara në Nenin 140 “Rrethanat rënduese”

Komisioneri rekomandon që të shtohen rrethanat rënduese dhe të riformulohet neni 140, pika 1, germa “k”, me përmbajtjen si vijon: “*kur vepra është kryer për motive që kanë të bëjnë me gjininë, seksin, moshën, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, shtetësinë⁵³, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar apo çdo motiv tjetër”.*

8. Rishikimin e shkaqeve të parashikuara në nenin 17 “Ekstradimi”

Komisioneri rekomandon që të shtohen shkaqet, për të cilat nuk lejohet ekstradimi, duke riformuluar nenin 17, pika 3, germa “c”, me përmbajtje si vijon: “*Ekstradimi nuk lejohet: c) kur ka arsye për të dyshuar që personi i kërkuar për t’u ekstraduar do të persekutohet, kërkohet ose dënohet për arsye të bindjeve politike, bindjeve fetare, përkatësisë kombëtare apo etnike, racës, ngjyrës, gjinisë, seksit, orientimit seksual, identitetit gjinor, karakteristikat e seksit.*”

⁵² Recommendation CM/Rec (2024)4 of the Committee of Ministers to member States “**On combating hate crime**” (Adopted by the Committee of Ministers on 7 May 2024 at the 1498th meeting of the Ministers’ Deputies)

⁵³ KMD rekomandon zëvendësimin e termit “Ksenofobia”, pasi ky term nënkupton paragjykimet, urrejtjen apo frikën nga personat e vendeve apo kulturave të tjera. Ksenofobia nuk përbën shkak në vetvete.

9. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon që vepra penale “*Dhuna në familje*”, të ketë një qasje të qartë gjinore për të njohur plotësisht natyrën gjinore të dhunës në familje, e cila prek kryesisht gratë dhe vajzat.

Komisioneri rekomandon që, në përputhje me standartet europiane dhe ato ndërkombëtare, vepra penale e parashikuar në nenin 732 “*Dhuna në familje*”, të ketë një qasje të qartë gjinore për të njohur plotësisht natyrën gjinore të dhunës në familje, e cila prek kryesisht gratë dhe vajzat ose të jetë e parashikuar në një dispozitë të veçantë, vepra penale “*Dhuna ndaj Grave*”.

10. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon rishikimin e terminologjisë së përdorur në projektligj, me qëllim eliminimin e parashikimeve diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuar, që vjen si rrjedhojë e detyrimeve që burojnë nga Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (KDPAK), e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012.

Nga përmbajtja e projektligjit, rezulton se nuk ka ende një rishikim të neneve të Kodit Penal, të cilat synojnë eliminimin e terminologjisë diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuar.

Vlerësojmë se termat e përcaktuar si: “*i paaftë mendërisht*”, “*paaftësi fizike*”, “*ç’rregullimet apo paaftësinë fizike apo mendore*”, duhen hequr dhe riformuluar në tërësinë e projektligjit në fjalë. Nevoja për rishikim vjen si rrjedhojë e detyrimeve që burojnë nga Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (KDPAK), e ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin nr. 108, datë 15.11.2012.

11. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon zëvendësimin e termit “marrëdhënie homoseksuale” me “marrëdhënie seksuale”.

Homoseksualizmi është dekriminalizuar në vitin 2001, me ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal, sipas Ligjit Nr. 8733, datë 24.01.2001. Termi “marrëdhënie seksuale” përfshin si marrëdhëniet seksuale midis individëve të së njëjtës gjini ashtu edhe atyre të gjinive të ndryshme. Për këtë arsye, marrëdhënia juridike apo vlera shoqërore që kërkohet të mbrohet nga legjislacioni penal nëpërmjet veprave penale, garantohet më së miri pa referuar në përmbajtje të ligjit termin “marrëdhënie homoseksuale”.

Sa më sipër, me qëllim eliminimin e përdorimit të një gjuhe të papërshtatshme, me konotacion negativ dhe paragjykes, rekomandojmë që, në projektligj, termi “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale” të zëvendësohet me “marrëdhënie seksuale”.

Ndihma juridike

Në referim të nenit 6 të Kodit të Procedurave Administrative, që parashikon se: “1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit”, nenit 3 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që parashikon se: “1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. 2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar”, si dhe nenit 32, pika 1, gërma “j”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që parashikon se: “Komisioneri ka kompetencë të informojë për të drejtën e mbrojtjes

nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2025, ka ofruar ndihmën e tij juridike si më poshtë vijon:

- Kthim përgjigje, me e-mail dt. 20.02.2025, kërkesës për informacion të dërguar nga Shoqata "Drejtësi Sociale", me lëndë “Rreth ankimit të Drejtësi Sociale kundër avokatit Spartak Ngjela”.
- **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI** Datë 11.06.2025, administruar email sipas të cilit kërkohet përshtatja e draft-marrëveshjes së bashkëpunimit mes KMD dhe CLR. U përshtat drafti sipas modeleve ekzistuese, pasi nuk kam informacion se çfarë kanë propozuar palët për marrëveshjen. Drafti i përshtatur u përcoll në email në të njëjtën datë.
- Datë 22.01.2025 administruar email i z. P.Saraci, i cili kërkon vijimin e procedurave të ekzekutimit të vendimit të KMD-së. Iu kthye përgjigje, në konsultim me KMD në të njëjtën datë, se nga ana e institucionit do të ndiqen procedurat perkatëse ligjore.

9. Ndërgjegjësimi

Në zbatim të mandatit të përcaktuar nga legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) ka si funksion thelbësor promovimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në shoqëri.

Gjatë vitit 2025, veprimtaria ndërgjegjësuëse është konceptuar jo vetëm si aktivitet informues, por si një instrument parandalues, edukues dhe transformues, me qëllim:

- rritjen e kulturës së barazisë në institucionet publike dhe private;
- fuqizimin e grupeve vulnerabël për të kërkuar mbrojtje;
- parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe praktikave diskriminuese;
- forcimin e standardeve të organeve të barazisë në përputhje me acquis të BE-së.

Ndërhyrjet janë realizuar përmes:

- komunikimit publik dhe mediatic;
- organizimit të aktiviteteve në nivel vendor dhe kombëtar;
- pjesëmarrjes në konferenca rajonale dhe ndërkombëtare;
- trajnimeve për profesionistë dhe studentë;
- nënshkrimit të marrëveshjeve bashkëpunimi;
- angazhimit në projekte ndërkombëtare.

Komunikimi Publik dhe Bashkëpunimi me Median

Gjatë vitit 2025, komunikimi publik ka qenë një komponent i rëndësishëm i strategjisë institucionale.

Daljet në media kanë synuar:

- ndërgjegjësimin mbi të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi;
- sqarimin e kompetencave të institucionit;
- adresimin publik të çështjeve sensitive që lidhen me gjuhën e urrejtjes;
- promovimin e tolerancës dhe diversitetit.

Daljet mediatike sipas muajve**Shkurt** – Tiranadiplomat.al, ATSH**Mars** – RTSH, ATSH, News 24

Fokus: Diskriminimi në diskursin publik, standardet e raportimit mediatik dhe roli i organeve të barazisë.

Maj – Ora News TV

Fokus: Ndikimi i gjuhës së urrejtjes në shoqëri dhe mekanizmat ligjorë të mbrojtjes.

Qershor – Shqiptarja.com, Balkanweb.com, RTSH

Fokus: Mbrojtja e grupeve vulnerabël dhe roli i institucioneve të pavarura.

Tetor – ABC News, Reporter.al, ATSH, Shqiptarja.com, MCN TV

Fokus: Standardet evropiane për organet e barazisë dhe nevoja për përafrim legjislativ.

Nëntor – MCN TV, Shqiptarja.com

Fokus: Përfshirja sociale dhe sfidat e komuniteteve të marginalizuara.

Dhjetor – Ora News TV, MCN TV, Report Tv, Nestnews.al, Shqiptarja.com

Fokus: Bilanci vjetor i veprimtarisë dhe prioritetet për vitin pasardhës.

Në total: **21 dalje dhe raportime mediatike.**

Këto dalje kontribuan në:

- rritjen e njohjes së mandatit të institucionit;
- rritjen e kërkesave për informacion nga qytetarët;
- konsolidimin e rolit të institucionit si autoritet i pavarur.

Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete

Gjatë vitit 2025, Komisioneri dhe Zyra kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si takime, seminare, trajnime, tryeza diskutimi, grupe pune, workshop, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucione shtetërore apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut.

Janar

Muaji janar u karakterizua nga aktivitete të fokusuara në edukimin e të rinjve dhe në forcimin e dialogut me aktorë institucionalë dhe akademikë.

Takimi me të rinjtë pranë Qendrës TISS

Komisioneri zhvilloi një takim me të rinjtë pranë Qendrës së Shërbimeve dhe Trajtimit Psiko-Social (TISS), ku u trajtuan në mënyrë të detajuar:

- format e diskriminimit në mjedisin shkollor dhe social;
- ndikimi psikologjik i përjashtimit dhe stigmatizimit;
- rëndësia e raportimit të rasteve të diskriminimit;
- roli i ligjit dhe i institucionit në garantimin e mbrojtjes.

Gjatë diskutimit u inkurajua dialogu i hapur me të rinjtë, të cilët ndanë përvoja konkrete dhe perceptime mbi diskriminimin në mjedisin e tyre. Aktiviteti synoi jo vetëm informimin, por edhe ndërtimin e besimit të të rinjve ndaj mekanizmave institucionalë.

Vizita studimore e programit “Shteti i së Drejtës”

Në ambientet e institucionit u pritën pjesëmarrësit e Edicionit të Dytë të programit “Shteti i së Drejtës”, të organizuar nga Akademia e Integritit European dhe Negociatave.

Gjatë këtij takimi:

- u prezantua kuadri ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi;
- u shpjegua struktura organizative e institucionit;
- u paraqitën statistika dhe tipologji të rasteve më të shpeshta të trajtuara;
- u diskutuan sfidat në zbatimin praktik të legjislacionit.

Pjesëmarrësit u njohën me procedurën e shqyrtimit të ankesave dhe me rolin e institucionit në raport me pushtetin gjyqësor dhe administratën publike.

Konferenca inauguruese e Forumit Human Rights 30

Komisioneri mori pjesë në konferencën inauguruese të Forumit Human Rights 30, të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Universiteti i Essex-it.

Në këtë forum u diskutua:

- rritja globale e narrativave të urrejtjes;
- sfidat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në kontekst ndërkombëtar;
- roli i institucioneve të pavarura në mbrojtjen e standardeve demokratike.

Ndërhyrja e Komisionerit theksoi rëndësinë e reagimit institucional të koordinuar dhe të bazuar në ligj për të përballuar fenomene të diskriminimit sistemik.

Takimi në Korçë mbi segregimin

Në Korçë u zhvillua një takim me përfaqësues të qeverisë, pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile për të adresuar segregimin e nxënësve romë dhe egjiptianë.

Gjatë takimit:

- u analizuan detyrimet që rrjedhin nga vendimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- u diskutuan masa konkrete administrative dhe arsimore;
- u theksua rëndësia e aksesit të barabartë në arsim.

Ky aktivitet përfaqësoi një hap konkret në drejtim të adresimit të një problematike me ndikim të drejtpërdrejtë në barazinë në arsim.

Shkurt

“JAVA KUNDËR DISKRIMINIMIT 2025”

Muaji shkurt u karakterizua nga organizimi dhe zhvillimi i “Javës Kundër Diskriminimit 2025”, një iniciativë e realizuar në bashkëpunim me projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Fuqizimi i mbrojtjes nga diskriminimi në Shqipëri”, me mbështetjen e programit Instrumenti Horizontal III.

Kjo javë përfaqësoi një ndërhyrje të gjerë territoriale dhe tematike, me aktivitete të zhvilluara në disa bashki të vendit dhe me përfshirjen e institucioneve vendore, organizatave të shoqërisë civile, nxënësve, përfaqësuesve të komuniteteve vulnerabël dhe aktorëve institucionalë.

➤ Kukës

Takim me qytetarë dhe shoqërinë civile

“Java Kundër Diskriminimit” u çel në Kukës, në qendrën “Yes”, ku Komisioneri zhvilloi një takim informues me qytetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të Bashkisë Kukës, Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë dhe institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjatë diskutimit u trajtuan:

- e drejta e mbrojtjes nga diskriminimi;
- mënyrat e paraqitjes së ankesave;
- format më të shpeshta të diskriminimit në nivel lokal;
- rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional për adresimin e rasteve.

Takimi u zhvillua në formë bashkëbisedimi të hapur, duke u dhënë mundësi qytetarëve të paraqesin shqetësime konkrete dhe të kërkojnë sqarime mbi procedurat institucionale.

Takim me të moshuarit

Në kuadër të aktiviteteve në Kukës, Komisioneri zhvilloi një takim me të moshuarit në një qendër pritjeje.

Diskutimi u fokusua në:

- diskriminimin për shkak të moshës;
- aksesin në shërbime sociale dhe shëndetësore;
- rëndësinë e trajtimit me dinjitet dhe barazi.

Ky aktivitet synoi të adresojë një kategori që shpesh mbetet jashtë vëmendjes së debatit publik për diskriminimin.

➤ Durrës

Në Durrës u zhvillua një takim në Qendrën për Zhvillimin Komunitar “Sot për të ardhmen”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bashkisë dhe Zyrës së Këshillit të Evropës.

Tematikat e trajtuara përfshinë:

- të drejtat dhe liritë themelore;
- diskriminimin në aksesin në shërbime;
- rolin e pushtetit vendor në parandalimin e diskriminimit.

Gjatë takimit u theksua rëndësia e koordinimit ndërmjet institucioneve vendore dhe mekanizmave kombëtarë të mbrojtjes nga diskriminimi.

➤ Kavajë

Në Kavajë u organizua një tryezë e rrumbullakët me fokus Ditën e Drejtësisë Sociale dhe “Javën Kundër Diskriminimit”.

Diskutimi trajtoi:

- barazinë sociale;
- sfidat në përfshirjen e grupeve vulnerabël;
- rëndësinë e politikave lokale për garantimin e aksesit të barabartë në shërbime.

Tryeza shërbeu si platformë diskutimi mes institucioneve vendore dhe shoqërisë civile.

➤ Maliq

Në Maliq u zhvillua një takim informues me qytetarë dhe shoqërinë civile, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Bashkisë, përfaqësuesve të Këshillit të Evropës dhe Avokatit të Popullit.

Diskutimi u përqendrua në:

- të drejtat e pakicave;
- diskriminimin në nivel lokal;
- rolin e bashkive në garantimin e barazisë.

Takimi u zhvillua në formë dialogu të hapur, ku u diskutuan problematika konkrete të komunitetit.

➤ Pustec

Në Bashkinë Pustec u zhvillua një takim me fokus Pakicat Kombëtare.

U diskutuan:

- mbrojtja e identitetit kulturor dhe gjuhësor;
- akses i barabartë në arsim dhe shërbime publike;
- roli i institucioneve në garantimin e barazisë faktike.

Ky aktivitet kishte rëndësi të veçantë për shkak të përbërjes etnike të zonës dhe nevojës për ndjeshmëri institucionale.

➤ Gramsh

Në shkollën “Asllan Shahini” në Gramsh u zhvillua një takim me stafin pedagogjik dhe drejtuesit e shkollës.

Temat kryesore:

- të drejtat e nxënësve;
- diskriminimi në mjedisin shkollor;
- parandalimi i bullizmit;
- përgjegjësia e institucioneve arsimore.

Diskutimi synoi forcimin e rolit të shkollës si hapësirë gjithëpërfshirëse dhe e sigurt për çdo nxënës.

➤ Përmet

Në Shkollën e Mesme “Sami Frashëri” në Përmet u zhvillua një bashkëbisedim me nxënës dhe staf pedagogjik mbi:

- të drejtat e të rinjve;
- bullizmin dhe gjuhën e urrejtjes në internet;
- përdorimin e përgjegjshëm të rrjeteve sociale.

Ky aktivitet theksoi rritjen e rasteve të gjuhës së urrejtjes online dhe nevojën për edukim digjital.

➤ Dropull

Në Dropull u zhvillua një takim me fokus Pakicat Kombëtare dhe të drejtat e tyre në nivel lokal.

Diskutimi përfshiu:

- aksesin në shërbime publike;
- ruajtjen e identitetit kulturor;
- rëndësinë e dialogut ndërkulturor.

➤ Sarandë

Në Sarandë u organizua një tryezë diskutimi mbi të drejtat e Pakicave Kombëtare dhe shërbimet sociale për komunitetin.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve publike dhe partnerë ndërkombëtarë.

Diskutimi u përqendrua në:

- përfshirjen sociale;
- politikat lokale për mbështetjen e komuniteteve;
- bashkëpunimin ndërinstitucional.

Në përfundim, “Java Kundër Diskriminimit 2025” përbëri:

- ndërhyrjen më të gjerë territoriale të vitit;

- një platformë dialogu ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve;
- një mekanizëm konkret për promovimin e barazisë në nivel lokal.

Mars

Muaji mars u karakterizua nga aktivitete me fokus në rolin e medias në parandalimin e diskriminimit, në procesin e integritimit evropian dhe në forcimin e bashkëpunimit me institucionet akademike.

Tryeza “Aftësitë mediatike si një mjet për të luftuar gjuhën e urrejtjes”

Komisioneri mori pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë “Aftësitë mediatike si një mjet për të luftuar gjuhën e urrejtjes”, e organizuar nga “Aleanca Pa Urrejtje”, me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Këshillit të Evropës.

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të:

- Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA);
- Këshillit Shqiptar të Medias (KSHM);
- Avokatit të Popullit;
- përfaqësues të medias dhe organizatave të shoqërisë civile.

Diskutimi u fokusua në:

- rritjen e narrativave të urrejtjes në hapësirën publike dhe online;
- përgjegjësinë editoriale të mediave;
- nevojën për integrimin e edukimit mediatik në politikat kundër diskriminimit;
- rolin e organeve të barazisë në monitorimin e diskursit publik.

Komisioneri theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes institucioneve rregullatore, mediave dhe organeve të pavarura për të garantuar një diskurs publik që respekton dinjitetin dhe barazinë.

Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE)

Komisioneri mori pjesë në takimin e radhës të Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, ku u diskutuan:

- Raporti Vjetor për vitin 2024;
- Plani i aktiviteteve për vitin 2025;
- ecuria e procesit të integritimit evropian;
- statusi aktual i negociatave me Bashkimin Evropian.

Në këtë kuadër, Komisioneri raportoi mbi:

- direktivat e Bashkimit Evropian për standardet e organeve të barazisë;
- nevojën për përafrimin e legjislacionit shqiptar;
- rëndësinë e forcimit të pavarësisë dhe kapaciteteve të institucioneve të barazisë.

Diskutimi evidentoi rolin e institucionit në përmbushjen e kriterëve politike të anëtarësimit dhe në garantimin e standardeve të të drejtave të njeriut.

Takimi me Universitetin Epoka dhe Universitetin e Bolonjës

Në kuadër të Programit READ (Ekspertizë Kërkimore nga Diaspora Akademike), u zhvillua një takim me përfaqësues të Universitetit Epoka dhe Universitetit të Bolonjës.

Takimi u përqendrua në:

- forcimin e mbrojtjes ligjore të minoriteteve;
- përmirësimin e kurrikulës së Klinikës Ligjore;
- integrimin e praktikës institucionale në edukimin universitar.

Gjatë diskutimit u theksua rëndësia e:

- bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe akademisë;
- përfshirjes së studentëve në analizën e rasteve konkrete të diskriminimit;
- ndërtimit të kapaciteteve profesionale në fushën e të drejtave të njeriut.

Institucioni shprehu gatishmërinë për të ofruar ekspozim praktik për studentët e drejtësisë, duke kontribuar në formimin e profesionistëve të ardhshëm me ndjeshmëri ndaj çështjeve të barazisë.

Prill

Muaji prill u fokusua në bashkëpunimin me institucionet arsimore, pushtetin vendor dhe organizatat e shoqërisë civile.

Vizita në Gjimnazin “Vasil Kamami”, Elbasan

Komisioneri zhvilloi një vizitë pune në Gjimnazin “Vasil Kamami” në Elbasan, ku u zhvillua një bashkëbisedim me nxënës dhe staf pedagogjik mbi:

- parimin e barazisë;
- diskriminimin në mjedisin shkollor;
- respektimin e të drejtave të njeriut;
- mekanizmat e raportimit të diskriminimit.

Gjatë takimit me drejtuesit e shkollës dhe përfaqësues të Lëvizjes Rinore Egjiptiane dhe Rome, u diskutua:

- rëndësia e përfshirjes së komuniteteve rom dhe egjiptiane;
- nevoja për ndërhyrje të hershme në rastet e bullizmit;
- bashkëpunimi ndërinstitutional për mbështetjen e nxënësve vulnerabël.

Panel diskutimi në Bashkinë Roskovec – “Roma Romale I 2025”

Përfaqësuesja e institucionit mori pjesë në panelin e organizuar nga Bashkia Roskovec në kuadër të festivalit “Roma Romale I 2025”.

Diskutimi trajtoi:

- sfidat sociale dhe ekonomike të komunitetit rom dhe egjiptian;
- aksesin në arsim, punësim dhe shërbime publike;
- rolin e pushtetit vendor në promovimin e përfshirjes.

Ky aktivitet kontribuoi në rritjen e dialogut mes institucioneve dhe komuniteteve.

Takimi me studentët e Universitetit Epoka

Në ambientet e institucionit u zhvillua një takim me studentët e drejtësisë të Universitetit Epoka, në kuadër të projektit READ.

Gjatë takimit:

- u prezantuan raste konkrete të trajtuara nga institucioni;
- u diskutua zbatimi praktik i legjislacionit kundër diskriminimit;
- studentët u njohën me procedurat e shqyrtimit të ankesave.

Takimi kishte karakter formues dhe synoi nxitjen e interesit profesional për fushën e të drejtave të njeriut.

Maj

Muaji maj u karakterizua nga forcimi i bashkëpunimeve institucionale dhe angazhimi në aktivitete me fokus barazinë, përfshirjen dhe mbrojtjen nga diskriminimi në fusha të ndryshme të jetës shoqërore.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Futbollit

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit, me qëllim promovimin e një sporti gjithëpërfshirës dhe pa diskriminim.

Marrëveshja synon:

- parandalimin e gjuhës së urrejtjes në ambientet sportive;
- ndërgjegjësimin e sportistëve dhe tifozëve mbi respektimin e barazisë;
- promovimin e fushatave sensibilizuese në evente sportive;
- bashkëpunimin në trajtimin e rasteve të diskriminimit në sport.

Ky bashkëpunim përfaqëson një hap konkret drejt zgjerimit të ndërhyrjeve të institucionit në fusha me ndikim të gjerë shoqëror.

Konferenca Finale “Së Bashku për Barazi: Diversiteti dhe Gjithëpërfshirja për Komunitetin LGBTIQ+”

Komisioneri mori pjesë në konferencën finale të projektit të organizuar nga Open Mind Spectrum Albania (OMSA).

Diskutimet u përqendruan në:

- fuqizimin institucional për mbrojtjen e komunitetit LGBTIQ+;
- sfidat në aksesin në shërbime publike;
- diskriminimin në tregun e punës;
- nevojën për politika të qëndrueshme për përfshirjen sociale.

Pjesëmarrja e institucionit theksoi angazhimin për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTIQ+ dhe bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile.

Takimi me SCiDEV, AGSH dhe Sindikatën e Gazetarëve

U zhvillua një takim me përfaqësues të sektorit të medias për të diskutuar:

- mbrojtjen e gazetarëve nga diskriminimi;
- kushtet e punës në sektorin e medias;
- nevojën për raportim të përgjegjshëm mbi çështjet e diskriminimit.

Takimi synoi forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucionit dhe organizatave të medias.

Qershor

Muaji qershor u karakterizua nga angazhime ndërkombëtare dhe bashkëpunime me organizata të shoqërisë civile.

Takimi Global mbi Planifikimin Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Njeriut

Komisioneri mori pjesë në takimin global të organizuar nga Universiteti i Liverpulit, ku u diskutua:

- roli i planeve kombëtare të veprimit për të drejtat e njeriut;
- koordinimi ndërinstytucional;
- integrimi i dimensionit të barazisë në politikat kombëtare.

Projekti “Të Rinjtë Romë – Ambasadorë të një Shoqërie pa Korrupsion”

Në takimin e organizuar nga IRCA, u diskutua:

- roli i të rinjve romë në promovimin e integritetit;
- diskriminimi i shumëfishtë;
- rëndësia e edukimit qytetar.

Tryeza e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Komisioneri mori pjesë në tryezën mbi rehabilitimin dhe riintegrimin në sistemin e burgjeve.

U diskutua:

- stigmatizimi i personave që kanë shlyer dënimin;
- roli i institucioneve në riintegrimin social;
- diskriminimi pas vuajtjes së dënimit.

Marrëveshja me Qendrën për të Drejtat në Punë (CLR)

U nënshkrua një marrëveshje për ndërgjegjësimin mbi të drejtat në punë, me fokus:

- diskriminimin në marrëdhëniet e punës;
- barazinë gjinore;
- kushtet e sigurta të punës.

Korrik

Muaji korrik përfshiu aktivitete me fokus median, edukimin dhe shtetin e së drejtës.

Takimi mbi të ardhmen e RTSH-së

Komisioneri mori pjesë në një takim publik konsultues mbi të ardhmen e RTSH-së, ku theksoi:

- rëndësinë e platformave publike gjithëpërfshirëse;
- përfaqësimin e grupeve vulnerabël;
- rolin e medias publike në promovimin e barazisë.

Prezantimi i Udhërrëfyesit për Jurisprudencën Kushtetuese

Pjesëmarrja në këtë aktivitet theksoi:

- rëndësinë e interpretimit kushtetues në mbrojtjen e barazisë;
- lidhjen mes jurisprudencës dhe praktikës administrative.

Takimi me studentët e “Summer University 2025”

Studentët u njohën me:

- mandatin e institucionit;
- procedurat e trajtimit të ankesave;
- sfidat praktike në zbatimin e ligjit.

Gusht

Takimi me Qendrën Europiane për Liri të Shtypit dhe Medias (ECPMF)

U diskutua:

- liria e medias;
- mbrojtja e gazetarëve nga diskriminimi;
- siguria profesionale në mjediset mediatike.

Shtator

Takimi me organizatat e personave me aftësi të kufizuara

Diskutimi u fokusua në:

- shërbimin “peer support”;
- aksesin në shërbime;
- përfshirjen në vendimmarrje.

Konferenca e 9-të Rajonale e Organeve të Barazisë

U diskutua:

- bashkëpunimi ndërmjet organeve të barazisë;
- shkëmbimi i praktikave të mira;
- sfidat rajonale.

Tetor

Trajnimi mbi të Drejtat e Punës (GADC)

U trajtuan:

- kuadri ligjor;
- diskriminimi në punë;
- mekanizmat e raportimit.

Konferenca mbi sektorin e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve

Diskutimi u përqendrua në:

- kushtet e punës;
- rolin e bashkive;
- barazinë në tregun e punës.

Projekti “VIOLET”

U zhvillua takimi i dytë i Komitetit Drejtues të projektit për krijimin e mjediseve të punës të sigurta dhe pa ngacmime seksuale.

Nëntor

Raporti mbi fuqizimin ekonomik të grave

Institucioni mori pjesë në prezantimin dhe diskutimin e raportit, duke theksuar:

- rëndësinë e politikave me qasje gjinore;
- nevojën për monitorim të fondeve publike.

Trajnimi i studentëve të drejtësisë

Studentët u njohën me praktikën institucionale dhe analizuan raste konkrete.

Dhjetor

Konferenca Ndërkombëtare në Prishtinë

Komisioneri mori pjesë në konferencën mbi të ardhmen e të drejtave të njeriut, ku u diskutuan sfidat kombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare.

Konferenca përmbyllëse e vitit 2025

U organizua një konferencë me organizatat e shoqërisë civile për:

- prezantimin e veprimtarisë së vitit 2025;
- diskutimin e prioriteteve për vitin 2026;
- forcimin e bashkëpunimit institucional.

Përfundime dhe objektiva strategjike

Gjatë vitit 2025, në kuadër të mandatit të tij ligjor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar një veprimtari të gjerë ndërgjegjësuese, e cila është konkretizuar në:

- **mbi 50 aktivitete publike dhe institucionale**, përfshirë takime informuese, tryeza diskutimi, trajnime dhe konferenca;
- **aktivitete në më shumë se 10 bashki të vendit**, duke garantuar shtrirje territoriale dhe akses më të gjerë të qytetarëve në informacion;
- **15 dalje dhe raportime mediatike** në media kombëtare audiovizive dhe të shkruara;
- formalizimin e **marrëveshjeve të bashkëpunimit** në fusha me ndikim të drejtpërdrejtë, si sporti dhe marrëdhëniet e punës;
- pjesëmarrje aktive në forume kombëtare dhe rajonale mbi standardet e organeve të barazisë dhe procesin e integritet evropian.

Kjo veprimtari ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi, në forcimin e dialogut me pushtetin vendor dhe shoqërinë civile, si dhe në konsolidimin e rolit të institucionit si mekanizëm i pavarur për garantimin e barazisë.

Në vijim të përvojës së vitit 2025, prioritetet strategjike për vitin 2026 do të fokusohen në:

1. **Zgjerimin e shtrirjes territoriale**, me synim mbulimin e më shumë njësive të qeverisjes vendore dhe zonave me akses të kufizuar në informacion.
2. **Forcimin e ndërhyrjeve parandaluese në hapësirën digjitale**, veçanërisht në adresimin e gjuhës së urrejtjes online.
3. **Zhvillimin e indikatorëve të matshëm të performancës**, për vlerësimin sistematik të ndikimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese.
4. **Thellimin e bashkëpunimit me institucionet arsimore**, me fokus edukimin kundër diskriminimit dhe bullizmit.
5. **Forcimin e bashkëpunimit me pushtetin vendor**, për integrimin e parimit të barazisë në politikat dhe shërbimet lokale.
6. **Vijimin e përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian për organet e barazisë**, në funksion të procesit të integritetit evropian.

Institucioni mbetet i angazhuar për të forcuar më tej dimensionin parandalues të mandatit të tij dhe për të garantuar zbatimin efektiv të legjislacionit kundër diskriminimit, në përputhje me parimet kushtetuese të barazisë dhe dinjitetit njerëzor.

10. Veprimtaria monitoruese e KMD

Raportime të KMD

Gjatë vitit 2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) ka zhvilluar një veprimtari të gjerë në drejtim të raportimeve periodike, dhënies së mendimeve mbi projektakte ligjore e nënligjore, si dhe përfaqësimit institucional në procese kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi dhe garantimin e të drejtave të njeriut.

Veprimtaria është realizuar përmes administrimit të kërkesave zyrtare, analizimit të dokumentacionit, përgatitjes së materialeve përkatëse dhe përcjelljes së tyre brenda afateve të përcaktuara, duke siguruar përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe ndërkombëtare të institucionit.

Kontributi në zbatimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike në fushën e barazisë dhe të drejtave të njeriut

Gjatë vitit 2025, KMD ka kontribuar në monitorimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike kombëtare që prekin drejtpërdrejt fushën e barazisë, përfshirjes dhe të drejtave themelore.

Janë përgatitur dhe përcjellë kontribute në kuadër të:

- Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur;
- Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit;
- Strategjisë Kombëtare për Migracionin;
- Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore;
- Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI;
- Planit Kombëtar për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve;
- Axhendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve;
- Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale;

- Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave.

Kontributet e institucionit kanë synuar të sigurojnë respektimin e parimit të mosdiskriminimit dhe trajtimin e barabartë në zbatimin e këtyre dokumenteve, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Përbushja e detyrimeve të raportimit dhe bashkëpunimi me mekanizma ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut

Gjatë vitit 2025, KMD ka përbushur detyrimet e raportimit dhe bashkëpunimit me mekanizma ndërkombëtarë dhe evropianë në fushën e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit.

Institucioni ka kontribuar në:

- Raportin e Sundimit të Ligjit (Rule of Law Report);
- proceset monitoruese të Këshillit të Evropës, përfshirë ciklin e monitorimit të ECRI;
- shqyrtimin e raporteve periodike pranë Komitetit për të Drejtat e Njeriut (CCPR);
- raporte tematike të Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR);
- raportimet periodike pranë Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), në pjesën që lidhet me mosdiskriminimin dhe barazinë në punë.

Kontributet janë përgatitur në mënyrë të detajuar dhe janë depozituar brenda afateve të përcaktuara, duke garantuar përfaqësim të saktë të situatës në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Mendime dhe komente mbi projektakte me ndikim në të drejtat e njeriut

Në vitin 2025 janë administruar dhe trajtuar një sërë projektaktesh ligjore dhe nënligjore me ndikim në fushën e barazisë dhe të drejtave themelore.

Janë përgatitur mendime dhe komente lidhur me:

- draft-ligje në fushën e barazisë gjinore;
- projektakte në fushën e migracionit dhe antitrafikut;
- dokumente planifikimi me ndikim në grupet në situatë të cenueshme;
- përputhshmërinë e akteve të Bashkimit Evropian në fushën e organeve të barazisë me kuadrin ligjor kombëtar.

Këto ndërhyrje kanë synuar garantimin e integritetit të parimit të mosdiskriminimit në kuadrin normativ dhe forcimin e mbrojtjes juridike të individëve.

Pjesëmarrja në struktura koordinuese ndërinstytucionale në fushën e të drejtave të njeriut

KMD ka vijuar përfaqësimin në grupet ndërinstytucionale të punës që trajtojnë çështje të lidhura me:

- të drejtat themelore dhe funksionimin institucional;
- forcimin e mekanizmave të mbrojtjes nga diskriminimi;
- harmonizimin e kuadrit ligjor me standardet evropiane në fushën e barazisë.

Në këtë kuadër janë përgatitur materiale informuese, përditësime periodike dhe kontribute teknike që lidhen me përbushjen e detyrimeve të shtetit shqiptar në fushën e të drejtave të njeriut.

Dimensionin evropian i mandatit – Anëtarësia në rrjete të organeve të barazisë

Si anëtar i EQUINET – Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë, KMD ka qenë pjesë aktive e shkëmbimit të praktikave dhe ekspertizës në nivel evropian.

Gjatë vitit 2025 janë ndjekur mbledhje të përgjithshme, aktivitete tematike dhe procese të mbledhjes së informacionit mbi standardet e organeve të barazisë dhe çështje të mosdiskriminimit. Ky angazhim ka forcuar dimensionin ndërkombëtar të mandatit të institucionit dhe ka kontribuar në përmirësimin e praktikave institucionale.

Bashkëpunimi institucional dhe komunikimi publik

Gjatë vitit 2025 është realizuar bashkëpunim i vazhdueshëm me institucione qendrore, institucione të pavarura, organizata ndërkombëtare dhe media, përmes:

- shkëmbimit të informacionit në kuadër të raporteve tematike;
- kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave zyrtare;
- ofrimit të të dhënave dhe analizave për çështje me interes publik në fushën e mosdiskriminimit.

Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe përforcimi institucional

Gjatë vitit janë ndjekur procese ndërinstitucionale, trajnime dhe aktivitete profesionale me fokus në legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e analizës ligjore. Investimi në ngritjen e kapaciteteve ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së raportimeve, analizave dhe përfaqësimit institucional në forume kombëtare dhe ndërkombëtare.

11. Programi i transparencës

Në përputhje me programin e transparencës, KMD ka vendosur në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit

www.kmd.al, vendimet për diskriminim dhe mosdiskriminim, nga ankesat individuale dhe nga hetimet kryesisht.

Në dispozicion të publikut në faqen zyrtare janë të gjitha rekomandimet e KMD-së dhe vendimet e Gjykatave.

KMD publikon në faqen zyrtare kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të KMD-së dhe Zyrave Rajonale, orarin zyrtar.
- Funkcionin dhe kompetencat e KMD
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë ankesë për diskriminim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e ankesave.

- Kuadrin ligjor, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore.
- Raportet e KMD
- Aktivitetet ndërgjegjësuere dhe informuese të organizuara nga Zyra e KMD-së,
- Takimet e Komisionerit
- Marrëveshjet e bashkëpunimit
- Strukturën organizative të KMD-së;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, orarin e punës, emrin dhe kontaktete koordinatorit për të drejtën e informimit; regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të programit të transparences.

V. ZYRAT RAJONALE

1. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD. Ky objektivi është një nga prioritetet kryesore të ZR Korçë. Gjatë vitit 2025 kjo zyrë ka qenë organizatore e zhvillimit të ditëve të hapura me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe kategorive të ndryshme shoqërore si dhe promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim.

Janar

- Takim me kryetarin e Bashkisë Maliq. U diskutua mbi veprimtarinë e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bashkëpunimin ndërinstytucional për trajtimin e rasteve të diskriminimit në marrjen e shërbimeve, si dhe organizimin e një aktiviteti në kuadër të 15-vjetorit të miratimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Takim me nxënësit e gjimnazit “Faik Konica”. Në takim pjesëmarrësit u njohën me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, llojet e diskriminimit dhe rolin e institucionit në trajtimin e rasteve.

Shkurt

- Organizim aktiviteti ndërgjegjësuere dhe informues me nxënësit e gjimnazit “Ymer Dishnica”, në kuadër të 15-vjetorit të miratimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD). Nxënësit u njohën me LMD, rolin e institucionit të KMD, rastet e trajtuara, procedurën e paraqitjes së ankesave dhe llojet e diskriminimit, si dhe u zhvilluan diskutime mbi praninë e këtij fenomeni në shoqëri.
- Organizim i një dite të hapur me banorët e Bashkisë Maliq.
- Në kuadër të 15-vjetorit të miratimit të LMD, institucioni i KMD organizoi aktivitet me përfaqësues të Bashkive Maliq dhe Pustec, përfaqësues të OJF-ve dhe institucioneve të pavarura që ofrojnë shërbime në komunitet, përfshirë Avokatin e Popullit dhe Ndihmën Juridike Falas.

Mars

- Organizim i një dite të hapur me nxënësit e gjimnazit “Themistokli Gërmenji”, në bashkëpunim me specialisten e Barazisë Gjinore pranë Drejtorisë së Kujdesit Social, Bashkia Korçë. Nxënësit u njohën me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, llojet e diskriminimit, rastet e trajtuara, si dhe procedurat që duhen ndjekur në rastet e diskriminimit.
- Takim me banorët e Gurit të Kuq dhe Kabash, Bashkia Pogradec, ku u diskutuan problematikat që lidhen me kushtet e banimit dhe situatën ekonomiko-sociale.
- Takim me përfaqësues të një organizate jofitimprurëse R/E në Pogradec, ku u diskutua situata e banorëve që jetojnë në zonat e Kabashit dhe Gurit të Kuq.

Prill

- Organizim aktiviteti ndërgjegjësues dhe informues me nxënësit e shkollës së mesme “Raqi Qirinxhi”. Nxënësit u njohën me veprimtarinë e institucionit të KMD, kuadrin ligjor kundër diskriminimit, rëndësinë e diversitetit dhe barazisë, si dhe u zhvilluan aktivitete interaktive për rritjen e ndërgjegjësimit.
- Organizim aktiviteti ndërgjegjësues dhe informues me një grup grash në Bashkitë Maliq dhe Korçë, në bashkëpunim me Shërbimin e Ndihmës Juridike Falas dhe Fondacionin “Misioni Emanuel”. Të pranishmet u njohën me rolin e institucioneve dhe shërbimet që ato ofrojnë.
- Takim me përfaqësues të OSCE/ODIHR. Gjatë takimit u diskutua ecuria e fushatës zgjedhore dhe roli i institucionit të KMD në monitorimin e saj.
- Pritje e një grupi nxënësish të shkollave 9-vjeçare të Bashkisë Korçë. Nxënësit u njohën me rolin e zyrës, mbështetjen që ofron në rastet e diskriminimit, procedurën e paraqitjes së ankesave dhe materialet informuese të përshtatura për fëmijë.

Maj

- Takim me përfaqësues të OSCE. U diskutua fushata zgjedhore, përfshirja e minoriteteve në procesin zgjedhor, si dhe monitorimi dhe raportimi i shkeljeve të mundshme.

Qershor

- Organizim i një aktiviteti ndërgjegjësues dhe informues me specialistët e Shërbimit Social, Bashkia Ersekë. Pjesëmarrësit u njohën me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, institucionin e KMD dhe rastet e trajtuara pranë tij.

Korrik

- Takim me përfaqësuesin e pakicës minoritare egjiptiane pranë Zyrës së Pakicave Kombëtare. Gjatë takimit u diskutuan problematika dhe çështje të ndryshme lidhur me diskriminimin në zbatimin e politikave për këtë kategori, si dhe bashkëpunimi i dy institucioneve në mbrojtje të pakicës egjiptiane. Ky aktivitet u realizua me pjesëmarrjen e prefektit të Qarkut Korçë, nën/kryetares së Bashkisë Korçë, përfaqësuesve të pakicës egjiptiane dhe përfaqësueses së Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit në Korçë .
- Organizim i një tryeze të rumbullakët me përfaqësues të pakicës egjiptiane, organizata jofitimprurëse që mbrojnë të drejtat e kësaj pakice dhe mediatorë të komunitetit. Diskutimet u fokusuan në çështjet dhe problematikat që has pakica egjiptiane në Bashkinë Korçë.

Gusht

- Në bashkëpunim me Fondacionin Dorcas, në Bashkinë Maliq u organizua një takim informues me grupet vulnerabël. Pjesëmarrësit u njohën me punën e Institucionit të KMD dhe me VKM 666, e cila lidhet me përfitimin e bursave për fëmijët e këtyre grupeve, si dhe procedurat dhe vendet ku mund të aplikojnë. Ky aktivitet u realizua në kuadër të programit “Fuqizimi Social i Grupeve Vulnerabël në Korçë, komponenti Familje të Lulëzuara”, të zbatuar nga Fondacioni Dorcas.

Shtator

- Takim me një grup studentësh të universitetit zvicerian, të cilët u njohën me punën e Institucionit të KMD dhe rastet e shqyrtuara prej tij. Gjatë diskutimeve, studentët dhe pedagogët vlerësuan rolin e institucionit në zgjidhjen, adresimin dhe ndërmjetësimin e rasteve të paraqitura nga qytetarët dhe OJF-të.
- Takim me drejtuesin e shkollës “Naim Frashëri”, mediatorin kulturor dhe grup prindërisht. Diskutimet u fokusuan mbi situatën aktuale të shkollës në kuadër të zbatimit të planit për desegregim, sfidat që po hasen dhe informacion lidhur me përgatitjen e dokumentacionit për bursat.

Tetor

- Organizim i një dite të hapur me personat me vështiresi në shikim. Ky aktivitet u organizua në ambientet e Prefekturës së Qarkut Korçë, në bashkëpunim me specialisten e Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit.

Nëntor

- Takim me drejtoreshën e shkollës “Naim Frashëri”. Gjatë takimit u diskutuan problematikat lidhur me përfitimin e bursave, përfshirë mungesën e dokumentacionit të nevojshëm, situatat e fëmijëve që jetojnë me gjyshërit, vërtetimet e pamundura për punë, gjëndja aktuale nga certifikata familjare, si dhe sfidat që krijohen për fëmijët me status ekonomik të ulët.

Dhjetor

- Në kuadër të “16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave”, ZR Korçë, në bashkëpunim me specialisten e barazisë gjinore dhe dhunës pranë Drejtorisë së Kujdesit Social, Policinë dhe Zyrën e Ndihmës Ligjore Falas, organizoi aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese me nxënës, studentë dhe punonjës. Aktivitetet u zhvilluan në gjimnaze, Universitetin “F. S. Noli” dhe fasoneri, ku pjesëmarrësit u njohën me punën e institucioneve, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) dhe mbështetjen që ky ligj ofron për personat që përballen me shkelje të të drejtave ose diskriminim.
- Takim me përfaqësuesit e Qendrës “Streha”, ku diskutimi u fokusua mbi problematikat dhe diskriminimin që hasin grupet vulnerabël në marrjen e shërbimeve, përfshirë komunitetin LGBTQ+.

Pjesëmarrje në aktivitete institucionale

Janar

- Pjesëmarrje në trajnimin për forcimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të institucioneve lokale mbi parandalimin e abuzimit të burimeve shtetërore për përfitim elektoral, organizuar nga KRIK Albania.
- Pjesëmarrje në tryezën e dialogut social të organizuar nga Bashkia Korçë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve dhe OJF-ve. Tema ishte mbështetja e moshës së tretë në marrjen e shërbimeve të ndryshme.
- Pjesëmarrje në tryezën e diskutimit mbi ndjekjen e zbatimit të vendimit “X dhe të Tjerë kundër Shqipërisë”.

Shkurt

- Pjesëmarrje në takimin me temë “Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit”, organizuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (DHKN) dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF).
- Pjesëmarrje në tryezën e Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN), organizuar nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) pranë Bashkisë Korçë.
- Pjesëmarrje në takimin ndërinstitucional të organizuar nga Ndhma Juridike Falas, me pjesëmarrjen e Zv. Ministrit të Drejtësisë. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të Javës Ndërgjegjëse të Publikut për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, 15–22 shkurt 2025.

Mars

- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar pranë shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qerjazi”, Korçë. Nxënësit u njohën me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), llojet e tij dhe mënyrat për të reduktuar diskriminimin dhe bullizmin në shoqëri.

Prill

- Pjesëmarrje në fushatën ndërgjegjëse me rastin e 2 prillit 2025, Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Të rinjtë për një shoqëri gjithëpërfshirëse”, i mundësuar nga Programi “Askush të mos mbetet pas” (Leave No One Behind), i zbatuar nga UNDP me agjencitë e OKB-së dhe mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Bashkia me rastin e 8 prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri”. Fëmijët u njohën me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), ndërsa gjatë diskutimeve u theksua rëndësia e diversitetit kulturor dhe barazisë, duke sjellë shembuj konkretë.
- Pjesëmarrje në takimin për hartimin e Planit Vendor të Veprimt për Barazi Gjinore 2025–2030, organizuar nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me UN Women, si pjesë e grupit të punës.

Maj

- Pjesëmarrje në takimin ndërsektorial “Partneritet për Evropën: Roli i Shoqërisë Civile, Institucioneve Akademike dhe Aktorëve Kyç në Procesin e Integritit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Vendit”, i zhvilluar në Universitetin “Fan S. Noli”.

- Pjesëmarrje në aktivitetin “Fuqizimi i Sektorit Kreativ përmes Qasjes në Mekanizmat e Financimit”, organizuar nga Zyra e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS).

Qershor

- Pjesëmarrje në aktivitetin përmbyllës me temë “Të rinjtë për një shoqëri gjithëpërfshirëse”, të zbatuar në Korçë nga shoqëria “Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Kontaktet e Kufizuara” (MEDPAK), në partneritet me Bashkinë e Korçës dhe Universitetin “Fan S. Noli”, me mbështetjen e Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.
- Pjesëmarrje në takimin me kryetarin e Bashkisë, ku pjesëmarrës ishin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe inspektorët e hetimit. Në takim u diskutua problematika lidhur me bursat.
- Pjesëmarrje në panairin “Trashëgimia kulturore e pakicave etnike dhe linguistike në Qarkun e Korçës”, organizuar nga Universiteti “Fan S. Noli”.
- Pjesëmarrje në aktivitetin “Massive Outdoor Event”, organizuar nga Fondacioni “Misioni Emanuel”.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Korçë me rastin e 24 qershorit, Ditës së Egjiptjanëve të Ballkanit.
- Pjesëmarrje në takimin me përfaqësues të pakicave minoritare, të organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me KMD. Qëllimi i takimit ishte mbledhja e të dhënave dhe diskutimi mbi problematikat që hasën pakicat minoritare gjatë procesit të censusit, të cilat do të përfshihen në raportin përkatës.
- Pjesëmarrje në ëorkshop-in e organizuar në kuadër të nismës së Dorcas Albania mbi vullnetarizmin, ku temë kryesore ishte ngritja e një platforme për vullnetarizëm aktiv.

Gusht

- Pjesëmarrje në konsultimin publik me grupet e interesit, grupet formale dhe informale të të rinjve dhe mbrojtës të barazisë gjinore, organizuar nga Bashkia Korçë, si pjesë e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor për Barazi Gjinore (PVBGJ).

Shtator

- Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar nga qendrat ditore për fëmijë në Maliq. Pjesëmarrësit u njohën me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD), funksionin e Institucionit të KMD, informacion mbi bursat shkollore dhe VKM 666, përfituesit dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e tyre.
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët me temë “Sfidat kryesore të punësimit të të rinjve nga grupet në nevojë në nivel lokal”, organizuar nga Fondacioni “Misioni Emanuel” në kuadër të projektit YEPP II – Youth Employment Enabling Prospects.
- Pjesëmarrje në tryezën e diskutimit mbi të Drejtat e Personave të Moshuar në Shqipëri: Aksesi në Shërbime dhe Ndikimi i Digitalizimit, organizuar nga OSCE.
- Pjesëmarrje në inaugurimin e Qendrës së Shërbimit Mbështetës për Fëmijët dhe Familjen pranë Bashkisë Korçë.

Tetor

- Pjesëmarrje në tryezën e diskutimit mbi të Drejtat e Personave të Moshuar në Shqipëri: Aksesi në Shërbime dhe Ndikimi i Digitalizimit, organizuar nga OSCE.
- Pjesëmarrje në eventin “Së bashku shkruajmë një histori pa moshë”, organizuar nga Fondacioni Dorcas Albania në kuadër të 1 Tetorit-Ditës Ndërkombëtare të Moshës së Tretë.
- Pjesëmarrje në ceremoninë e inaugurimit të Qendrës Multifunkionale në Pogradec, mbështetur nga Bashkia Pogradec, në partneritet me ASDO-Albania Sustainable Development Organization, me mbështetjen e Bashkimit Evropian përmes programit EU4SocialCare të zbatuar nga UNICEF dhe Eorl Vision Albania, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Pjesëmarrje në aktivitetin sensibilizues “Tetori Rozë në Devoll-Bashkë për jetën”, organizuar nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, ku morën pjesë gra, përfaqësuese të institucioneve dhe nxënëse të shkollës “Fuat Babani”, me mesazhe për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm të kancerit të gjirit.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Shoqata e të Verbërve Korçë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë.
- Pjesëmarrje në aktivitetin sensibilizues mbi parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, organizuar nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Maliq.
- Pjesëmarrje në aktivitetin sensibilizues “Çdo ditë vlen për jetën tënde”, organizuar nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Korçë, në kuadër të fushatës Tetori Rozë. Pjesëmarrje në forumin rajonal “Integriteti Mjedisor në Përdorimin e Tokës”, ku u diskutuan gjetjet e projektit “Monitorimi për Qëndrueshmëri”, i zbatuar nga All Green Centre.
- Pjesëmarrje në tryezën e Grupit Teknik Ndërsektorial dhe në tryezën e Grupit Multifunksional pranë Bashkisë Korçë, me referime nga specialistja e dhunës dhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF).

Nëntor

- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: “20 Nëntori-Dita Botërore e të Drejtave të Fëmijëve”, organizuar nga Bashkia Korçë.
- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: “Konkursi për Nisma Vullnetarizmi-Volunt Eja Korçë”, organizuar nga DORCAS Albania.
- Pjesëmarrje në tryezën e Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN), organizuar nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), Bashkia Korçë, me referim rastesh.
- Pjesëmarrje në hapjen zyrtare të fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, organizuar nga Bashkia Korçë.
- Pjesëmarrje në aktivitetin “Jo Martesa të hershme”, organizuar nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me UNFPA.

Dhjetor

- Pjesëmarrje në tryezën e GTN (Grupi Teknik Ndërsektorial), organizuar nga specialistja e Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), me referim rastesh.

- Pjesëmarrje në trajnimin “Forcimi i Kapaciteteve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), për Menaxhimin, Referimin dhe Koordinimin e Rasteve të DHBGJ”, organizuar nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me organizatën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”.
- Pjesëmarrje në aktivitetin “Me profesion dhe zemër për njerëzit me aftësi ndryshe”, organizuar nga Shkolla Profesionale Teknike në bashkëpunim me Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Këshilli i Qarkut në kuadër të 16 dhjetorit, Ditës së Shpalljes së Korçës si Krahinë Autonome.
- Pjesëmarrje në aktivitetin përmbyllës të projektit “Perspektiva që mundësojnë punësimin e të rinjve”, organizuar nga Fondacioni “Misioni Emanuel”, Korçë.
- Pjesëmarrje në ankandin e produkteve artizanale të prodhuara nga mosha e tretë, i zhvilluar nga Qarku Korçë dhe Fondacioni “Misioni Emanuel”.

Pasqyrim në Media

- Gjatë kësaj periudhe, specialistja e ZR Korçë ka pasur 4 dalje mediatike në televizionin lokal dhe është ftuar gjithashtu në emisionin special të Radio “Emanuel”.

Informacion mbi detyrat e përmbushura gjatë periudhës janar-dhjetor 2025

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, specialisti i ZR të KMD Korçë ka përmbushur këto detyra:

- Pritje dhe asistim të qytetarëve çdo ditë, përfshirë dhënien e informacionit, plotësimin e formularëve të ankesave, orientim mbi dokumentacionin e nevojshëm, interpretim të vendimeve të KMD-së dhe ndihmë në hartimin e shkresave drejtuar institucioneve përkatëse.
- Mbajtje kontakti të vazhdueshëm me ankuesit gjatë gjithë fazës së hetimit administrativ.
- Komunikim dhe shkëmbim informacioni me drejtoreshën e DPA, inspektorët e Drejtorisë së Hetimit Administrativ dhe specialistët e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave, për rastet e regjistruara dhe procesin e hetimit.
- Këmbim e-mailesh dhe telefonatash me institucionet përgjegjëse për rastet e paraqitura nga qytetarë të ndryshëm.
- Dhënia e sqarimeve dhe asistencës për qytetarët mbi mënyrën e plotësimit të formularëve dhe bashkëlidhjen e aktet provuese, përfshirë ndihmë në portalin e-Albania, dokumentacion për aplikim pranë zyrës së strehimit, restaurim banese dhe ndihmë ekonomike.
- Referim rastesh pranë institucioneve përkatëse dhe takime me përfaqësues të pushtetit vendor për ndërmjetësim dhe zgjidhje të rasteve.
- Komunikim i vazhdueshëm me përfaqësues të Bashkisë dhe Drejtorisë Mbështetëse për çështjet e mosdhënies së bursave në zbatim të VKM 666.
- Referim rastesh pranë Avokatit të Popullit dhe Shërbimit Ligjor Falas.
- Përgatitje dhe dorëzim raportimesh në kuadër të raportit vjetor, raportit 6-mujor dhe raporteve të tjera për detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Organizim dhe mbikëqyrje e aktiviteteve të zhvilluara në Korçë, Pogradec, Devoll, Pustec, Maliq dhe Kolonjë.

2. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD. Ky objektivi është një nga prioritetet kryesore të ZR Fier. Gjatë vitit 2025 kjo zyrë ka qenë organizatore e zhvillimit të ditëve të hapura me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe kategorive të ndryshme shoqërore si dhe promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim.

Janar

- Takim pune dhe pritje qytetarësh me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Vlorë. Gjatë këtij takimi u trajtuan çështje konkrete të paraqitura nga qytetarët, duke ofruar asistencë dhe informim mbi të drejtat e tyre.
- Takim individual me një qytetar në Vlorë, në mungesë të mundësisë për të marrë asistencë pranë Zyrës Rajonale Fier, qytetarit iu shpjegua në detaje kuadri ligjor i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), kompetencat përkatëse si dhe afatet kohore. Gjithashtu, u dha një përshkrim i qartë i ecurisë së hetimit administrativ deri në marrjen e vendimit përfundimtar.
- Takim pune me Ndhmën Juridike Falas Fier lidhur me organizimin e aktiviteteve në kuadër të javës ndërgjegjësuere për viktimat e krimit, me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe ndërgjegjësimin publik.
- Takim me Ndhmën Ligjore Falas dhe përfaqësuesen e një projekti bashkëpunues me fokus identifikimin dhe planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të një bashkëpunimi të zgjeruar, me qëllim përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe shërbimeve ligjore për qytetarët.

Shkurt

- Në kuadër të 15 vjetorit të miratimit të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi realizoi një aktivitet në shkollën e mesme “Sami Frashëri” në Përmet, me temë: “Të drejtat e të rinjve dhe beteja kundër bullizmit dhe gjuhës së urrejtjes në internet”, me pjesmarrje të stafit mësimor, drejtues, prindër dhe nxënës. Ky takim u zhvillua me mbështetjen e projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshilli i Evropës.
- Në vijim të Javës kundër Diskriminimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi aktivitetin me temë: “Pakicat Kombëtare në Shqipëri”, në Bashkinë Dropull. Aktiviteti synoi të nxiste dialogun dhe ndërgjegjësimin mbi të drejtat e pakicave kombëtare dhe nevojën për mbrojtjen efektive të tyre nga çdo formë diskriminimi. Ky aktivitet u mbështet nga projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me Qendrën “AJMMI”, organizoi në Sarandë një tryezë diskutimi me aktorë lokalë të këtij rajoni në kuadër të 15-vjetorit të miratimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këtë tryezë u diskutuan raste dhe problematika të cilat preknin komunitetin Rom, duke u ndalur në aspekte që lidhen me çështjet e strehimit, trajtimi social etj.

Mars

- Specialistja e Zyrës Rajonale, në bashkëpunim me Ndhmën Juridike Parësore Fier, zhvilloi një aktivitet informues me një grup nxënësish në ambientet e Qendrës “Epoka e Re”. Aktiviteti kishte për qëllim informimin e të rinjve mbi Ligjin Kundër Diskriminimit dhe shërbimet që ofron Qendra

e Ndhmës Juridike Falas. Gjithashtu, u synua ndërgjegjësimi i nxënësve për të drejtat e tyre dhe promovimi i një mjedisi gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë.

Prill

- **Pritje në zyrë e përfaqësueses së Avokatit të Popullit në Berat**, takim pune në kuadër të forcimit të bashkëpunimit, si dhe pritje e qytetarëve për trajtimin e ankesave dhe shqetësimeve të tyre.
- **Takim pune me Ndhmën Juridike Falas**, për realizimin e disa aktiviteteve të përbashkëta në disa njësi administrative të Qarkut Fier, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre ligjore.
- **Takim pune me Drejtoreshën e Shtëpisë së të Moshuarve Fier**, në lidhje me trajtimin e rastit të një të moshuari për çështjen e përfitimit të pensionit të pleqërisë, si dhe ndjekjen institucionale të procedurave për zgjidhjen e tij.
- Specialistja e Zyrës Rajonale Fier, në bashkëpunim me Ndhmën Ligjore Falas, organizoi një ditë të hapur në njësinë administrative Frakull e Madhe, Qarku Fier, me qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit mbi diskriminimin, rëndësinë e barazisë sociale dhe informimin mbi mekanizmat për raportimin e rasteve të diskriminimit.
- Specialistja e Zyrës Rajonale Fier, në bashkëpunim me Ndhmën Ligjore Falas, organizoi një ditë të hapur në njësinë administrative Mbrostar, Qarku Fier, me të njëjtin fokus: ndërgjegjësimin e komunitetit mbi diskriminimin, rëndësinë e barazisë sociale dhe mënyrat për të raportuar raste të diskriminimit.
- Në kuadër të **Ditës Botërore të Autizmit**, specialistja e Zyrës Rajonale Fier, në bashkëpunim me Ndhmën Ligjore Falas, organizoi një aktivitet ndërgjegjëses në **Qendrën Komunitare PAK**, Roskovec. Aktiviteti synonte promovimin e barazisë dhe përfshirjes së personave me autizëm, si dhe theksoi rëndësinë e mbrojtjes nga diskriminimi dhe respektimit të të drejtave të tyre. Aktiviteti përfshiu bashkëpunim me institucione vendore, shpërndarje të materialeve informuese dhe nxitje të dialogut mbi sfidat dhe mundësitë për këtë komunitet.

Maj

- **Specialistja e Zyrës Rajonale** zhvilloi një takim me gratë punonjëse të kompanisë fasoneri **IN-TEX** në Fier, me fokus informimin e tyre mbi të drejtat ligjore në vendin e punës dhe kompetencat e **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)**. Gjatë takimit u theksua rëndësia e raportimit të çdo forme diskriminimi dhe u sqaruan rrugët institucionale për adresimin e shqetësimeve të tyre. U bë e ditur se KMD ka të drejtë të marrë ankesa individuale apo kolektive, të zhvillojë hetime, të japë rekomandime dhe të kërkojë zbatimin e ligjit nga punëdhënësit.
- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, specialistja e Zyrës Rajonale organizoi një aktivitet “Street Laë”, me fokus edukimin juridik mbi të drejtat dhe detyrimet brenda familjes. Pjesëmarrësit u informuan mbi mbrojtjen ligjore ndaj dhunës në familje, barazinë gjinore dhe mënyrat për të pasur akses në ndihmë juridike.
- **Specialistja e Zyrës Rajonale** lehtësoi përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Vlorë, në procesin e **monitorimit të qendrave të votimit në Bashkinë Fier**, me fokus vlerësimin e përshtatshmërisë së infrastrukturës për **personat me aftësi të kufizuara (PAK)**.

- **Specialistja e Zyrës Rajonale**, në bashkëpunim me **Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier**, zhvilloi një takim pune me **psikologen pranë Qendrës Shëndetësore nr. 1 në Fier**. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit për identifikimin dhe referimin e rasteve për ndihmë juridike falas, si dhe për krijimin e një qasjeje më të integruar, ku kujdesi psikologjik dhe ndihma ligjore e plotësojnë njëra-tjetrën për individët që kanë nevojë për mbështetje.

Qershor

- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve Viktima të Agresionit, specialistja e Zyrës Rajonale në bashkëpunim me Qendrën e Ndhmës Juridike Parësore Fier organizoi një takim ndërinstucional në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë Fier, me qëllim ndërgjegjësimin dhe forcimin e mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë dhune, abuzimi apo agresioni.
- Realizuar takim me Qendrën e Ndhmës Juridike Falas në Fier në kuadër të planifikimit të disa aktiviteteve në bashkëpunim.
- Specialistja e Zyrës Rajonale, në bashkëpunim me **Ndhmën Ligjore Falas**, organizoi një aktivitet informues me kursantët e **Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik në Fier**. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimin mbi të drejtat e individit, mbrojtjen nga diskriminimi dhe aksesin në ndihmë ligjore falas. Pjesëmarrësit u njohën me mënyrat e adresimit të rasteve të diskriminimit dhe shërbimet ligjore pa pagesë.
- Specialistja e Zyrës Rajonale zhvilloi një takim me përfaqësuesen e **Këshillit të Evropës** dhe organizatës **“Voice of Roma in Albania”**, në kuadër të hartimit të një raporti të veçantë nga Avokati i Popullit mbi të drejtat e pakicave kombëtare. Takimi kishte në fokus shqyrtimin e problematikave që përjeton komuniteti rom në nivel lokal, si: vështirësitë në arsim, punësim, strehim dhe akses në shërbime publike. U theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstucional dhe e forcimit të rolit të organizatave komunitare në mbrojtje të të drejtave të pakicave.
- Takim pune online me Drejtoreshën e Pritjes së Ankesave dhe Zyrat Rajonale me qëllim koordinimin e detyrave të përcaktuara si dhe problematikave të hasura. U theksua rëndësia e komunikimit të vazhdueshëm dhe raportimit të rregullt mbi ecurinë e punës.

Korrik

- Në kuadër të zbatimit të politikave sociale dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstucional, Zyra Rajonale organizoi një aktivitet informues në Njësinë Administrative Portëz dhe Bashkinë Patos mbi zbatimin e VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022, që përcaktojnë kategoritë e nxënësve përfitues të bursave në arsimin parauniversitar dhe kriteret e përfitimit, me qëllim rritjen e nivelit të njohjes dhe zbatimit të këtij kuadri ligjor nga punonjësit e shërbimeve sociale, administrata vendore dhe komuniteti.
- U realizua një takim me Drejtoreshën e Shërbimit Social pranë Bashkisë Fier në kuadër të trajtimit të një çështjeje konkrete.
- Zyra Rajonale, në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier, zhvilloi një takim pune me psikologen pranë Qendrës Shëndetësore nr. 2 Fier, ku u diskutua roli i saj në identifikimin dhe parandalimin e formave të fshehta të diskriminimit ndaj

grupeve vulnerabël, si dhe nevoja për sensibilizim mbi stigmat ndaj shëndetit mendor dhe përfshirje në aktivitete ndërgjegjëse të përbashkëta.

Gusht

- Realizuar takim me Ndihmën Juridike Falas Fier në kuadër të realizimit të aktiviteteve.
- Shpërndarje e materialeve të KMD-së në komunitet.

Shtator

- Zyra Rajonale zhvilloi një takim pune në zyrë me përfaqësuesen e OJF-së “Platforma Kombëtare për Gratë”, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe njohjen me veprimtarinë e Zyrës Rajonale.
- U realizua një takim pune me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Berat dhe Shërbimin e Ndihmës Juridike Falas, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe garantimin e aksesit në drejtësi për qytetarët. Diskutimet u fokusuan në informimin e publikut, organizimin e aktiviteteve sensibilizuese të përbashkëta dhe krijimin e një mekanizmi referimi më efikas për rastet që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi dhe të drejtat e njeriut.
- Zyra Rajonale zhvilloi një takim me punonjësën e Shërbimit Social të Bashkisë Divjakë për planifikimin e aktiviteteve informuese dhe sensibilizuese në dy njësi administrative ku janë të përqendruara kategori vulnerabël, duke u fokusuar në koordinimin e veprimeve ndërinstitucionale.
- U zhvilluan aktivitete informuese në bashkitë Lushnjë, Divjakë dhe Berat, ku u prezantuan dispozitat e Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si institucion i pavarur dhe procedurat e ankimit. Në këtë kuadër, u realizuan edhe takime me përfaqësues të njësive vendore dhe grupeve të interesit, me synim parandalimin e praktikave diskriminuese dhe promovimin e barazisë. Gjithashtu, Zyra Rajonale monitoroi zbatimin e VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022, duke theksuar respektimin e parimit të barazisë dhe transparencës në procesin e përfitimit të bursave për nxënësit.
- U zhvillua një takim me lehtësuesin e komunitetit rom, lidhur me moszbatimin e VKM nr. 666 për përfitimin e bursave nga fëmijët e komunitetit rom. U konstatua se përfitimi ishte miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, por ende nuk ishte zbatuar, dhe u identifikuan pengesat si dhe hapat e mëtejshëm për realizimin e vendimit në interes të fëmijëve romë.

Tetor

- Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale zhvilloi takime informuese në njësitë administrative Tërbuf dhe Grabian, të Bashkisë Divjakë, në kuadër të aktiviteteve për bashkitë e vogla. Gjatë takimeve u informua mbi Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe u monitorua zbatimi i VKM-së nr. 666, e ndryshuar me VKM nr. 511 datë 27.07.2022 që përcakton kriteret për përfitimin e bursave për nxënës të arsimit parauniversitar, përfshirë shkollat 9-vjeçare, të mesme dhe profesionale. U evidentuan sfida në informim dhe përfshirje të grupeve në nevojë, duke forcuar bashkëpunimin me autoritetet lokale.

- Në kuadër të aktiviteteve për mbrojtjen dhe informimin e personave me aftësi të kufizuara, në fshatin Seman të Njësisë Administrative Topojë, u zhvillua një takim informues me punonjësit e njësisë, si dhe persona me aftësi të kufizuara nga komuniteti lokal. Gjatë takimit u diskutuan të drejtat ligjore të personave me aftësi të kufizuara, sfidat që ata hasin në përditshmëri, si dhe mënyrat për të përmirësuar përfshirjen dhe aksesin në shërbimet sociale. Staf i njësisë u angazhua për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të forcuar bashkëpunimin me komunitetin për mbrojtjen e këtyre të drejtave.
- Në vazhdimësi të aktiviteteve informuese dhe mbrojtjes nga diskriminimi, u zhvillua një takim në Njësinë Administrative Dërmenas, ku target grupi ishin personat PAK (persona me aftësi të kufizuara). Diskutimet u fokusuan në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, mënyrat për parandalimin e diskriminimit ndaj tyre, si dhe masat për mbështetjen dhe përfshirjen e tyre në komunitet. **Qëllimi ishte rritja e ndërgjegjësimit dhe forcimi i bashkëpunimit për një komunitet më gjithëpërfshirës dhe të barabartë.**
- Zyra Rajonale priti në takim përfaqësues të OSBE-së në kuadër të vizitave monitoruese mbi të drejtat e të moshuarve dhe aksesin e tyre në shërbimet digjitale. Gjatë takimit u prezantuan gjetjet paraprake dhe u diskutuan rekomandimet fillestare.
- U theksua rëndësia e bashkëpunimit me aktorët lokalë dhe përfshirjes së komenteve për përmirësimin e raportit përfundimtar.

Nëntor

- Zyra Rajonale, në bashkëpunim me Shërbimin e Ndihmës Juridike Falas, zhvilloi një aktivitet pranë Qendrës me një Ndalesë (One Stop Center) në Spitalin Rajonal Fier, me pjesëmarrjen e koordinatorës së qendrës, psikologes dhe juristes së spitalit. Diskutimi u fokusua në mbrojtjen e të miturve nga dhuna fizike dhe seksuale, rëndësinë e raportimit të rasteve dhe sigurimin e mbështetjes psikologjike dhe juridike për fëmijët viktime apo dëshmitarë të dhunës.
- U realizua një takim me specialisten e arsimit pranë Bashkisë Vlorë lidhur me zbatimin e VKM nr. 666, datë 10.10.2019, për kategoritë përfituese të bursave në arsimin parauniversitar.
- Në Njësinë Administrative Libofsh u zhvillua një aktivitet informues dhe ndërgjegjëses i organizuar nga Zyra Rajonale Fier e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bashkëpunim me Qendrën e Ndihmës Juridike Falas, me fokus forcimin e njohurive të komunitetit mbi të drejtat e grave, format e diskriminimit dhe mekanizmat institucionalë të mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore.

Dhjetor

- Zyra Rajonale, në bashkëpunim me Ndihmën Juridike Falas, organizuan një aktivitet informues në Njësinë Administrative Qendër me rastin e 3 Dhjetorit, Ditës së PAK. Gjatë aktivitetit u prezantuan të drejtat dhe mbrojtja nga diskriminimi, si dhe u ofrua këshillim individual për qytetarët mbi situatat e diskriminimit dhe aksesin në shërbime.

Pjesëmarrje në aktivitete institucionale**Janar**

- **Pjesëmarrje në ëebinarin me temë:** “*Pushteti gjyqësor në Bashkimin Evropian dhe lidhja e tij me pushtetin gjyqësor të shteteve anëtare*”, organizuar nga **ASPA**.

Shkurt

- Pjesëmarrje në tryezën teknike “Ndihmë Rast Pas Rasti”, në kuadër të Javës Ndërgjegjësuese për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, aktivitet i Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, organizuar nga Qendra Platforma Kombëtare për Gratë me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e realizuar nga Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Fier, në Njësinë Administrative Cakran, në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit informues mbi ligjin 111/2017 'Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti' si dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Mars

- **Pjesëmarrje në trajnimin me temë:** “*Përdorimi i platformave interaktive për personat me aftësi të kufizuara*”, organizuar nga **Fondacioni Doën Syndrome Albania**, në kuadër të projektit “**EU4 Drejtësia Gjithëpërfshirëse për Aftësinë e Kufizuar në Shqipëri**”, i zbatuar në partneritet me **Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe ANAD**, me mbështetje financiare nga **Bashkimi Evropian**.
- **Pjesëmarrje në tryezën informuese** për prezantimin e gjetjeve mbi “*Hartëzimin e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore*” në **Bashkinë Fier**, organizuar nga projekti “**Shëndet për të Gjithë (HAP) dhe Qendra Epoka e Re**”.
- **Pjesëmarrje në aktivitetin e realizuar nga Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare (QKShK)**, në kuadër të projektit “*Rritja e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit nga Policia e Shtetit, aktorët lokalë dhe komuniteti për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore*”, financuar nga **Ambasada Suedeze** nëpërmjet **programit të policimit në komunitet**.

Prill

- Pjesëmarrje në kuadër të “*Ditës Ndërkombëtare të Romëve*”, në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Roskovec, me qëllim promovimin e kulturës rome dhe rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat dhe mosdiskriminimin ndaj këtij komuniteti.
- Pjesëmarrje në kuadër të “*Ditës Ndërkombëtare të Romëve*”, në tryezën e rrumbullakët me temë “*Krijimi i një mjedisi mbështetës për fuqizimin ekonomik të Romëve*”, organizuar nga IRCA në bashkëpunim me Bashkinë Fier.
- Pjesëmarrje në trajnimin me temë: “*Aksesi në drejtësi dhe barazia para ligjit për personat me aftësi të kufizuara*”, organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPK) dhe Bashkia Fier.
- Pjesëmarrje në ëorkshop-in me temë: “*Nga sfidat te zgjidhjet: Politika lokale për punësimin e të rinjve*”, në kuadër të projektit YEEP II – Youth Employment Enabling Prospects, organizuar nga Voice of Roma in Albania.

- Pjesëmarrje në trajnimin mbi rehabilitimin e autorëve të dhunës dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri, organizuar nga Qendra “Vatra”.

Qershor

- Pjesëmarrje në tryezën e diskutimit mbi avokimin dhe politikat për mbrojtjen e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara nga dhuna me bazë gjinore, organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në bashkëpunim me UN Women.
- Në kuadër të Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit ndaj Abuzimit të të Moshuarve, Zyra Rajonale Fier mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Qendra Social Komunitare Roskovec. Gjatë aktivitetit u prezantua roli i KMD-së në mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të moshës dhe u shpërndanë materiale informuese për të pranishmit lidhur me mekanizmat e ankimit dhe ndihmën që ofron Komisioneri.
- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: “Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse në zbatimin e legjislacionit për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje”, organizuar nga Bashkia Fier në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare (QNL). Në cilësinë e specialistes pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), ndau përvojën e saj dhe kontributin në forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe promovimin e barazisë, mbrojtjes nga diskriminimi dhe të drejtave të viktimave të dhunës në familje.

Gusht

- Specialisti i Zyrës Rajonale u bë pjesë e Grupit Ndërinstitucional Teknik (GNT) në Bashkinë Roskovec për trajtimin e rastit të një të mituri, me qëllim sistemimin e tij në një rezidencë; u kontribua në koordinimin me strukturat përgjegjëse dhe sigurimin e respektimit të të drejtave të fëmijës gjatë procesit.
- **Pjesëmarrje në** aktivitetin e organizuar nga *Nisma për Ndryshim Shoqëror – ARSIS*, në bashkëpunim me *Bashkinë Fier*, në kuadër të projektit “*Fuqizimi i Strukturave Lokale dhe Institucioneve Qeveritare për të parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm dhe për të mbështetur procesin e Rehabilitimit dhe Ri-integritimit në Shqipëri*”, i financuar nga *GCERF* dhe i koordinuar me *CVE Albania* dhe *ACPD*.

Shtator

- Pjesëmarrje në trajnimin me temë: “Dhuna ndaj grave në hapësirën digjitale: Menaxhimi efektiv i rasteve dhe mbrojtja e të dhënave personale online”, organizuar nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri në bashkëpunim me Bashkinë Fier.
- Pjesëmarrje në aktivitetin lançues të Projektit “Shëndet për Barazi dhe Siguri – Forcimi i Reagimit Ndërinstitucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Fier”, organizuar nga qendra “Epoka e Re”.

Tetor

- Pjesëmarrje në ëorkshop-in për validimin e të dhënave paraprake nga vlerësimi i punës së Mekanizmit të Koordinimit të Referimit (MKR) në Bashkinë Fier, në kuadër të projektit “Rritja e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit nga Policia e Shtetit, aktorët lokale dhe komuniteti për viktimat nga DHF dhe DHBGJ”, i financuar nga Ambasada Suedeze nëpërmjet programit të policimit në komunitet, Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare (QKShK).

- Pjesëmarrje në **trajnim dy-ditor** me temë: "Disenjimi dhe koordinimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi Dhunën me Bazë Gjinore me qëllim nxitjen e raportimit të rasteve pranë Mjekut të Familjes", organizuar nga Qendra "Epoka e Re", në bashkëpunim me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.

Nëntor

- Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale ishte pjesë e tryezës teknike në kuadër të projektit 'Rritja e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e punës dhe krijimi i një mjedisi mbështetës për të rinjtë në Bashkitë Selenicë dhe Himarë', organizuar në Vlorë, me mbështetjen e Qendrës së Studimeve dhe Zhvillimeve (SDC), financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Gjatë takimit, pjesëmarrësit u njohën me veprimtarinë e institucionit të KMD-së dhe Zyrës Rajonale, duke u ndalur te mbrojtja që ofron ligji në fushën e punësimit, si dhe te ankesat e trajtuara pranë Zyrës Rajonale në këtë fushë.
- Zyra Rajonale u bë pjesë e tryezës ndërinstitucionale, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të institucioneve vendore, Shërbimi Social Shtetëror, Koordinatorin e Dhunës në Familje, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF) dhe Policia, me fokus zbatimin e ligjit Nr. 111/2017 "Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti". Gjatë tryezës u trajtuan dhe raste konkrete për të cilat u lanë sugjerime dhe referime nga institucionet përkatëse.
- Pjesëmarrje në marshimin e realizuar nga Bashkia Fier, në kuadër të çeljes së fushatës nderkombëtare "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave

Dhjetor

- Pjesëmarrje në aktivitetin ndërgjegjësues, organizuar nga shoqata "Center for Gender Justice in Albania", zhvilluar në Qendrën e Kujdesit Ditor për Fëmijë dhe të Rinj me Aftësi të Kufizuara, Vlorë, në Ditën Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Pjesëmarrje në aktivitetin përmyllës të projektit YEPP II - "Youth Employment Enabling Prospects", organizuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, në partneritet me Voice of Roma in Albania.

Informacion mbi detyrat e përmbushura gjatë periudhës janar-dhjetor 2025

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 janë realizuar:

- Pritje qytetarësh çdo ditë; dhënie informacioni, asistencë në plotësimin e formularit të ankesës në të gjitha rubrikat përkatëse, orientim për dokumentacionin e nevojshëm, interpretim i vendimeve të KMD-së, interpretim i shkresave të ndryshme, si dhe asistencë në hartimin e shkresave drejtuar institucioneve përkatëse në lidhje me problematikat e qytetarëve.
- Mbajtje kontakti të vazhdueshëm me ankuesit në çdo fazë të hetimit administrativ dhe më tej.
- Mbajtje kontakti të vazhdueshëm me organizatat joqeveritare dhe institucionet e pushtetit vendor për pjesëmarrje në aktivitete; gjithashtu mbajtje kontakti me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në Vlorë, Berat dhe Sarandë, si edhe me Qendrat e Ndhmës Juridike Parësore Falas në Fier, Përmet dhe Gjirokastrë, në kuadër të bashkëpunimit për pjesëmarrje në aktivitete apo për referim rastesh.
- Shkëmbim emailsh pune me Drejtorinë e Pritjes së Ankesave (DPA).
- Shkëmbim emailsh pune me inspektorët për çështjet e adresuara nga Zyra Rajonale Fier.

- Përgatitje e raporteve të ndryshme (vjetore, gjashtëmuajore, periodike etj.) në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe bazuar në kërkesat e ardhura nga DPA.
- Pritje telefonatash nga publiku për informim në lidhje me procedurën e ankesës dhe çështje që lidhen me diskriminimin.
- Rritje e ndërgjegjësimit të opinionit publik, promovimi i masave parandaluese dhe ndërgjegjësimi i komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim, të realizuara përmes aktiviteteve të tipit “Ditë të Hapura”, ose “Street Laë”.
- Janë realizuar 15 (pesëmbëdhjetë) takime institucionale
- Janë realizuar 24 (njëzet e katër) aktivitete në terren dhe zyrë (informuese, ndërgjegjesuese, monitoruese, tryeza, ditë të hapura etj)
- Pjesëmarrje në 24 (njëzet e katër) aktivitete dhe 1 (një) ëëbinar.

Gjatë periudhës janar-dhjetor specialisti i Zyrës Rajonale Fier ka informuar/këshilluar dhe referuar në zyrat përkatëse 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) qytetarë për problematikat si më poshtë:

- Konsulencë lidhur me procesin gjyqësor për vërtetim atësie.
- Konsulencë lidhur me mbifaturim nga OSSHE pavarësisht nga ndërprerja e kontratës.
- Konsulencë në lidhje me hipotekën.
- Konsulencë ligjore lidhur me njohjen e viteve të ushtrisë dhe punën në minierë për llogaritjen e pensionit të pleqërisë.
- Konsulencë ligjore lidhur me pezullimin e pensionit suplementar dhe atij të pleqërisë për shkak të punësimit privat.
- Konsulencë lidhur me dokumentat dhe aplikimin për "ndreqje gabimi" pranë kadastrës me qëllim vijimin e procedurës së regjistrimit të objektit të legalizuar.
- Konsulencë lidhur me masën e kompensimit të shpenzimeve funerale nga ana e ISSH Fier.
- Konsulencë lidhur me bonusin e dhënë në dhjetor të 2024 për personat PAK si dhe asistim në përpilimin e shkresës drejtuar Shërbimit Social Shtetëror Fier lidhur me mosmarrjen e masës së kempit së bashku me bonusin e dhënë nga qeveria.
- Konsulencë lidhur me konfliktin e lindur midis komshinjve për shkarkimin e ujërave të pijshëm; orientuar t’i drejtohen me kërkesë Bashkisë Fier për marrjen e masave.
- Konsulencë mbi procedurën e regjistrimit të fëmijës së lindur jashtë vendit.
- Këshillim mbi procedurën e regjistrimit të pronës.
- Këshillim mbi procedurën e njohjes së atësisë. Referuar Ndihmës Juridike Falas.
- Interpretim i vendimeve të Gjykatave (shkallës së parë dhe apelit).
- Informacion mbi statusin e padisë në Gjykatën e Lartë.
- Konsulencë mbi procedurën e regjistrimit të tokës truall.
- Konsulencë mbi afatet ligjore të ankimimit për ndërprerje të pagesës së kempit.
- Konsulencë lidhur me procedurën për të ndjekur çështjen në rrugë gjyqësore për ulje të masës së pagesës nga KMCAP. Referuar Ndihmës Juridike Falas, Fier.
- Mbi ndjekjen e çështjes në rrugë gjyqësore për zgjidhje të menjëhershme të kontratës së punës pa respektuar afatet ligjore të njoftimit për largim nga puna.
- Mbi dokumentacionin e nevojshëm për të përmbushur kriteret ligjore për përfitimin e avokatit falas për zgjidhje të konfliktit në lidhje me dëmin e shkaktuar nga komshiu për shkak të kanalizimeve. Referuar Ndihmës Juridike Falas në Fier.

- Konsulencë mbi procedurën dhe dokumentacionin për përfitim të avokatit falas për hapje të procesit gjyqësor në lidhje me ndryshimin e masës së pensionit ushqimor. (Referuar Ndhmës Juridike Falas)
- Asistuar në përpilim kërkesë për t'u pajisur me formularin A6.
- Konsulencë ligjore lidhur me ligjin "Paketa e maleve".
- Asistuar në përpilim shkresë drejtuar Gjykatës së Lartë lidhur me përshejtim procedure për shkak të moshës.
- Konsulencë lidhur me ekzekutimin e vendimit nga ana e Përmbartimit.
- Konsulencë lidhur me mospërmbushjen e detyrimit të pensionit ushqimor, referuar Ndhmës Juridike Falas.
- Referuar për kompetencë dy ankesa Zyrës Rajonale të AP-së në Berat.
- Konsulencë ligjore lidhur me interpretimin e ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
- Ndërmjetësuar në marrjen e një kopje të AMTP-së.
- Asistuar në përpilim shkresë për tërheqjen e AMTP-së.
- Aplikim për leje qëndrimi në platformën e-Albania për llogari të një qytetari.
- Konsulencë lidhur me problematikën me OSHEE dhe UKF Fier.
- Përpilim shkresë për të marrë formularin A6.
- Asistim në përpilim shkresë drejtuar Njësisë Administrative Levan.
- Asistim në përpilim shkresë drejtuar OSHEE-së Fier.
- Konsulencë me një grup mësuesish lidhur me procedurat e ankimimit dhe kompetençat ligjore të KMD-së.
- Asistuar në përpilim shkresë për pajisje me dokumentacion të ndarjes së tokës, drejtuar Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
- Konsulencë në lidhje me çështje debie pranë UKF Fier.
- Konsulencë për rrugën ligjore në lidhje me moskthimin e shumë sipas kontratës së huas.
- Interpretim i vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Referuar për kompetencë përfaqësuesit të Avokatit të Popullit në Vlorë çështje në lidhje me riparimin e banesës nga ana e Bashkisë Fier.
- Konsulencë lidhur me procedurën e regjistrimit të divorcit në Shqipëri.
- Interpretim i vendimit të KMD-së dhe orientim për hapa të tjere ligjore.
- Konsulencë ligjore lidhur me pjesëmarrjen si palë e tretë në procesin gjyqësor të KMD-së.
- Konsulencë për t'u pajisur me certifikatë pronësie.
- Orientuar për t'u drejtuar me kërkesë/ankesë DAR Fier, për të vijuar më tej me hapa të tjerë ligjore.
- Orientuar për t'u drejtuar në Zyrën e Ndërmjetësimit Vlorë, qytetari për zgjidhje të rastit të tij.
- Asistim në përpilim kërkesë drejtuar Njësisë Administrative Ndërmenas.
- Asistim për plotësim kërkesë drejtuar ATP-së për Kthim dhe Kompensim të Pronës.
- Konsulencë ligjore lidhur me një rast mbifaturimi nga ujësjellësi. Qytetari iu sqaruan hapat për ankimin administrativ dhe mundësitë për ndjekje ligjore të mëtejshme.
- U ofrua konsulencë ligjore për një qytetar lidhur me mungesën e bazës ligjore për kompensim për periudhën e papunësisë, duke u sqaruar se legjislacioni shqiptar parashikon vetëm

pagesën e papunësisë dhe ndihmën ekonomike kur plotësohen kushtet ligjore, si dhe mundësinë e ankimit në rast diskriminimi në punësim.

- U dha konsulencë ligjore për një qytetar që nuk ka përfituar dy paga dhe asistencën njëvjeçare sipas kontratës, duke u orientuar për ndjekje ligjore dhe përfitim të ndihmës juridike falas në Berat, si person me të ardhura të pamjaftueshme dhe pjesëtar i komunitetit egjiptian.
- U ofrua konsulencë ligjore për punonjës të sigurisë së një kompanie private, pa kontratë pune, të cilët nuk kanë marrë pagën për dy muaj, duke i orientuar të paraqesin ankesë pranë Inspektoriatit Shtetëror të Punës.
- U asistua përpilimi i një kërkesë drejtuar ISSH-së lidhur me njohjen e viteve të punës për shkak të parregullsive në llogaritjen e masës së pensionit.
- U asistua një qytetar në ngarkimin e dokumentacionit në sistem për procedurat e njohjes së pronësisë.
- U ofrua asistencë ligjore lidhur me çeljen e trashëgimisë testamentare.
- **Asistuar qytetari lidhur me ndryshimin e vendbanimit në sistem.**
- **Aplikim për vërtetim pasurie.**
- **Konsulencë lidhur me kalimin e pronësisë.**
- **Konsulencë lidhur me rishqyrtimin e pensionit.**
- **Aplikim për certifikatë familjare e vitit 1991.**
- Konsulencë ligjore lidhur me një konflikt me OSHEE, ku qytetari pretendon se komshiu ka ndërhyrë në rrjetin elektrik, duke shkaktuar matje të padrejtë të konsumit. U ofrua konsulencë mbi kuadrin ligjor (Ligji nr. 43/2015 dhe Kodi Penal), detyrimin e OSHEE për kontroll teknik dhe ndarje të linjave, si dhe të drejtat për ankimin pranë ERE dhe kallëzim penal në organet e rendit.
- **Konsulencë ligjore lidhur me një konflikt fqinjësor për mungesë uji**, pasi pompa elektrike e përbashkët ishte prishur; palët u këshilluan mbi të drejtat dhe detyrimet për riparimin sipas marrëveshjeve të përdorimit të përbashkët dhe rregulloreve të ujësjellësit.
- **Konsulencë ligjore mbi mosshyerjen nga prindi të pensionit ushqimor**, në kundërshtim me vendimin gjyqësor; u sqaruan hapat për ekzekutimin përmbarimor dhe procedurat ligjore për përgjegjësi penale në rast moszbatimi.
- **Konsulencë lidhur me rishqyrtimin e pensionit.**
- **Konsulencë ligjore lidhur me zvarritjen e procedurave pranë hipotekës**, ku u sqaruan të drejtat për marrjen e shërbimit brenda afateve ligjore dhe mundësia e ankimit administrativ apo gjyqësor për vonesat e pajustificuara.
- **Konsulencë ligjore lidhur me çështje pronësie për pajisjen me hartë kadastrale dhe aplikimin në sistem**, ku u ofruan udhëzime mbi dokumentacionin e nevojshëm dhe procedurat ligjore për regjistrimin pranë ASHK.
- U ofrua konsulencë ligjore mbi rastin e një qiramarësi që refuzon të lirojë një objekt pa hipotekë, i mbajtur me marrëveshje dore me afat të pacaktuar; u sqaruan hapat për njoftimin me shkrim, padinë për lirimin e sendit të zaptuar dhe ekzekutimin përmbarimor, si dhe nevoja për rregullimin e dokumentacionit të pronësisë.
- Konsulencë ligjore lidhur me mënyrat e kalimit të pronës nga prindi te fëmija.
- Konsulencë ligjore lidhur me procedurat e ndryshimit të mbiemrit.
- Konsulencë ligjore mbi problematikën e kanalizimeve; u orientua të paraqesë kërkesë pranë Bashkisë dhe Ujësjellësit në Ballsh.

- Aplikim për çertifikatë pronësie.
- Intepretim shkrese ardhur nga Kadastra lidhur me dokumentacionin për aplikim.
- Orientuar qytetari t'i drejtohet Bashkisë Fier lidhur me problematikën e tij.
- Konsulencë ligjore lidhur me kalimin e pronësisë së shtëpisë në mungesë testamenti apo akt dhurimi.
- Konsulencë lidhur me mosegzekutimin e pensionit ushqimor me vendim gjykate nga ana e njërit prind.
- Asistuar në përpilim shkrese për pajisje me formular A6.
- Dhënë konsulencë lidhur me bazën ligjore për "Lejen prindërorë të papaguar" sipas Kodit të Punës neni 132-133-134.
- Konsulencë lidhur me të drejtën e ankimimit pranë Kempit Epror.
- Qytetarit iu ofrua konsulencë ligjore dhe u orientua pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për humbjen e çertifikatës së pronësisë.
- Qytetarit iu ofrua konsulencë ligjore lidhur me çështjen e ndryshimit të grupit nga KEMP-i epror, si dhe u orientua mbi procedurat ankimore dhe dokumentacionin e nevojshëm.
- Konsulencë ligjore mbi kategoritë që përjashtohen nga taksa e banesës, sipas legjislacionit në fuqi.
- Asistuar në aplikimim për tu pajisur me çertifikatë pronësie.
- Konsulencë lidhur me lejen vjetore pas lejes së lindjes.
- Asistuar në përpilim shkrese drejtuar ASHK-së.
- Konsulencë lidhur me pjesëtimin e pasurisë.
- Konsulencë lidhur me posedimin e sendit.
- Konsulencë lidhur me aplikimin për banesë sociale.
- Asistuar në përpilim shkrese drejtuar ASHK-së.
- Konsulencë lidhur me aplikimin për pension social.
- Konsulencë lidhur me aplikimin për përfitimin e bursës së fëmijës sipas VKM 666.
- Orientuar për dorëzim dokumentacioni për përfitim burse sipas VKM 666 pranë zyrës me një ndalesë Bashkia Fier.
- Konsulencë lidhur me ndryshimin e gjëndjes civile.
- Konsulencë lidhur me përfitimin e kujdestarisë së fëmijës dhe pensionit ushqimor.
- Rifreskim karteles pasurie.
- Aplikim për përfitimin e banesës sociale.
- Asistuar në përpilim shkrese drejtuar njësisë administrative Frakull.
- Asistuar në përpilim shkrese drejtuar DRAP Fier dhe Ministrisë së Arsimit.
- Konsulencë lidhur me çështje pronësie.
- Asistence lidhur me përfitimin nga skema e ndihmës juridike falas. Referuar çështja pranë qendrës në Fier.
- Konsulencë lidhur me heqjen e kujdestarisë së fëmijës PAK.
- Konsulencë lidhur me mosofrimin e shërbimit psikologjik për fëmijën PAK nga psikologia e shkollës.
- Konsulencë lidhur me ndryshimin e emrit të kontratës së energjisë elektrike.
- Konsulencë lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e bursës sipas VKM 666, 3 qytetarëve, si dhe orientuar për aplikim pranë Bashkisë Fier.
- Aplikim për kalimin e pronësisë.

- Konsulencë lidhur me aplikimin për kredi të butë.
- Konsulencë lidhur me aplikimin për përfitimin e bonusit të qerasë.
- Asistuar në aplikimin në sistem për përfitimin e kredisë së butë 3 qytetarë.
- Asistuar në përpilim shkresë drejtuar OSHE për kompensim të energjisë elektrike.
- Konsulencë lidhur me anulimin e deklaratës noteriale.
- Aplikim për tërheqje të çertifikatës martesore para vitit 2010.
- Konsulencë ligjore lidhur me përfitimin e bonusit të bebes kur akti i lindjes është mbajtur jashtë territorit të Shqipërisë.

Ndërmjetësime

- Zyra Rajonale ndërmjetësoi në fushën e arsimit dhe siguroi për një mësues ndihmës për mbështetjen e një fëmije nga Vlora.
- Ndërmjetësuar në fushën e shërbimeve për marrjen e një kopje të AMTP-së pranë DAMT Fier

Pasqyrim në Media

- Dalje në media në televizionin lokal të Vlorës **6+1 Vlora TV**.

3. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD. Ky objektivi është një nga prioritetet kryesore të ZR Shkodër. Gjatë vitit 2025 kjo zyrë ka qenë organizatore e zhvillimit të ditëve të hapura me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe kategorive të ndryshme shoqërore si dhe promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim.

Shkurt

- Takim me përfaqësuesin e Zyrës së Ndihmës Juridike Falas për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta.
- Takim me përfaqësues të shoqatës “Montenegro”.
- Takim me përfaqësues të Qendrës së Gruas “Hapa të Lehta”, me qëllim prezantimin e rolit të ZR të KMD-së dhe misionit të Komisionerit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Takim me përfaqësues të Projektit “Shpresa”, duke përfshirë psikologun klinike, me qëllim prezantimin e rolit të ZR të KMD-së dhe misionit të Komisionerit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Mars

- Takim me përfaqësues nga Ambasada Amerikane, ku u diskutua për strukturën, funksionet, shtrirjen dhe sfidat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).

- Takim me përfaqësues të Shoqatës “Për të Drejtat e Komunitetit Egjiptian”, për të njohur situatën aktuale dhe problematikat e banorëve të lagjes “Iliria”.
- Takim me përfaqësues të Shoqatës “Moraça-Rozafa”, ku u diskutua historiku i shoqatës dhe i minoritetit serb në Shqipëri, si dhe situata aktuale e këtij komuniteti.
- Takim me përfaqësues të Shoqatës "Shpresa për të Ardhmen", ku u prezantuan shoqata dhe projektet e ndryshme të ndërmarra nga ajo.

Prill

- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Komunitetit Rom, Zyra Rajonale në bashkëpunim me Avokatin e Popullit dhe Qendrën e Ndihmës Ligjore Falas, organizoi një ditë të hapur në lagjen “Iliria”, ku u diskutua me pjesëtarë të komuniteteve Rom dhe Egjiptian për problematikat e tyre.
- Organizuar një ditë e hapur në zonën “Zalli i Kirit”, ku janë zhvendosur familjet Rome nga lagja “Iliria”. Diskutimet përqendroheshin mbi mungesën e ujit dhe dritave, si dhe mbi nevojën për ndërhyrje të autoriteteve vendore.
- Realizuar në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, takim me përfaqësues të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara në Shkodër, ku u diskutuan problematikat me të cilat përballen këta persona.
- Në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, u realizua takim me specialistët e Shërbimeve Sociale të Bashkisë Shkodër për prezantimin e strukturave dhe mundësive të bashkëpunimit.

Maj

- U organizua takim me përfaqësues të organizatës “Malteser” për evidentimin e rasteve potenciale të diskriminimit. Gjatë takimit u diskutuan problematikat me të cilat përballen pjesëtarë të komunitetit Rom dhe persona me aftësi të kufizuara.

Qershor

- U organizua një leksion sensibilizues në shkollën 9-vjeçare “Gjergj Vat Martini”, Velipojë, ku nxënësve iu prezantua përkufizimi dhe format e diskriminimit, si dhe informacion mbi LMD-në dhe KMD-në.
- U organizua takim në Zyrën Rajonale me përfaqësues të komunitetit Egjiptian në Komitetin e Pakicave Kombëtare dhe me përfaqësues të shoqatës së tyre në Shkodër. Diskutimet u fokusuan mbi situatën aktuale dhe problematikat me të cilat përballen komuniteti.
- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër shfrytëzimit të fëmijëve në punë, specialistit i Zyrës Rajonale, në bashkëpunim me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit dhe të organizatës egjiptiane në Shkodër, organizuan një aktivitet sensibilizues në lagjen “Iliria”, ku morën pjesë fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian. Aktiviteti përfshiu prezantim të institucioneve përkatëse dhe aktivitete zbatuese për fëmijët, me qëllim njohjen e të drejtave të tyre.
- Në bashkëpunim me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Shkodër, u organizua një takim me përfaqësuesit e zyrës së Ndihmës Juridike Falas. Diskutimet u fokusuan në çështjet që janë trajtuar së fundmi nga Zyra e Ndihmës Juridike Falas dhe me problematikat e përgjithshme me të cilat po përballen institucionet përkatëse aktualisht.

- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Gjuhës së Urrejtjes, përfaqësuesi i Zyrës Rajonale, në bashkëpunim me përfaqësuesen e organizatës “Projekti Shpresa”, organizoi një aktivitet sensibilizues me temë: “Shoqëri pa Barrierë: Përfshirje, të Drejta dhe Zhvillim i Ndërgjegjësimit Kundër Diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Shtator

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale Shkodër, u organizua një aktivitet informues dhe sensibilizues në Qendrën Multifunkionale “Për Familjen”, mbi mundësitë për përfitimin e bursave shkollore sipas VKM nr. 666, për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Egjiptian.
- Në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, u zhvillua një takim në azilin e pleqve në Shkodër, ku u prezantua struktura institucionale dhe u diskutuan problematikat me të cilat përballen banorët dhe stafi.
- U zhvillua takim me përfaqësues të sindikatave të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe, ku pas prezantimit institucional, diskutimet u fokusuan mbi problematikat e përgjithshme dhe individuale të anëtarëve të sindikatave.
- Në bashkëpunim me Avokatin e Popullit dhe shoqatën “Projekti Shpresa”, u zhvillua një takim, ku u diskutuan problematikat e personave me aftësi të kufizuara në rajonin e Shkodrës.

Tetor

- Përfaqësuesi i ZR, së bashku me Përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Shkodër, organizuan një takim me Presidentin e Shoqatës Rome në Lezhë “Romët e Veriut”. Fokusi i diskutimeve ishte mbi situatën aktuale të komunitetit rom në Lezhë dhe problematikat me të cilat përballlet ky komunitet.
- Përfaqësuesi i ZR, së bashku me Përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Shkodër, si edhe me Përfaqësuesen e Zyrës së Ndhmës Juridike Falas në Lezhë, organizuan një ditë të hapur në qytetin e Lezhës.

Nëntor

- Përfaqësuesi i ZR zhvilloi një takim me oficeren ligjore të organizatës ndërkombëtare OSCE, gjatë të cilit iu prezantua projekti i realizuar nga organizata mbi aksesin e moshës së tretë në shërbimet e dixhitalizuara; u informua mbi numrin e personave të moshës së tretë që janë paraqitur pranë Zyrës Rajonale për depozitimin e ankesave.

Dhjetor

- Në bashkëpunim me Përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Shkodër, u zhvillua aktivitet sensibilizues në shkollën 9-vjeçare “Ali Laçej”, ku u organizua një diskutim i hapur mbi tematika relevante për nxënësit, si diskriminimi, gjuha e urrejtjes dhe bullizimi. Më pas, u prezantua institucioni dhe formulari i ankesës.
- Në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, u zhvillua takim me prindërit dhe me zv. Drejtoreshën e shkollës speciale “3 Dhjetori”, ku u diskutuan problematikat e shkollës dhe sfidat me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara.

- Në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, u organizua takim me kryetarin dhe anëtarët e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura në Shkodër, ku u zhvilluan diskutime mbi problematikat potenciale me të cilat përballen anëtarët e sindikatës.

Pjesëmarrje në aktivitete institucionale

Shkurt

- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga KMD-ja në Kukës me temë: “15 vjetori i miratimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

Mars

- Pjesëmarrje në takim informues të organizuar nga Qendra e Gruas "Hapa të Lehta", për Ditën Ndërkombëtare Kundër Racizmit, ku morën pjesë rreth 10–15 nxënës nga Qeveria e Nxënësve e Shkollës 9-vjeçare "Ismail Qemali". Në këtë takim u bë prezantim mbi diskriminimin racor në Shqipëri, si dhe mbi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe kompetencat e tij.
- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: “Festivali i Trashëgimisë Kulturore në Shqipërinë e Veriut”, organizuar nga përfaqësuesit e organizatës “Forumi Shqiptar i Liqenit të Shkodrës”.

Prill

- Pjesëmarrje në marshimin sensibilizues të organizuar nga Bashkia Shkodër me temë: “Ecim për Autizmin”, në kuadër të Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga OMSA-Albania dhe Qendra e Gruas “Hapa të Lehta” me temë: “Implementimin e Politikave Lokale dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTIQ+”. Në takim ishin të pranishëm punonjës të Bashkisë Shkodër si edhe përfaqësues nga Ministria e Brëndshme dhe Avokati i Popullit.
- Pjesëmarrje në Tryezën e Rrumbullakët, organizuar nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri në bashkëpunim me organizatën “Gruaja te Gruaja”. Tematika e diskutimit ishte “Përfshirja e grave në proceset e vendimmarrjes”. Në këtë aktivitet morën pjesë qytetarë dhe studentë.
- Pjesëmarrje në tryezën e diskutimit, organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHHPAK), me tematikë “Aksesi në drejtësi dhe barazia para ligjit për personat me aftësi të kufizuara”.

Maj

- Pjesëmarrje në ëorkshopin e organizuar nga Lincoln Center Shkodër, me stafin e Qendrave Komunitare “Për Familjen” të Bashkisë Shkodër, me temë: “Mënyra praktike si të përballemi me sfidat e punës me familjet e qendrave komunitare ‘Për Familjen’”.
- Pjesëmarrje në aktivitetin “GenZë”, organizuar nga Shërbimi Psikosocial i ZVA Shkodër, në bashkëpunim me psikologët e shkollave të mesme. Gjatë këtij aktiviteti u bë prezantim mbi të drejtat dhe detyrimet e të rinjve sipas konventave ndërkombëtare, konceptin e diskriminimit dhe format e tij, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).

Qershor

- Në kuadër të projektit "Krenar që kemi të Drejta: Promovimi i barazisë, përfshirjes sociale dhe mosdiskriminimit të grave dhe personave LGBTIQ+ në Shqipëri", ZR u ftua nga organizata "COSPE" për të marrë pjesë në Tryezën e Parë Teknike Ndërinstitucionale, e cila u zhvillua në ambientet e Bashkisë Shkodër.

Korrik

- Pjesëmarrje në aktivitetin përmbyllës të projektit "Konsolidimi i Sistemeve për Fuqizimin e Viktimave në Shqipëri" organizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale Bashkia Shkodër, organizata "Të ndryshëm & Të barabartë" dhe KMOP – Qendra për Inovacion dhe Veprim Social (Greqi), në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit "BE për përfshirjen sociale në Shqipëri".

Tetor

- Pjesëmarrje në ekspozitën me punime artistike të realizuara nga të rinj me aftësi të kufizuara, organizuar në kuadër të projektit "Fuqizimi i Shëndetit dhe Mirëqenies: Laboratorë të angazhimit me punë për personat e rritur jetimë me aftësi të kufizuara në nevojë", organizuar me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit Mendor.
- Përfaqësuesi i ZR, u ftua nga Shoqata "Projekti Shpresa" për të marrë pjesë në 30-vjetorin e themelimit të shoqatës.

Dhjetor

- Pjesëmarrje në aktivitetin "Ëalk In My Shoes: Different Abilities, Equal Opportunities", organizuar nga Young European Ambassadors. Gjatë aktivitetit u bë prezantimi i institucionit, duke theksuar rolin e Komisionerit në mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe promovimin e barazisë së mundësive në komunitet.
- Pjesëmarrje në konferencën përmbyllëse të projektit "Youth4Youth: A Neë Generation for Ëellbeing", organizuar nga Qendra e Këshillimit dhe Shërbimeve Psikologjike, me mbështetjen e UNESCO dhe SEVENTEEN. Aktiviteti u fokusua në sfidat e shëndetit mendor të të rinjve dhe rëndësinë e qasjes së barabartë në shërbime. Pjesëmarrësi kontribuoi në diskutimet dhe shkëmbimin e ideve me aktorët e pranishëm.

Informacion mbi detyrat e përmbushura gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 ZR Shkodër:

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar detyrat si më poshtë:

- Pritur qytetarë të interesuar për të ngritur një ankesë pranë KMD. Informuar, sqaruar dhe ndihmuar në plotësimin e formularit dhe akteve bashkëshoqëruese.
- Komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me ankuesit për çdo informacion apo/dhe ndihmë që ato kanë pasur nevojë.
- Komunikuar dhe ndihmuar inspektorët e çështjeve në KMD për çdo informacion që ato kanë pasur nevojë për shqyrtimin e ankesës.

- Kthim përgjigje me email me përfaqësues të institucioneve lokale dhe të organizatave të shoqërisë civile.
- Telefonata pune me KMD, bashkëpunëtorë, institucione qendrore e vendore dhe aktorë të ndryshëm lokal.
- Përgatitje e raporteve, në përgjigje të kërkesave të DPA.
- Takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e institucioneve vendore, OJF-ve dhe ata të Shoqërisë Civile.
- Referuar 10 (dhjetë) raste në zyrat përkatëse për zgjidhjen e problematikave, si më poshtë:
- Konsulencë për aplikimin për përfitimin e bursës sipas VKM-së nr. 666, për pjesëtarë të komunitetit rom.
- Ofrimi i informacionit për procedurën e ndryshimit të pashaportizimit, duke iu drejtuar Zyrës së Shërbimeve Sociale, Bashkia Shkodër.
- Konsultimi i një qytetari për realizimin e një ankese pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit.
- Realizimi i interpretimeve të vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).
- Ofrimi i informacionit për aplikimin për pranimin në Shtëpinë e të Moshuarve, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Bashkia Shkodër.
- Orientim pranë Zyrës së Ndhmës Juridike Parësore për një person që dëshiron të hapë një çështje pronësie në gjykatë.
- Referimi i një rasti pranë Zyrës së Avokatit të Popullit për trajtimin e një çështjeje pronësie.
- Referimi i një rasti pranë Zyrës së Avokatit të Popullit në lidhje me punësimin në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.
- Referimi i një rasti pranë Zyrës së Avokatit të Popullit në lidhje me mungesën e kushteve minimale të jetesës për disa pjesëtarë të komunitetit rom.
- Drejtimi i një personi pranë Zyrave të Punësimit për t’u regjistruar si person i papunë.

Pasqyrim në media

- Specialisti i Zyrës Rajonale realizoi intervista për mediat “Star Plus TV” dhe RTSH, ku trajtoi rastet e diskriminimit të paraqitura pranë KMD-së nga Zyra Rajonale Shkodër gjatë vitit 2025, si dhe rolin e KMD-së në luftën kundër gjuhës së urrejtjes.

VI. ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

1. Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2024

- I. Janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve për vitin 2025, si dhe janë dorzuar pranë ILDKPKI- së deklaratat e pasurive të subjekteve që mbartin detyrimin e deklarimit sipas arashikimeve ligjore për vitin 2024.
- II. Është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit. Stafi i KMD-së ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme si, trajnime të organizuara me anë të webinarëve nga, Shkolla Shqipëtare e Administratës Publike (ASPA) dhe institucione të tjera.
- III. Në trajnimin e organizuar me webinar nga ASPA dhe institucione të tjera janë trajtuar tema si:
 - Kodi i Procedurave Administrative.
 - Legjislacioni në fushën e sigurisë kibernetike
 - Barazia gjinore, analizat dhe statistikat
 - Menxhimi i projekteve
 - Higjiena kibernetike dhe praktikrat më të mira të sigurisë
 - Siguria online
 - Forcimi i llogaridhënies institucionale: Etika, informimi dhe mekanizmat e antikorupsionit.
 - Mbrojtja nga diskriminimi: zbatimi i ligjit dhe roli i institucioneve në mbrojtjen e grupeve të cënueshme.
 - Trajtimi i rasteve të konfliktit të interesave
 - Veprimtaria e burimeve njerëzore në menaxhimin, matjen e performances dhe motivimin në administratën publike.
 - Të drejtat themelore të njeriut dhe administratë publike në Shqipëri
 - Lidershipi në administratën publike: Roli strategjik për performance dhe sukses.
 - Elementet e menaxhimit të marrëdhënies në shërbimin civil: Legjislacioni dhe praktikrat.
 - Marrëdhëniet individuale të punës, të drejtat, detyrimet dhe përparësitë e normave juridike.
 - Transparenca dhe aksesin në informacionin public.
 - Balanca mes etikës dhe të drejtave politike të nëpunësve.
 - Deklarimi i pasurive, llojet dhe afatet e deklarimit të pasurisë.
 - Aftësitë menaxheriale për zhvillimin e burimeve njerëzore.
- IV. Punonjësit u përfshinë në një proces trajnimesh, të cilat mundësuan shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikrat më të mira si dhe në aktivitete të ndryshme të organizuarë në fushën e të drejtave të njeriut/diskriminimit me tema:
 - Platëforma e Integritit Evropian dhe Anëtarësimin në Procesin e Integritit
 - Kapitulli 2 Lëvizja e lirë e punëtorëve.
 - Gratë në politike dhe zgjedhje
 - Akses në drejtësi dhe barazia para ligjit për personat me aftësi të kufizuara.
 - Politikrat lokale për punësimin e të rinjëve.
 - Analiza gjinore dhe përdorimi i saj në ciklin buxhetor.

- Rehabilitimi i autorëve të dhunës dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri.
 - Moduli i Intiligjencës Artificiale
 - Kapitulli 2 Harmonizimi iakteve të legjislacionit të BE-së.
 - Përgatitja e planit të punës për adresimin e kriterëve mbyllëse për Kapitullin 2 Levizja e lirë e punëtorëve.
 - Platëforma e dialogimit Për një integrim më të mire socio-ekonomike të të huajve në Shqipëri.
 - Rimendimi i forumit rinor të ballkanit perendimor 2025.
 - Plani kombëtar vijues të veprimit për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri 2026-2030.
 - Të drejtat e të moshuarëve në Shqipëri
 - Lancimi i udhëzuesit për këshilltarët e etikës dhe prezantimin I udhëzuesit për këshilltarët e etikës.
 - Mirëqenia mendore e të rinjëve.
- V. Punonjësit e Zyrës Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me tema:
- Java kundër Diskriminimit
 - Tryezë diskutimi Fuqizimi përmes mentorimit social- rrugët drejt punësimit.
 - Takim informues për ligjin Për mbrojtjen nga diskriminimi si dhe funksioni i zyrës rajonale.
 - Takim informues në kuadër të Ditës Botërore të Autizmit
 - Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi- Barazia gjinore dhe mbikëqyrja ligjore
 - Rritja e dukshmërisë dhe përmirësimi i zbatueshmërisë së vendimarrjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
 - Indeksi i aksesueshmërisë dhe transparencës publike.
 - Konfereca vjetore e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

2. Menaxhimi i burimeve financiare 2025

Në zbatim të ligjit “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2025”, po Ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2025, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond prej **80.523,63 (në mijë lekë)** për vitin 2025. Totali i vlerës së akorduar përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	51. 758	<i>mijë lekë (zëri 600)</i>
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	8. 972	<i>mijë lekë (zëri 601)</i>
Fondi për Shpenzime Operative:	13. 320	<i>mijë lekë (zëri 602-606)</i>

Fondi për Investime:	1. 000	mijë lekë (zëri 231)
Fondi donator Shpenzime Operative:	5. 473, 63	mijë lekë (zëri 602-606)

Nga fondi i planifikuar nga buxheti i shtetit për 12-mujorin që është **75.050,00 (në mijë lekë)**, për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar vlerën buxhetore dhe jashtë buxhetore **68.066,47 në mijë lekë** ose **90,7 %** të buxhetit të akorduar.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 34 datë 20. 05.2010 “Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndryshuar, numri mesatar i punonjësve është realizuar 34 nëpunës, nga 34 të miratuar.

Nga fondi i pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpërblimeve të planifikuar prej **60.730,00 (në mijë lekë)** për këtë periudhë, është realizuar **59.057,53 (në mijë lekë)** për paga dhe për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose **97,25 %** e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606); për 12-mujorin e vitit 2025, është planifikuar në vlerën **13.320 në mijë lekë**. Për periudhën respektive është realizuar vlera prej **12.746,97 (në mijë lekë)** ose **95,7 %**, e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi për shpenzim investime (zëri 231): nga vlera e përgjithshme prej 1.000 (në mijë lekë) për periudhën e raportuar është realizuar vlera prej **922,4 (në mijë lekë)** ose **92,24 %**, e fondit të vitit të planifikuar..

Realizimi dhe monitorimi i përdorimit të fondeve publike në nivel të përgjithshëm programi dhe realizimi ka qënë në masën **96,9 %**.

Fondi donator në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606); për 12-mujorin e vitit 2025, është planifikuar në vlerën **5.473,63 në mijë lekë** për këstin e parë. Për periudhën respektive është realizuar vlera prej **1.102,00 (në mijë lekë)** ose **20,13 %**, e fondit të vitit të planifikuar.